



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE  
DHE SHANSEVE TE BARABARTA

**Strategjia sektoriale  
e mbrojtjes sociale  
2007-2013**

Gusht 2007

# Parathënie

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, është produkt i reformave të Qeverisë, që kanë për qëllim standardizimin e procesit të planifikimit strategjik, midis ministrive.

Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe kërkesat e Urdherit të Kryeministrit, nr. 134, datë 12.06.2006, kjo strategji sektoriale, jep një tablo të hollësishme të politikave të mbrojtjes sociale të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

- Hapi i parë në këtë drejtim ishte hartimi dhe aprovimi i Strategjisë së Sherbimeve Sociale, në maj të vitit 2005, e cila përfshijë qëllime për decentralizimin dhe de-institucionalizimin. Strategjia po implementohet këto dy vitet e fundit.
- Në vitin 2006, Ministria hartoi një dokument të ngjashëm politikash për të ardhmen, në fushën e përfitimeve të asistencës sociale në cash, për të qartësuar politikën e Qeverisë në këtë drejtim. Ky raport i cili përfundoi në qershor 2007, është një tjetër komponent integral i kësaj strategjie.
- Në fund, kjo strategji përmbledh axhendën e politikave për mundësitë e barabarta, që është reflektuar në disa dokumenta strategjikë ndërsektoriale, të përgatitur vitet e fundit, për femijet, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin rom, kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe barazisë gjinore.

Megjithatë sigurimet shoqërore, janë një komponent bazë i mbrojtjes sociale, kjo fushë politikash është paraqitur në një strategji tjetër sektoriale, e cila është përgjegjësi e Ministrisë së Financave, në përputhje me ndryshimet në legjislacionin për sigurimet shoqërore.

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, është një komponent i rëndësishëm i Strategjisë ndërsektoriale të Përfshirjes Sociale, e cila paraqet politikën horizontale të Qeverisë për reduktimin e varfërisë dhe luftën kundër përjashtimit social dhe do të jetë gjithashtu pjesë e pandare e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Programi i buxhetit afat-mesëm të Ministrisë së Punës, do të shërbejë si një plan veprimi tre-vjeçar, për këtë strategji sektoriale.

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, në proces do të rishikohet dhe plotësohet në përputhje me nevojat dhe përvojën që do të krijohen gjatë implementimit të saj, duke reflektuar ndryshimet në politikën bazë të Qeverisë.

Qëllimi i Ministrisë për politikën e mbrojtjes sociale është konvergimi i tyre me konceptet që po adoptohen aktualisht nga vendet anëtare të Bashkimit Europian.

Do të dëshiroja të falënderoja Zëvendësministren znj. Marieta Zaçe, e cila ishte përgjegjëse për koordinimin e gjithë punës për hartimin e strategjisë, anëtarët e grupit teknik, z. Nexhmedin Dumani, z. Thanas Poçi, znj. Elida Erebara dhe znj. Ilda Bozo, për kontributin e tyre. Drafti i Strategjisë u diskutua me aktorët e interesit, grupime dhe organizata të shoqërisë civile, shoqatat e bashkive dhe komunave, dhe donatorë të ndryshëm. Komentet dhe sugjerimet e Departamentit të Bashkëpunimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj të Këshillit të Ministrave ishin një kontribut me vlerë për përmirësimin e dokumentit.

Duke i falënderuar të gjithë aktorët për bashkëpunimin e ofruar gjatë hartimit të këtij dokumenti, i ftojme ata të angazhohen në misionin e përbashkët për jetësimin dhe zbatimin e filozofisë së kësaj Strategjie.

**Koço Barka, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**

## Pasqyra e lëndës

Parathënie .....	2
Pasqyra e lëndës .....	3
Tabela dhe figura .....	4
Hyrje .....	5
1. Situata aktuale .....	7
1.1 Varfëria .....	7
1.2 Grupet në rrezik përjashtimi social .....	14
2. Vizioni, prioritetet strategjike dhe qëllimet strategjike .....	23
3. Politikat .....	30
3.1 Zbutja e varferisë .....	30
3.2 Reformimi i sistemit të shërbimeve shoqërore .....	38
3.3 Mbështetja e grupeve në rrezik nga përjashtim social .....	48
4. Implikimet financiare .....	54
5. Monitorimi .....	61

## Tabela dhe figura

Tabela 1.1	Shkalla e varferise absolute per fryme 2002-2005	8
Tabela 1.2	Shkalla e varferise relative per fryme 2002-2005	8
Tabela 1.3	Karakteristikat e te varferve, 2002-2005	9
Tabela 1.4	Fondet, numri i familjeve dhe masa mesatare për një familje	11
Tabela 1.5	Grupet e personave me aftësi të kufizuar	17
Tabela 3.1	Numri i llogaritur i familjeve të varfëra (2005) dhe numri aktual i familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike (2007) sipas qarqeve	31
Tabela 3.2	Projeksion i masës së ndihmës ekonomike sipas anëtareve të familjes	32
Tabela 3.3	Buxheti, numri i familjeve, dhe masa mesatare e projektuar	33
Tabela 3.4	Treguesit dhe dokumentacioni për identifikimin e familjeve	34
Tabela 3.5	Koeficientet e rinj që do të përdoren për vlerësimin e të ardhurave nga bujqësia dhe blegtoaria	36
Tabela 4.1	Shpenzimet aktuale dhe ato të projektuara sipas programit buxhetor, 2006-2010	54
Tabela 4.2	Produktet kryesore dhe buxheti e programit të mbrojtjes sociale	55
Tabela 5.1	Lista e indikatorëve të strategjisë	62
Figura 1.1	Shpenzime për mbrojtjen sociale si pjesë e PBB-së, 2000-2005	12

## Hyrje

Kalimi në rrugën e ekonomisë së tregut, në vitet '90, u shoqërua me mbylljen e industrive dhe aktiviteteve jorentabel, rritjen e nivelit të papunesisë, varferise dhe emigracionit. Zhvillimet e reja u shoqëruan edhe me thellimin e pabarazive ekonomike dhe sociale dhe krijimin e grupeve dhe individëve të ekspozuar ndaj rrezikut të perjashtimit social.

Për reduktimin e varferise dhe zbutjen e pasojave të saj, për grupet dhe individët në nevojë, u ndërmorën politika të reja për tregun e punës, u dizajnuar një sistem i ri pensionesh dhe u ndërtua një rrjet programesh me pagesa në cash dhe shërbime të perkujdesit shoqëror. Këto programe me kohë janë përmirësuar dhe aktualisht mbulojnë me pagesa dhe shërbime: i) familjet e varfëra dhe individët në nevojë, ii) personat me aftësi të kufizuara, si dhe iii) fëmijët jetimë, të rinjtë, të moshuarit, dhe gratë e vajzat në nevojë.

Rritja ekonomike, alokimi më i mirë i fondeve, migrimi dhe urbanizimi, kanë dhënë një impakt të rëndësishëm në reduktimin e varferise dhe zbutjen e perjashtimit social. Aktualisht, vlerësohet se në nivelin e varferise absolute jetojnë rreth 18% e popullsisë, nga 25% që ishin në vitin 2002. Për reduktimin e varfërisë, ka ndikuar edhe Programi i Ndhmës Ekonomike, pagesa të tjera në cash për personat me aftësi të kufizuara si dhe funksionimi i një rrjeti të ri me shërbime sociale për individët dhe grupet në nevojë.

Programet mbulojnë rreth 110 mijë familje, të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike; mbi 105 mijë persona me aftësi të kufizuara ose afro 3 % të popullsisë, që marrin një pagesë mujore për aftësinë e tyre të kufizuar si dhe kompensohen rreth 250 mijë familje për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Përveç shërbimeve të trashëguara, tashmë kanë filluar të funksionojnë një rrjet i ri shërbimesh të decentralizuara dhe ditore pranë komunitetit.

Qëndrueshmëria ekonomike, fuqizimi i shtetit, rritja e kompetencave të pushtetit vendor, si dhe përgatitjet për plotësimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Karta Sociale Evropiane e Rishikuar, Konventat e ratifikuara, dhe Marreveshja e Stabilizim Asocimit, diktuan nevojën për reformimin e sistemit të pagesave dhe shërbimeve për grupet, familjet dhe individët në nevojë dhe hartimin e Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale.

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, si pjesë e Strategjisë ndersektoriale të Përfshirjes Sociale, parashikon objektiva konkrete për reduktimin e varferise dhe ofrimin e shërbimeve për grupet në nevojë, në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, mbështetet në prioritetet e Programit të Qeverisë, për politikat sociale, reduktimin e varferise, përmirësimin e cilësive të jetesës së grupeve në nevojë dhe fuqizimin e tyre për t'u përfshirë në zhvillimet komunitare.

Reformimi i skemës së ndihmës ekonomike dhe pagesave të tjera, do të mbështetet në identifikimin e nevojave të familjeve të varfëra mbi bazën e treguesve të varferise absolute, mbulimin më të mirë të nevojave me fonde dhe sigurimin e një niveli dinjitoz jetese për familjet, PAK dhe përfitues të tjerë. Në fushën e shërbimeve shoqërore, reforma ka në themel të saj ngritjen e shërbimeve në nivel komunitar, atje ku janë përfituesit dhe lindin nevojat e tyre, për të mbështetur dhe ndihmuar individin, familjen, grupin ose komunitetin që të vet-funksionojnë, të jenë të pavarur dhe të përfshihen si të barabartë me anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Këto zhvillime do të ecin në harmoni me procesin e decentralizimit të kompetencave dhe përgjegjësisë në pushtetin vendor. Decentralizimi synon krijimin e një sistemi shërbimesh, ku individit ndihmohet dhe mbështetet në mjedisin ku ai jeton, duke i respektuar personalitetin, vlerat, aftësitë, veçanësitë, parapëlqimet dhe burimet e tij.

Synimi i Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale, është të sigurojë një politikë të qartë për reformimin e sistemit të pagesave dhe shërbimeve shoqërore, jo vetëm për grupet në nevojë, por për të gjithë shoqërinë. Objektivat kryesorë të saj për pagesat në cash janë: (i) reduktimi i shkallës së varferisë për frymë në 10% të popullsisë deri në 2013, në përputhje me rezultatet e LSMS (Anketa e matjes së nivelit të jetesës së familjes); (ii) përmirësimi i targetimit të përfituesve në skemën e ndihmës ekonomike dhe mbulimi i nevojave të familjeve të varfëra në përputhje me vijën e varferisë absolute, sipas LSMS; (iii) rritja e masës mesatare të ndihmës ekonomike; (iv) kushtëzimi i shpërndarjes së NE me punë komunitare në të gjithë territorin e vendit; (v) përmirësimi i administrimit të subvencionit për energji; (vi) përmirësimi i sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara; (vii) përshkallëzim i pagesave për PAK në varesi të gjendjes dhe kushteve sociale.

Objektivat kryesorë për shërbimet shoqërore, do të jenë: (i) decentralizimi, kalimin e të gjitha shërbimeve rezidenciale brenda vitit 2007 në administrim të njesive; (ii) zgjerimi i llojshmerisë së shërbimeve komunitare dhe mbulimi i të gjitha grupeve me shërbime baze në të gjitha rrethet e vendit; (iii) shtrirja e shërbimeve komunitare deri në vitin 2013 edhe në bashkitë që aktualisht nuk kanë shërbime të tilla; (iv) pilotimi i shërbimit të kujdestarisë 2008-2010 në dy bashki dhe deri në vitin 2013 shtrirja e këtij shërbimi edhe në njesitë e tjera vendore në përputhje me nevojat dhe mundësitë e buxhetit; (v) de-intitucionalizimi, konsolidimi i modelit të shërbimeve "shtëpi -familje" për fëmijet dhe PAK, zgjerimi i këtyre shërbimeve edhe për grupet e tjera sociale (të rinjtë, të moshuarit); (vi) implementimi i standardeve të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për fëmijet, PAK, të moshuarit; (vii) inspektimi dy herë në vit të të gjitha shërbimeve të perkujdesit rezidencial dhe ditor që ofrohen nga operatorët publik dhe privat; (viii) licensimi i ofruesve të rinj dhe rilicensimi periodik i të gjitha OJF që ofrojnë shërbime të perkujdesit.

Në Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale, janë rivlerësuar dhe koordinuar edhe objektivat që përcaktohen në dokumenta të tjera ndërsektoriale si: (i) Strategjinë Kombëtare të Fëmijëve, (ii) Strategjinë për Personat me Aftësi të Kufizuara, (iii) Strategjinë Rome, dhe (iv) Strategjinë për Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje.

Strategjia është e strukturuar në pesë kapituj kryesorë: analiza e situatës; vizioni, qëllimet dhe prioritetet strategjike; politikën, ku paraqiten objektivat dhe mënyrat e arritjes së tyre; parashikimi i kostove financiare dhe auditimi i përdorimit të fondeve; si dhe mekanizmi i monitorimit.

Zbatimi i Strategjisë, kërkon angazhimin e strukturave në varësi të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, përgjegjëse për pagesat dhe shërbimet shoqërore, strukturave të qeverisjes vendore si partnere kryesore për zbatimin e programeve sociale, si dhe organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë, mbrojnë dhe ofrojnë shërbime për grupet në nevojë.

## 1. Situata aktuale

Tranzicioni nga ekonomia socialiste ne ekonomine e tregut solli, jo vetem liri por edhe mundesi te reja shoqeruar me kosto te larte. Per shumicen e popullsisë, pershtatja me sfiden e re per sigurimin e jeteses nuk ishte e thjeshte. Tashme nuk kishte me pune te garantuar, u hoq subvencioni i cmimeve per produktet e konsumit, dhe sherbimet publike pushuan se ekzistuari per shkak te pakesimit te te ardhurave buxhetore. Qeverite e para demokratike ne Shqiperi luftuan te mbronin familjet nga keto risqe, sepse keto ishin te pamesuara me problemet sociale dhe u mungonte eksperienca per tu pergjigjur me politikat e duhura. Sidoqofte, rezultate ekonomike ne rritje, te mbeshtetura dukshem ne remitancat e shqiptareve te cilet emigruan jashte vendit, ndihmuan ne reduktimin e ekspozimit ndaj ketij risku. Ne fakt, reagimet individuale ndaj pasigurise subjektive mbi situaten ekonomike ne vend tregojne qe Shqiptaret kane nje kendveshtrim pozitiv. Kjo i ben ata te vecante ndaj vendeve fqinje te Ballkanit Perendimor, ku eshte krijuar perceptimi per nje situatë stanjacioni e cila eshte rrjedhojë reagimit ndaj problemeve te njejta.

Sidoqofte, varferia mbetet shqetesimi i politikës dhe shkalla e varferise eshte nga me te lartat ne Europe. Grupe te identifikueshme te popullsisë jane te perjashtuar nga shoqeria ne lidhje me "llojet e ndryshme te deprivimit dhe pengesave, te cilat vetem apo se bashku, pengojne pjesemarrjen e plote ne fusha si papunesia, arsimi, shendetsia, strehimi, kultura, aksesimi ne te drejten e perfitimit te mbeshtetjes familjare, si dhe te mundesive te trainimit dhe punesimit". Instrumentat kryesore politike qe ka ne dispozicion qeveria per te ndihmuar ata njerez qe jane goditur me shume nga tranzicioni, dhe per te ndihmuar grupe te vecanta shoqerore te rrezikuara nga perjashtimi social, si dhe sfidat qe has ne permiresimin e efektivitetit te ketyre instrumentave, pershkruhen ne kapitullin e meposhtem.

### 1.1 VARFËRIA

Te ardhurat e medha nga emigracioni paten nje ndikim te madh ne popullate ne percaktimin e vendbanimit sepse, ne pjesen me te madhe te vendit, shume njerez u larguan nga fshatrat e tyre per tu vendosur ne qytete apo jashte Shqiperise. Per rrjedhoje, nuk ekziston nje grup perfaqesues i shoqerise nga i cili te percaktohet tendeca e varferise ne vitet e para te tranzicionit. Rezultate e Censurit te 2001 bene te mundur seleksionimin e nje grupi i cili u perdor si baze per Anketen e Matjes se Nivelit te Jeteses (LSMS). Anketa u bazua tek familja dhe u organizua nga Instituti i Statistikes per periudhen 2002-2005. Ky vezhgim, ne te cilin jane intervistuar rreth 3,600 familje, ka sherbyer dhe si mjete kryesor per monitorimin e tendences se varferise keto vitet e fundit.

Indikatorët e varferise ne Shqiperi bazohen ne vleresimin e konsumit dhe jo ne te ardhurat, sepse informacioni mbi te ardhurat nuk eshte shume i sakte ne krahasim me informacionin mbi konsumin. Vija e varferise absolute percaktohet ne raport me nje shporte me artikuj ushqimore (dhe jo-ushqimore) duke lehtesuar krahasimin ne kohe dhe ndermjet grupeve te popullsisë. Varferia absolute, e matur mbi bazen e nje konsumi real mujor per fryme nen 4891 lek me cmimet e vitit 2002, ka rene nga 25.4% ne 2002 ne 18.5% ne 2005. Varferia absolute ekstreme, e matur mbi bazen e nje konsumi real mujor per fryme nen 3041 lek me cmimet e vitit 2002 per te arritur edhe ate pjese te popullsisë e cila do ta kishte te veshtire edhe plotesimin e nevojave baze ushqimore, ka rene nga 4.7% ne 3.5%.

Kjo renje e konsiderueshme e varferise per nje periudhe te shkurter kohe eshte rezultat i ritmeve te larta te zhvillimit te vendit ne vitet e fundit. Sidoqofte, ritmet dhe tendecat e varferise nuk jane njesoj ne te gjithe vendin. LSMS jep vleresime te besueshme per zonat rurale dhe urbane te kater rajoneve te medha te vendit: Tiranës, bregdetit, pjeses qendrore dhe malore. Tabela 1.1 permblesh shkallen e varferise absolute per secilen nga keto zona. Shkalla e varferise ne zonat malore, te cilat jane shumica rurale dhe ku varferia eshte shume e larte ne krahasim me pjeset e tjera te vendit, ka rene me shpejtesi. Te dhenat tregojne se kjo pjeserisht

mund t'i atribuohet faktit qe familjet e ketyre zonave kane marre nivelin me te larte mesatar te remitancave. Megjithate, ne pergjithesi, varferia eshte perqendruar me shume ne zonat rurale midis 2002 dhe 2005. Kjo vjen per shkak te prapambetjes se sektorit bujqesor dhe pamundesise per te siguruar te ardhura alternative.

**Tabela 1.1 Shkalla e varferise absolute per fryme (%), 2002-2005**

	Varferia absolute, 2002	Varferia absolute, 2005	Varferia absolute, ekstreme, 2002	Varferia absolute, ekstreme, 2005
Bregdeti	20.6	16.2	3.6	2.2
Pjesa Qendrore	25.6	21.2	4.6	5.2
Pjesa malore	44.5	25.6	10.8	3.2
Tirana	17.8	8.1	2.3	1.0
Zona te tjera urbane	20.1	12.4	4.8	2.7
Rurale	29.6	24.2	5.2	4.5
<b>Totali</b>	<b>25.4</b>	<b>18.5</b>	<b>4.7</b>	<b>3.5</b>

Burimi : Anketa per Matjen e Nivelit te Jeteses

Kufijte e varferise relative, qe preferohen nga Bashkimi Europian per matjen e varferise, pasqyrojne shkallen e privimit ne lidhje me te ardhurat e pjese tjeter te popullsisë. Masa me e perdorur eshte e ashtu-quajtura shkalla e rrezikut-nga-varferia, e cila tregon pjesen qe u takon individeve qe jetojne ne nje familje qe konsumon me pak se 60% e medianes kombetare. Keto masa jane me te ndjeshme ndaj ndryshimeve dhe kjo perputhet me rezultatet e Tabeles 1.2, e cila sygjeron qe shkalla e varferise relative ka nje rritje mesatare nga 2002 ne 2005.

**Tabela 1.2 Shkalla e varferise relative per fryme (%), 2002-2005**

	Varferis relative, 2002	Varferia relative, 2005
Bregdeti	11.3	14.1
Pjesa qendrore	14.3	20.0
Pjesa malore	23.9	20.4
Tirana	9.1	7.5
<b>Totali</b>	<b>13.9</b>	<b>16.6</b>

Burimi : Anketa per Matjen e Nivelit te Jeteses

Koeficienti Gini, i cili mat masen ne te cilen ndryshon shperndarja aktuale nga shperndarja e barabarte, eshte rritur lehtesisht nga 0.28 ne 0.29. Kjo eshte shume mire e krahasueshme me mesataren e BE (0.31) por duhet te marret parasysh se te dhenat per Shqiperine i referohen pabarazise se konsumit, qe ka tendence te kete nje shperndarje per te drejten e te ardhurave.

Ne nje rast te tille, reduktimi i varferise do te kishte qene me i shpejte nese nuk do te kishte patur rritje te pabarazise dhe faktit qe nje pjese e popullsisë se varfer nuk perfituan nga zhvillimi ekonomik. Nje gje e tile u vu re kryesisht ne zonat bregdetare dhe qendrore. Nder masat standarte te pabarazise, pjesa e konsumit total nga 20% i popullsisë me te varfer pesoi renie nga 12.7% ne 8.2% nga 2002 ne 2005.



Ne kushtet e Shqiperise, si indikatorët e varferise absolute dhe at ate varferise relative jane te rendesishem sepse na japin nje panorama me te gjere te ndryshimeve per statusin e asistences sociale te popullsisë.

Analiza e te dhenave te LSMS 2002-2005 tregon se varferia shoqerohet me karakteristika specifike demografike (Tabela 1.3). Per shembull, familjet me te varfera jane me te zgjeruara numerikisht, kane me shume femije, dhe kane me shume probabilitet per te patur pjesetare te papune. Ne vecanti, raporti i varesise, pra raporti mes anetareve te familjes nga 0-14 vjec dhe I anetareve te familjes 60 vjec e lart ne krahasim me anetaret e familjes te moshes 15-59, eshte shume meil larte ne familjet e varfera. Per me teper, te varferit kane me pak akses ne sherbimet baze si shkollat, qendrat shendetsore, telefonat, ujë, higjenë etj.

**Tabela 1.3 Karakteristikat e te varferve, 2002-2005**

	2002			2005		
	Jo varfër	të	Të varfër	Jo varfër	të	Të varfër
Madhesia mesatare e familjes	4.0		5.7	4.0		5.5
Familje me kryefamiljare gra (%)	13.1		9.3	11.7		8.1
Te moshes 60 e lart (%)	19.7		10.2	14.7		9.8
Numri i anetareve nen 15 vjec	1.0		2.1	0.9		1.9
Raporti i varesise	0.8		1.1	0.7		1.0
Te papune (%)	5.0		8.7	3.4		4.8
Te dekurajuar, sezonale dhe pushuar nga puna (%)	3.6		5.3	3.4		4.2
Vitet e shkollimit te kryefamiljarit	7.9		6.2	9.8		8.0
Rregjistrimi neto ne arsimin fillor (%) <sup>3</sup>	94.1		91.6	92.3		82.8
Rregjistrimi neto ne shkollen e mesme (%)	46.7		19.4	53		23.9
Distanca nga qendra shendetsore: nje ore ose me shume (%)	1.0		9.2	5.6		12.7
Popullimi: me shume se 3 persona per dhome (%)	20.3		48.6	18.7		44.9
Akcesi ne telefonine fikse (%)	25.2		7.1	27.2		5.8
Akcesi ne telefonine celulare (%)	46.9		15.9	83.9		64
Uje i rrjedhshem ne shtepi (%)	55.7		32.7	58		31.5
Tualet jashte shtepise dhe pa tubacione (%)	68.0		41.4	73.9		45.8
Pa korrent per 12 ore ne dite ose me shume, ne 24 ore (%)	12.5		16.1	1.5		3.0

Burimi : Anketa per Matjen e Nivelit te Jeteses

### Pagesat ne kesh për zbutjen e varfërisë

Qeveria ka ndërtuar një sistem të mbrojtjes sociale për zbutjen e pasojave të varfërisë, per te lehtësuar plotesimin e nevojave baze jetike.

Programi kryesor i pagesave ne kesh eshte ndihma ekonomike, e cila mbeshtet familjet me te ardhura te pakta ose pa te ardhura. Sipas ketij programi, pushteti qendror, ne baze te kerkesave per fonde, u shperndan bashkive dhe komunave bllok grante te kushtezuara per mbulimin e nevojave te familjeve te varfera. Njesite e qeverisjes vendore i administrojne keto fonde nepermjet marrjes dhe kontrollit te aplikimeve sipas rregullave qe percakton pushteti qendror per pranimin dhe perfitimin e ndihmes ekonomike (megjithatë pushteti vendor ka të drejtë të vendose kritere të veçanta për të mbështetur familjet e varfëra nga burimet e veta).

Rregullat e pranimit ne skemen e ndihmes ekonomike, perfshin nje numer dokumentash ku vertetohet niveli i te ardhurave nga aktiviteti, pronat, biznesi, dhe punesimi si dhe disa tregues te tjere alternativ qe vleresojne gjendjen sociale ekonomike te familjes. Per shembull nuk duhet te kete anetare te familjes te punësuar, në emigracion ose që zotërojnë prona, pasuri apo mundesi per gjenerim te ardhurash.

Rregullat e perfitimit te ndihmes ekonomike kane patur nje tavan te percaktuar sa 2.5 here te nivelit te pageses baze te papunesise per cdo familje perfituese. Perfitimi i ndihmes ekonomike bazohej ne strukturen e familjes: (i) kryefamiljari merrte 95% e pagesës bazë së papunësisë; (ii) të moshuarit dhe anëtarët me aftësi të kufizuara merrnin 95% të pagesës bazë të papunësisë; (iii) anëtarët nën moshën e punës merrnin 25% të pagesës së kryefamiljarit dhe (iv) anëtarët në moshë pune 20% te pagesës së kryefamiljarit. Familjet me te ardhura te pakta, mund te perfitonin nje pagese te pjesshme.

Ne praktike, mekanizmi i vleresimit te varferise, identifikimi i familjeve dhe shperndarja e ndihmes ekonomike kane problemet e meposhtme:

- Identifikimi i familjeve të varfëra
  - Informacioni për popullsinë sipas gjendjes civile që përdoret si bazë për llogaritjen e ndihmës ekonomike për çdo familje është i pasaktë sepse nuk reflekton emigracionin. Në regjistrat e gjendjes civile, ndodh që një pjesë e popullsisë të migruar nuk është çregjistruar nga komuna e tyre e origjinës, ndonëse ato janë vendosur në komunën pritëse. Meqenëse rezidenca është kriter për të përfituar ndihmën ekonomike këto persona mund të mos e përfitojnë ndihma ekonomike ose e përfitojnë atë në dy njësi njëherësh.
  - Legjislacioni përcakton disa kriteret dhe dokumenta që duhet të plotësojnë aplikantët për të vërtetuar mungesën e të ardhurave nga puna, prona dhe aktivitete të tjera, por edhe të dhënat e tyre nuk dëshmojnë realisht nivelin e varfërisë. Dokumentacioni që përdoret aktualisht për të identifikuar familjet, plotësohet me vështirësi: (i) nëntë dokumenta dhe certifikata shpesh të noterizuar nga shtatë zyra rajonale kërkohen për tu plotësuar; (ii) në këtë proces ka edhe presione për pagesa dhe transaksione të paligjësme; dhe (iii) subjektivizmi dhe gabimet në plotësimin e dokumentave ballafaqohet edhe me mungesën e kapaciteteve dhe lëvizjet e shpeshta të administratorëve lokalë.
  - Masa e ndihmës ekonomike për familje nuk përcaktohet mbi bazën e nivelit të varfërisë. Vija zyrtare e varfërisë është përcaktuar sipas të dhënave të anketës LSMS por ka mospërputhje me treguesit dhe të dhënat administrative që përdoren aktualisht për vlerësimin e nevojave për fondet e ndihmës ekonomike.
- Identifikimi i familjeve është bërë sipas kriterëve ligjore dhe dokumentacionit që dëshmon për nivelin e të ardhurave të familjeve. Pra nuk ka patur një referencë të caktuar për nivelin e varfërisë për të bërë të mundur llogaritjen e përqindjes së popullsisë nën vijën e varfërisë. Masa e ndihmës ekonomike (jo më shumë se 6500 lekë në muaj për familje) ka shërbyer si vijë varfërie, por vlerësimi i të ardhurave nuk bëhej mbi kriteret shkencore por mbi disa tregues alternativë apo në plotësimin e disa dokumentave që shpesh përmbajnë pasaktësi dhe shkallë të lartë informaliteti.
- Llogaritja e bllok ndihmës për njësitë e qeverisjes vendore mbështetet (i) në informacionin për popullsinë që disponojnë zyrat e gjendjes civile; dhe (ii) në të dhënat që lidhen me punësimin në sektorin publik apo privat, pagesën e papunësisë, pensionet, emigracionin, dhe të ardhurat nga toka apo blegtoaria. Ky informacion nuk krijon mundësi për të matur nivelin real të varfërisë. Formula aktuale e llogaritjes së granteve të ndihmës ekonomike nuk është e saktë. Harta e varferise e bazuar ne te dhena te detajuara te Censurit te 2001 dhe LSMS 2002 identifikoi nje numer te madh te njësive të qeverisjes vendore qe perfitonin grante qe nuk perputheshin me shtrirjen e varferise.

- Problemi kryesor i programit është se mbulimi dhe nivelet e pagesave janë të ulëta, çka ka bërë që efekti i programit të ndihmës ekonomike në uljen e varfërisë të jetë shumë i vogël. Pagesa mesatare është e barabartë me më pak se 15% e kufirit të varfërisë. Pagesa mesatare mujore e ndihmës ekonomike të plotë për një familje në vitin 2005 ishte 2.689 lekë, ndërkohë që ndihma ekonomike e pjesëshme në zonat rurale ishte 1.935 lekë; për rrjedhojë, përfituesve u duhet të gjejnë burime të tjera shtesë për mbështetje. Pagesa e ndihmës ekonomike nuk u korrektohet asnjëherë me rritjen që ka pësuar pagesa bazë e papunësisë. Fondet e akorduara në këto 7-8 vitet e fundit plotësonin vetëm 40%-60% të nevojave ligjore. Po të ndiqej kriteri i llogaritjes së ndihmës ekonomike sa 250% e pagesës bazë të papunësisë së vitit 2005, niveli maksimal i ndihmës ekonomike do të ishte 13100 lekë. Pas vitit 2005, mekanizmi i llogaritjes së ndihmës ekonomike nuk lidhet më me pagesën e papunësisë, por me një masë fikse, brenda disa kufijve, që përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, me prirje drejt pensionit minimal, por edhe në varësi me burimet e buxhetit të shtetit. Kufiri maksimal i masës së përfitimit të ndihmës ekonomike u rrit nga 6500 lekë në 7000 lekë në muaj, ndërsa kufiri minimal i ndihmës ekonomike nga 500 lekë në 800 lekë në muaj. Masa e ndihmës ekonomike, për kryefamiljarin dhe për personat mbi moshë punëu bë 2600 lekë në muaj, ndërsa për personat në moshë pune dhe nën moshë pune u bë respektivisht 600 dhe 700 lekë në muaj.

Dinamika e disbursimit të fondeve për ndihmen ekonomike dhe numri i familjeve përfituese paraqitet në Tabelen 1.4. Gjate kesaj periudhe, numri i perfituesve ka rene me 25%. Masa mesatare e pageses gjithashtu ka rene kohet e fundit.

**Tabela 1.4 Fondet, numri i familjeve dhe masa mesatare për një familje**


Viti	Fondet e programuara Miliard lekë	Numri i familje në ndihmen ekonomike Mije	Ndihma ekonomike mesatare Lekë
2000	4.4	150	2453
2001	4.2	142	2445
2002	4.2	135	2591
2003	4.0	130	2544
2004	4.0	124	2662
2005	3.2	118	2244
2006	2.8	112	2052

Burimi: Përpunuar nga të dhënat administrative të MPÇSSHB.

Ne fakt, që nga 2002, alokimi i fondeve për ndihmen ekonomike ka rene nga 0.8% në 0.4% të GDP. Kjo renie është në kontrast të plotë me dy tendencat opozitare të koheve të fundit:

- Ka rritje të shpenzimeve për sigurimet shoqërore. Pensionet publike kanë një mbulim më të madh se ndihma ekonomike përse i përket numrit të familjeve të varfëra që janë në skemë. Për këtë shkak dhe për shkak të madhësisë mesatare të tyre, pensionet përbejnë kontributin më të spikatur ndër të gjitha transfertat publike, në reduktimin e varfërisë.
- Megjithatë shpenzimet për asistencën sociale në përgjithësi, kanë rene, ka një rritje të shpejtë të shpenzimeve për programin e pagesës së aftësisë së kufizuar, i cili përshkruhet në detaje më të hollësishme në Seksionin 1.2. Aktualisht, pagesa mesatare për aftësinë e kufizuar është dy herë më e lartë se pagesa mesatare për ndihmen ekonomike dhe buxheti i deritanishëm për personat me aftësi të kufizuar e kalon ndjeshëm fondet e destinuar për ndihmen ekonomike.

Figura 1.1 Shpenzime për mbrojtjen sociale si pjesa e PBB-së, 2000-2005



Shënim: 'Ndihmat sociale të tjera' përfshijnë përfitime për aftësi të kufizuar dhe shpenzime për institucionet e kujdesit social.

Burimi: Rishikimi i shpenzimeve publike dhe institucioneve në Shqipëri

Vlerësimi më i fundit i efektshmërisë së programit të ndihmës ekonomike i cili bazohet tek LSMS 2005, arriti në konkluzionet e mëposhtme:

- Ka patur rënie të mesatare të fondeve për njësitë e pushtetit vendor nga 1,000,000 leke (2000) në 740,000 leke (2006) (një ulje prej 29%) sidomos në Tiranë dhe zonat bregdetare.
- Reduktim gradual i numrit mesatar të përfituesve për çdo njësi lokale nga 400 (2000) në 310 (2006) (një ulje prej 22%) që është aplikuar për përfituesit e pagesës së plote dhe të asaj të pjesshme.
- Ka ndryshime të mëdha të pagesës mesatare për çdo familje përfituese nga një rajon në tjetrin.
- Vlera e pagesës mesatare për çdo familje përfituese ka mbetur konstante (nga 2170 leke në 2000 në 2113 leke në 2006) por kjo ka ardhur për shkak të një rritje të madhe në vitin 2006.
- Përsa i përket mbulimit:
  - Masa për familjet e përfshira është 33% për zonat malore por 3% për Tiranën.
  - Masa për familjet më të varfëra të përfshira, u rrit nga 24.6% (2002) në 32.5% (2006); masa varion nga 45% në zonat malore në 20% në Tiranë dhe 10% në zonat bregdetare.
  - Masa për familjet në varferi ekstreme u rrit nga 30% (2002) në 50% (2006).
- Në lidhje me humbjet:
  - Masa e familjeve jo-të varfëra që e përfitojnë pagesën u rrit nga 57% (2002) në 64% (2005), sidomos në zonat malore dhe bregdetare.
  - Si përfundim, megjithatë ky është programi kryesor kundër varfërisë, ndihma ekonomike ka një ndikim relativisht të ulët tek varferia, meqë mbulimi që ajo siguron dhe pagesa mesatare janë shumë të vogla. Buxheti nuk financon pagesën e plote që duhet të marrin njëzëritë e cila për më tepër është në rënie.

Disa njësi vendore kanë pilotuar kushtëzimin e ndihmës ekonomike me punë komunitare nëpërmjet projekteve me kohë të plotë pune ose të pjesëshme disa ditë në muaj. Në të dyja format e angazhimit në punë, familjet që nuk pranojnë të marrin pjesë në punët komunitare, largohen nga skema e ndihmës ekonomike.

Në projektet me kohë të plotë pune, thirren në punë vetëm një pjesë e anëtarëve të aftë nga familjet në ndihmen ekonomike, kundrejt një pagese sa paga minimale në shkallë vendi si dhe sigurimet shoqërore. Pagesa mbulohet nga pjesa e fondeve të ndihmës ekonomike që u përkasin familjeve pjesëmarrëse, ndërsa pjesa tjetër e pagës, deri në nivelin e pagës minimale, plotësohet nga fondet e bashkisë apo komunës. Projektet me kohë të plotë në fazën pilot u mbështetën me fonde shtesë nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Këto projekte dhanë një impakt 10-20% në uljen e numrit të familjeve në skemë. Por kjo formë u ballafaqua me disa kufizime që lidhen me vështirësitë për gjetjen e fronteve të qëndrueshme të punës, garantimin e fondeve deri në nivelin e pagës minimale dhe aplikimin e saj mund të shtrihen vetëm për një numër të vogël pjesëmarrësish. Në thelb kjo formë është një program punësimi dhe mund të zbatohet vetëm në ato bashki që kanë burime të mjaftueshme nga taksat lokale.

Në projektet me kohë të pjesëshme, disa ditë në muaj, thirren në punë të gjithë anëtarët e aftë të familjes që përfitojnë ndihmë ekonomike. Pagesa është e barabartë me masën e ndihmës ekonomike që i takon familjes pjesëmarrëse në përputhje me strukturën e anëtarëve të saj. Impakti i kësaj forme në fazën e pilotimit ishte më i ndjeshëm. Rreth 35-40% e familjeve, nuk pranuan të marrin pjesë në punë dhe si rezultat u larguan nga programi i asistencës ekonomike. Fondet e lira i përfituan familjet e tjera që morën pjesë në punët komunitare.

Për të mbrojtur familjet e varfëra nga rritja e çmimit të energjisë elektrike në vitin 2003 filloi implementimi i skemës të kompensimit të çmimit të energjisë. Zbatimi në praktik i skemës nuk e dha impaktin e synuar. Vetëm 37,000 ose 20% e familjeve u përfshinë në skemë dhe e përfituan rimbursimin për rritjen e çmimit të energjisë, nga 191,500 familjet gjithsej që ishte parashikuar të përfitonin nga ky program. Programi nuk i nxiti familjarët e varfër për të paguar faturat e energjisë. Norma e mospagesës nga familjet e varfëra ishte dy herë më e lartë se sa norma e mospagesës nga familjet jo të varfëra. Mekanizmi administrativ i skemës u ballafaqua edhe me probleme. Lista e përfituesve me numrin e kontratës së energjisë përputheshin vetëm në masën 25% me të dhënat që dispononin KESH. Koha e prodhimit dhe shpërndarja e informacionit midis institucioneve përgjegjëse për implementimin e kësaj skeme (njësitë vendore, ISSH, SHSSH dhe KESH) bëhej me vonesë dhe krijonte vështirësi për disbursimin e fondeve.

Politika u përmirësua më tej në qershor të vitit 2006, me synim rritjen e masës së subvencionit dhe zgjerimin e grupeve përfituese për mbrojtjen e tyre nga rritja e mëtejshme e çmimit të energjisë elektrike.

- Për 200 KWh e parë të konsumuar masa e kompensimit është 500 lekë në muaj sipas kriterit për një familje, një kontratë me KESH-in. Tarifa e re mbulon 36% të rritjes së çmimit të energjisë elektrike për të gjitha kategoritë e mësipërme, nga 9% që mbulonte më parë.
- Subvencioni mbulon disa grupe përfituesish si:
  - familjet, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuara, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-it: subvencioni është bërë pjesë e listës së pagesës së ndihmës ekonomike që merret në njësinë vendore;
  - kryefamiljarë që përfitojnë pension invaliditeti, shtetëror dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetpunësuar në sektorin privat: subvencioni

pasqyrohet në një kolonë të veçantë në listpagesën e aftësisë së kufizuar për këtë kategori pranë njësisë vendore;

- kryefamiljarë që përfitojnë pension pleqërie shtetëror dhe jetojnë të vetëm ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët nuk kanë të ardhura: subvencioni është bërë pjesë në listpagesën e marrjes së pensionit në një kolonë të veçantë;
  - familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35,000 lekë në muaj: subvencioni është përfshirë si zë i veçantë në listpagesën e institucionit përkatës
- Në këto kushte u përmirësuan kriteret dhe dokumentacioni për identifikimin e përfituesve të subvencionit të energjisë elektrike:
- përfituesit, përcaktohen nga institucionet ku ato marrin pagën, pensionin apo pagesat nga programet e ndryshme sociale;
  - konsumi i energjisë elektrike, faturohet nga KESH-i, për të gjithë sasinë e energjisë së konsumuar nga familjet përfituese;
  - klientët, familjet përfituese të subvencionit e paguajnë të gjithë detyrimin sipas faturës dhe mbas këtij momenti paraqiten për të tërhequr subvencionin;
  - familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike apo me pagesë për aftësinë e kufizuar deklarojnë detyrimet e prapambetura për energjinë;
  - personat me aftësi të kufizuar deklarojnë se në familjen e tyre nuk kanë punonjës buxhetorë apo nuk marrin ndihmë ekonomike etj.

## 1.2 GRUPET NË RREZIK PËRJASHTIMI SOCIAL

Analiza e rezultateve të LSMS 2002-2005 (Tabela 1.3) mbi bazën e një vëzhgimi në rang kombëtar të familjeve të perzgjedhura, japin një ide të qartë mbi karakteristikat e familjeve dhe grupet sociale të varfëra. Natyrisht kjo duhet plotësuar me një informacion më të detajuar për përjashtimin social dhe pasojat që përjetojnë grupet e ndryshme: studime kanë evidentuar, në mënyrë të pavarur, grupe kryesore të individëve të ekspozuar ndaj rrezikut të cilat kanë nevojë për mbështetje me shërbime sociale. Këto grupe, aktualisht mbështeten nga legjislacioni ekzistues dhe nga programe të shërbimeve publike dhe jopublike. Në këto mënyra tabloja e varferisë bëhet më e plotë dhe masat që po merren për zbutjen e varferisë, si përfshirja, parandalimi, rehabilitimi dhe integrimi, po bëhen më efektive.

### Fëmijët

Fëmijët, për shkak të moshës, të pjekurisë fizike dhe intelektuale, janë kategoria më e ekspozuar ndaj rreziqeve, prandaj ato kanë nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë nga familja, shoqëria dhe institucionet shtetërore. Mbështetur në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, mbrojtja, promovimi dhe realizimi i të drejtave të fëmijëve ka qenë një nga prioritetet kryesore të politikave dhe veprimtarisë së MPÇSSH. Gjate periudhës së tranzicionit, Shqipëria ka bërë progres në drejtim të fëmijëve por shumë prej tyre mbeten të papërfshirë dhe të padukshëm. Në vitin 2005, 245 000 fëmijë jetonin nën vijën e varferisë absolute (LSMS 2005). Rritja ekonomike ka çuar në pakesimin e fëmijëve që jetojnë në varfëri deri në 34 për qind që nga viti 2002.

### Fëmijët jetimë apo me probleme sociale që jetojnë në institucione rezidenciale

Politika për mirërritjen dhe mbrojtjen e fëmijëve bazohet në parimin themelor që ata duhet të rriten në një mjedis të sigurt dhe familjar dhe mundësisht fëmijët të rriten në familjet e tyre natyrore. Në rastet kur nuk realizohet kjo, ata duhet të rriten në siguri dhe të mbrojtur nga

abuzimet kudo që ndodhen në përkujdesjen zëvendësuese. Duke u mbështetur në traditën shqiptare, kujdesi dhe shërbimet për fëmijët jetimë në të shumtën e rasteve ofrohen nga pjesëtarë të familjes ose të afërm të jetimit.

Një numër relativisht i vogël fëmijësh vendoset në qendrat rezidenciale të shërbimeve sociale; në familjet sociale, nëpërmjet birësimit; dhe kohët e fundit ka filluar të zbatohet nga disa OJF edhe shërbimi i kujdestarisë. Veç fëmijëve jetimë, ka edhe fëmijët e tjerë që për arsye ekonomike ose shoqërore nuk mund të jetojnë pranë familjeve biologjike, por vendosen dhe përfitojnë shërbime në insitucionet rezidenciale. Aktualisht për fëmijët ekzistojnë 9 institucione ku ofrohen shërbime rezidenciale për moshat 0-3 vjeç, 3-6 vjeç dhe 6-14 vjeç. Në përputhje me statistikat administrative rreth 349 fëmijët jetimë jetojnë në institucione rezidenciale publike, dhe rreth 200 fëmijë jetojnë në qendrat rezidenciale jopublike. Në këto institucione ofrohen shërbime sipas disa standardeve, të cilat kohët e fundit janë përmirësuar si rezultat i asistencës së eksperteve apo donatorëve dhe OJF-ve. Problemet që evidentohen:

- Shërbimet nuk arrijnë standardet e cilësisë dhe janë larg jetës së fëmijës në familje.
- Fëmijët janë të papërgatitur për jetë të pavarur pas moshës 18 vjeç. Nuk janë të siguruar me strehim dhe punë pas mbarimit të shkollës. Nuk ka informacion të saktë e ndjekje pas daljes nga institucioni.
- Fëmijët e rritur në institucione dallohen për një shkallë më të ulët të zhvillimit intelektual, e cila reflektohet në rezultatet e ulta në mësim. Nuk mbahet parasysh dëshira e fëmijëve në zgjedhjen e shkollës apo të profesionit. Një numër i vogël arrijnë të vazhdojnë shkollat e larta.
- Janë më të rrezikuar nga abuzimi seksual, shtatzania e hershme dhe përfshirja në rrjetet e trafikut dhe të prostitucionit.
- Lëvizja e shpeshta të fëmijëve nga një institucion në tjetrin për shkak të specializimit të institucioneve sipas grupmoshave dhe shpërndarjes së tyre në qytete të ndryshme.
- Duhet zbatuar politika nxitëse për birësimet dhe ndjekur me kujdes fati i të birësuarve brenda dhe jashtë vendit
- Stafet e institucioneve rezidenciale nuk kanë kapacitetet e domosdoshme për të ndjekur dhe stimuluar rritjen, zhvillimin psikologjik dhe emocional të fëmijëve, modelet e sjelljes dhe problemet e aftësisë së kufizuar.
- Infrastruktura e institucioneve ka mangësi në orëndi dhe pajisje, duke përfshirë pajisje speciale për rehabilitimin fizik të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

## Fëmijët e tjerë në nevojë që nuk jetojnë në institucione rezidenciale

Problemet që evidentohen:

- Një pjesë e fëmijëve jetimë përfitojnë pension familjar dhe jetojnë me prindin ose me të afërmit, por ka edhe raste që fëmijët nuk përfitojnë pension, sepse prindi/prindërit, nuk kanë qenë të siguruar dhe në këto kushte fëmija nuk ka mbështetje ekonomike.
- Mungojnë struktura në nivel vendor për identifikimin dhe grumbullimin në terren të të dhënave të fëmijëve të rrezikuar dhe fëmijët jetimë që nuk jetojnë në institucione për ndërmarrjen e veprimeve mbrojtëse.
- Mangësi në programe për mbështetjen e familjeve me shumë fëmijë, fëmijë me aftësi të kufizuar ose me probleme të mëprehta sociale, me punësimin, trajnimin profesional, ndihmë ekonomike të veçantë etj.
- Mungojnë shërbimet alternative për fëmijët që nuk u krijohen kushtet e nevojshme në familjet biologjike, si shërbimi i kujdestarisë, mbështetja ekonomike e të afërmeve që

kujdesen për fëmijë jetimë, familjet pritëse dhe birësuese, shërbime të tipit shtëpi familjeve etj.

- Nuk ka një sistem mbikqyrje, supervizimi mbi familjet kur vërehen raste neglizhence, abuzimi e dhune ndaj fëmijës dhe nuk merren masa për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Nuk zbatohen masat ndaj prindërve që braktisin fëmijët, apo nuk i dërgojnë ata në shkollë, i detyrojnë të punojnë. Aktualisht për këto grupe ofrohen disa shërbime ditore nga OJF-të, të cilat mbështetin vazhdimin e shkollës por këto shërbime nuk janë të mjaftueshme.

## Fëmijët e trafikuar

Trafikimi i fëmijëve është një fenomen shqetësues, që sjell pasoja të rënda fizike, emocionale dhe psikologjike me rrezik për të ardhmen e fëmijëve. Për të luftuar kundër trafikimit të fëmijëve është bashkëpunuar me OJF-të në disa drejtime:

- Fushata sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi në shkolla, komunitet, në media
- Identifikimi i fëmijëve të rrugës dhe në rrezik trafikimi dhe mbështetje materiale për familjet e varfëra dhe me probleme shoqërore
- Tërheqja e fëmijëve që nuk vazhdojnë shkollën në kurse të formimit profesional
- Rikthimi i asistuar të fëmijëve duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës
- Mbështetje për integrimin e tyre në familje apo në qendra pritëse dhe integruese publike dhe jopublike.

Në vitin 2003, u ngrit një qendër publike e pritjes dhe strehimit të vajzave, grave dhe fëmijëve të trafikuar. Në këtë qendër janë trajtuar fëmijët që riatdhesohen, deri në bashkimin e tyre me familjen ose sigurimin e alternativave të përkujdesit në përputhje me interesin më të lartë të tyre. Gjithashtu qendra ka pritur dhe mbështetur edhe fëmijë nga vendet fqinje. Mjaft fëmijë janë rikthyer pranë familjeve, por në disa raste ata janë ricikluar përsëri në trafikim.

Veç fëmijëve të trafikuar ose në rrezik trafikimi, është edhe një grupim fëmijësh, kryesisht moshat nga 14-18 vjeç që dërgohen nga familjet për të punuar në vendet fqinje, të cilët përbëjnë kryesisht grupin e fëmijëve të pashoqëruar në emigracion. Kjo kategori herë-herë identifikohet me fëmijët e trafikuar, gjë që nuk i përgjigjet realitetit.

Për të dy këtë kategori, nuk ka të dhëna zyrtare. Nga OJF të ndryshme jepen shifra, por të pakonfirmuara. Natyra klandestine e fenomenit, mungesa e shkëmbimit të informacionit zyrtar me vendet e destinacionit sjell vështirësi në konfirmimin e këtyre shifrave. Pranohet se rreth 4,000 femije shqipetare kane emigruar ne vendet fqinje pa prindet e tyre dhe jane te rrezikuar ndaj puneve te veshtira , lypjes dhe forma te tjera te shfrytezimit por gjithsesi fenomeni i trafikimit është shqetësues. Problemet përfshijnë:

- Sisteme të pamjaftueshme shërbimesh për mbrojtjen e fëmijëve, përgjegjës për identifikimin dhe ofrimin e ndihmës së duhur psiko-sociale dhe social-ekonomike për fëmijët në rrezik dhe familjet e tyre
- Varfëria dhe mundësitë e kufizuara të familjeve për të siguruar ardhura dhe për emigrim legal, shtynjë fëmijët dhe familjet e tyre për të ndërmarrë rrugëzgjdhje të rrezikshme
- Për fëmijët dhe familjet në rrezik trafikimi ndeshen vështirësi për vlerësimimin e situates se mundshme për shfrytëzim
- Marrëveshjet e bashkëpunimit me vendet pritëse të fëmijëve, viktima të trafikimit ende nuk janë nënshkruar



## Fëmijë që punojnë

Punët që bëjnë më shpesh fëmijë janë: shitës ambulante, lypësa, pastrues të makinave në semafore, dhe punë në bujqësi. Qeveria ka ratifikuar Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) Nr. 138 "Mbi moshën minimale" dhe Nr. 182 "Mbi format më të këqia të punës së fëmijëve". Në përputhje me standardet e ILO, është hartuar një kuadër ligjor që parandalon punën e fëmijëve ose vendos kufizime në punësimin e tyre. Në Kodin e Punës konfirmohet moshë 16 vjeç si moshë punësimi dhe parashikohet një mbrojtje të veçantë për fëmijët që punojnë. Që në vitin 1999 MPÇSSHB ka bashkëpunuar me Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO/IPEC) për forcimin e kapaciteteve institucionale të Komitetit Drejtues Kombëtar për Punën e Fëmijëve, i cili miraton politikat kombëtare mbi punën e fëmijëve, dhe të Njësisë së Punës së Fëmijëve. Po implementohen programet kombëtare për parandalimin e punës së fëmijëve dhe rehabilitimin e fëmijëve viktime të këtij fenomeni.

Mëgjithatë, impakti i programeve dhe politikave për mënjanimin e punësimit të fëmijëve është ende i pamjaftueshëm, duke përfshirë: bashkëpunimin me shkollën, familjen e komunitetin; bashkëpunimi ndërmjet Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve; inspektimi dhe monitorimi i punës së fëmijëve në sektorin formal nga Inspektoriatit Shtetëror i Punës; dhe shkëmbimi i informacionit pavarësisht nga krijimi i Qendrës së Dokumentacionit për punën e fëmijëve.

## Personat me aftësi të kufizuara (PAK)

Në grupin e PAK në përputhje me legjislacionin aktual përfshihen:

- PAK të lindur ose të bërë të tillë jo për shkakë punësimi
- Invalidët e punës

Tabela 1.5 Grupet e personave me aftësi të kufizuara

	Gjithsej	PAK	Kujdestarë
I. PAK të lindur ose të bërë të tillë nga shkakë që nuk lidhen me punësimin	61,141	53,000	8,141
a) mendore, sensorë, fizikë	47,631	42,322	5,309
b) të verbër	13,045	9,907	3,138
c) paraplegjike e tetraplegjike	1,465	771	694
II. Invalidët e punës	41,804	41,804	0
Gjithsej	102,945	94,804	8,141

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, qershor 2007.

Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara me pagesa në cash fillimisht u bazua në Ligjin nr. 7710, dt. 18.05.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore". Në vazhdim u miratuan statute ligjore për grupe të veçanta të PAK, si ligji mbi statutin e invalidëve të punës (1994), ligji për statusin e të verbërit (1996) dhe ligji për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik (2000). Këto statute, përveç pagesave në cash, garantojnë të drejta dhe mbrojtje ligjore për shërbime, punësim, lehtësira në energjinë dhe transport, strehim, përjashtimi nga disa lloje taksash, etj. Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" gërsheton pagesat në cash me shërbimet parandaluese, rehabilituese e integruese për këtë kategori.

Në ndryshim nga programi i ndihmes ekonomike, i cili bazohet në testimin e të ardhurave të familjeve përfituese, programi i PAK bazohet në vlerësimin e aftësive të kufizuara, të lindura

apo të fituara gjatë jetës. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar mbështetet në rregulloren dhe listën sëmundjeve dhe gjendjeve të aftësive së kufizuara. Vlerësimi kryhet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), i cili është në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe funksionon në 26 rrethe të vendit, dhe Komisioni Mjekësor për Vlerësimin e Verbërisë, (KMPV), i cili është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror dhe funksionon vetëm në Tiranë, për të gjithë personat e verbër në vend. Mbeshtetur në permiresimet e bëra për zgjerimin e hapërisave ligjore, në vitin 2007 u miratua rregullorja e re për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Në këtë dokument, janë përfshirë nozologji të reja të sëmundjeve dhe aftësi të tjera të kufizuara, ashtu siç janë hequr edhe sëmundje që trajtohen me nderhyrje mjekësore ose shërbime sociale.

Administratorët shoqërorë në bashki / komuna dhe punonjësit e zyrave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror ndihmojnë PAK për plotësimin e dokumentacionit dhe paraqitjen e tyre për vlerësim në komisionet e specializuara mjekësore. Komisionet kryejnë vlerësimin fizik të personave dhe shqyrtojnë epikrizën përcjellëse, të lëshuar nga klinika mjekësore të specializuara si dhe dokumenta të tjerë që vërtetojnë aksidentin ose gjendjen e aftësisë së kufizuar. Mbi këtë bazë, komisionet marrin vendimin ku përcaktohen shkaqet dhe grupi i aftësisë së kufizuar; shkalla e aftësisë për punë; dhe nevoja për kujdestar. Pas marrjes së vendimit të komisioneve, individit të cilësuar si PAK, i lind e drejta për të përfituar pagesa në cash dhe shërbime sociale. PAK paraqiten në njesite e qeverisjes vendore dhe përgatisin dokumentacionin për përfitimin e pagesave dhe shërbimeve.

## Pagesat në kesh për PAK

Fillimisht, PAK marrin vetëm ndihmë ekonomike në masën e pagesës së kryefamiljarit. Me pas u kalua në pagesë individuale për PAK, në bazë të vlerësimit të KMCAP dhe KMVP. Aktualisht çdo person me aftësi të kufizuara, përfiton 8 000 lekë në muaj dhe, kur komisionet mjekësore vlerësojnë se individët kanë nevojë për kujdestar, marrin edhe 8 000 leke në muaj për kujdestarin. Në bazë të Ligjit nr. 9355, pagesë për aftësinë e kufizuar përfitojnë:

1. PAK të cilëve aftësia e kufizuar ju ka ardhur nga shkaqe që nuk lidhen me punësimin si: nga lindja, para moshës ligjore për punësim, ose që në momentin e dëmtimit nuk kanë qenë të punësuar ose i anagazhuar në sektorin informal
2. PAK që janë invalidizuar në punë, të cilët përfitojnë edhe shërbime nga statutet e tyre të veçanta

Grupet e mësipërme, përveç pagesës nga Ligji nr. 9355, përfitojnë pagesa e tjera në cash dhe shërbime sociale edhe nga statutet e tyre të veçanta, kur aftësia e kufizuar ju ka ardhur nga puna dhe kanë fituar statusin e invalidit të punës:

- të verberit përfitojnë edhe pension invaliditeti dhe një shtesë prej 15% për kujdestarinë, e cila është përfshirë në pension
- personat para dhe tetraplegjikë përfitojnë edhe pension invaliditeti, një shtesë prej 15% për kujdestarinë, e cila është përfshirë në pension, dhe marrin një rimbursim për paketën higjieno-sanitare, 9 000 leke në muaj

Përveç pagesave të mësipërme, invalidet e punës të verber dhe para e tetraplegjike përfitojnë: perjashtim nga taksat e drejtpërdrejta; pagese të reduktuar për energjinë; rimbursimin për ilaçet; transport publik urban falas dhe 50% për transportin nderurban; rimbursim të një sasive karburanti që përdorin për lëvizjen me mjete motorike.

Në vitin 1993, trajtoheshin rreth 1 700 PAK, në vitin 1996 rreth 20 500 PAK, ndërsa në vitin 2006 u trajtuan rreth 61 141 PAK së bashku me kujdestarët. Aktualisht me pagesa dhe shërbime, trajtohen edhe 40 000 invalidë pune. Rritja e numrit të PAK, si rezultat i zgjerimit të hapësirave

ligjore nga miratimi i statuteve te vecante, eshte shoqeruar me rritjen e fondeve te disbursuara nga buxheti. Aktualisht, për pagesën e PAK disbursohen 8.1 miliard lekë.

## Shërbimet sociale për PAK

Fëmijët e lindur me aftësi të kufizuar ose të bërë të tillë në fëmijëri përfitojnë shërbime publike në 6 qendra rezidenciale dhe 3 njësi ditore. Sipas statistikave administrative, 335 fëmijë me aftësi të kufizuar jetojnë në qendra rezidenciale. Për PAK vitet e fundit janë ngritur dhe shërbime komunitare nga OJF të ndryshme dhe shoqata që mbrojnë dhe përfaqësojnë të drejtat dhe interesat e tyre si në Tiranë, Shkodër dhe Elbasan, ne te cilen perfitojne shërbime mbi 250 PAK.

Për PAK janë ngritur shërbime komunitare edhe nga projekti "Shpërndarja e shërbimeve sociale në komunitet", i financuar nga Banka Botërore. Në fazën e parë dhe të dytë të këtij projekti u ngriten 14 shërbime komunitare, si qendra ditore, shërbime në shtëpi, për PAK, në 8 qarqe dhe dy rrethe të vendit. Po ashtu në Berat, me mbështetjen e Shoqatës "ASED", u ngrit një kompleks shërbimesh për PAK: qender ditore, atelie punës dhe dy apartamente të mbrojtura, për të krijuar mbështetje komplementare për integrimin e PAK, në jetën komunitare.

Megjithë përmirësimet, përfituesit përballen me disa probleme:

- Shërbimet ditore dhe komunitare për fëmijët me AK janë të pamjaftueshme.
- Nuk ka mbështetje të mjaftueshme psiko-sociale për familjen.
- Nuk ka programe të mjaftueshme për trajnimin e tyre profesional, integrimin në jetën komunitare dhe sensibilizimin e publikut.
- Mungon vlerësimi për AK në të gjitha fazat e zhvillimit të fëmijës dhe nuk ka programe për trajnimin të fëmijëve me AK sipas grup moshave.
- Ka mungesa e pajisjeve të veçanta për fëmijet me AK.

Shërbimet rehabilituese ballafaqohen me problemet e mëposhtme:

- Mangësi në politikat për rehabilitimin profesional dhe punësimin e PAK
- Njohje nga familjarët dhe vetë PAK i legjislacionit të aftësisë kufizuar dhe zbatimimi i tij nga strukturat publike
- Pengesa në mjedis për një jetë të pavarur të PAK, si papërshtatshmëria e rrugëve, ndërtesave, dhe komunikimit

## Komuniteti i Romëve

Megjithëse pakica romë nuk quhet pakicë kombëtare por pakicë gjuhësore, me argumentin se nuk ka një shtet referimi, Romët trajtohen në përputhje me parimet e Konventës Kuadër të Keshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Vlerësohet se treguesit socialë për popullsinë romë janë konsideruar më të ulët se mesatarja kombëtare. Një pjesë e madhe e minoritetit rom jeton në kushte të pasigurta, të pambrojtur dhe në nivelin mesatar të jetesës. Papunësia masive pas viteve 90 goditi romët, më shumë se çdo grup tjetër. Situata e minoritetit rom në Shqipëri është komplekse. Situata e romëve nuk mund të reduktohet si një problem varfërie ose si çështje e një politike minoriteti. Në praktikë konstatohen raste të përjashtimit dhe të vetëpërjashtimit si rezultat i rrethanave ekonomike, sociologjike, psikologjike etj.

Kualifikimi i tyre i ulët u krijon atyre më pak shanse për t'u përfshirë në tregun e punës. Paragjykimet dhe stereotipet pengojnë lëvizshmërinë e tyre sociale. Shumica e romëve jetojnë në zona me infrastrukturë jo të zhvilluar. Familjet rome përgjithësisht kanë shumë anëtarë dhe në kushtet kur ato humbasin punën, nuk janë në gjendje të sigurojnë të paktën një jetesë modeste, të strehohen me kushte të pranueshme si dhe të përballojnë pagesën e faturave të shërbimeve publike. Kjo çon në lëvizjen e tyre drejt vendstrehimeve që nuk janë të pajisura me infrastrukturën e duhur, me kushte jo të shëndetshme dhe pa status legal. Kështu romët bëhen akoma dhe më të distancuar nga shërbimet publike, shkollat dhe mundësitë e punësimit. Karakteristikë tjetër për komunitetin rom është jeta e tyre jo në vazhdimësi në një vendbanim të caktuar. Ndryshimi i ambientit ku jetojnë, lëvizja nga një shkollë tek tjetra, vështirësia për t'u ripunësuar dhe integruar me jetën në një tjetër ambient, krijon vështirësi për evidentimin dhe regjistrimin e tyre në gjendje civile dhe për pasojë njohjen e legjislacionit, përjashtimin nga përfitimet e programeve sociale. Si rezultat i varfërisë, familjet rome vuajnë edhe nga probleme të mprehta sociale si dhuna, mosrespektimi i të drejtave të grave dhe fëmijëve, abuzimi me alkoolin, shtatzanitë në adoleshencë, vështirësi në administrimin e të ardhurave, etj. Këto familje bien shpesh pre e personave të tretë, të cilët përdorin fëmijët e tyre për trafikim, punë të detyruar, lypje, etj. Po ashtu gratë dhe vajzat rome janë më të rrezikuara nga trafikimi, i cili shpesh realizohet edhe me dijeninë e të afërmeve.

Ne kuadër të ratifikimit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve, Qeveria Shqiptare hartoi strategjinë për përmirësimin e kushtëve të jetesës së Minoritetit Rom e cila u miratua me VKM 633 dt.18 Shtator 2003. Për implementimin e saj, pranë Ministrisë u ngrit sektori i Monitorimit të Strategjisë Rome i cili ndjek zbatimin e objektivat në fushën e punësimit, shërbimeve sociale, arsimit, shëndetësisë, strehimit etj. Janë përcaktuar pikat e kontaktit që ndjekin implementimin e kësaj strategjie në të gjitha institucionet qendrore të cilat në mënyrë periodike raportojnë për progresin e detyrave. Vitin e kaluar u zhvilluan 12 tryeza të rrumbullakta në të gjithë vendin me përfaqësues të Pushtetit Lokal, të OJF-ve Rome dhe organizatave ndërkombëtare për sensibilizimin e opinionit dhe detajimin e detyrave të të gjithë këtyre aktoreve në raport me strategjinë. Tashmë këto struktura në mënyrë vertikale shkëmbejnë informacion, formulojnë raporte për progresin e objektivave.

Megjithatë masat e mara kundër braktisjes së shkolles, frekuentimin shkolles, debistimin e femiljeve nga shëndetësia, ofrimin e disa shërbimeve sociale nga shoqatat Rome dhe të tjera sidomos për fëmijet, trajnimin e grave dhe vajzave falas si një mundësi për punësim apo dhenien e konsulencës për njohjen e legjislacionit për përfitimin nga programet sociale ky komunitet vazhdon të ballafaqohet me probleme që lidhen me strehimin, rregjistrimin, shkollimin, punësimin etj.

## **Gratë**

Sanksionimi me ligj i barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit (Neni 18 i Kushtetutës), bën që burri dhe gruaja, si subjekte të së drejtës, de jure të trajtohen njësoj, në mënyrë të barabartë dhe si pasojë të kenë edhe detyrime të njëjta. Barazia përshkon të gjithë Kushtetutën dhe ligjet e tjera. Një sërë Kodesh të miratuara pas vitit 1995, përmbajnë dispozita në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe sanksionojnë parimin e barazisë burrë-grua: Kodi Civil, Kodi Penal, Kodi i Familjes dhe Kodi i Punës. Shqipëria ka ratifikuar Konventën "Për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas" në vitin 1993. Sipas detyrimeve që ka, Shqipëria ka raportuar pranë Komitetit të Konventës në janar 2003 dhe tani është në fazën e përmbushjes së rekomandimeve të bëra nga Komiteti i Konventës, sikurse dhe në përgatitjen e raportit të tretë periodik zyrtar. Projekt Ligji për Barazinë Gjinore plotëson kuadrin ligjor lidhur me barazinë gjinore në arsim, punësim dhe vendim-marrje. Ai mundëson ngritjen e mekanizmave qeveritarë në hartimin e politikave për barazinë gjinore dhe parashikon matjen e ndikimit të këtyre politikave nëpërmjet vlerësimeve dhe monitorimit periodik. Megjithatë, gratë janë një nga grupet që vuajnë më shumë nga pasojat e tranzicionit social dhe ekonomik. Pabarazia gjinore

mbetet nje shqetesim si rezultat i tradites gjinore dhe mendesise mashkullore te shoqerise, duke e vene nje pjese te grave ne dileme, per permbushjen e pergjegjesive familjare apo per karriere.

Politikat kryesore per zbutjen e kesaj ne menyre te vecante lidhen edhe me mbrojtjen e grave te trafikuara apo ne rrezik trafikimi, dhe te dhunuara.

## **Gra të trafikuar**

Një nga problemet më të mprehta me të cilat janë përballur gratë e vajzat ka qenë trafikimi për qëllim shfrytëzimi seksual. Disa nga shkaqet e këtij fenomeni janë gjendja e pamjaftueshme ekonomike, papunësia, nivel i ulët arsimor, mungesa e aksesit për shkollën si dhe mashtrimet e ndryshme. Sensibilizimi i opinionit nga Qeveria, por edhe nga shoqëria civile dhe donatorët për këtë kategori ka qenë i ndjeshëm. Shërbimet për gratë e trafikuar janë shtuar, janë hapur qendra pritjeje dhe riintegrimi, ku ofrohet ndihmë psiko-sociale dhe shëndetësore, si dhe shërbime integrimi. Janë zhvilluar fushata sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese, në media, shkolla e mjedise publike, janë zbatuar programe trajnimi dhe punësimi për krijimin e mundësive për punësim për gratë e vajzat e trafikuar ose në rrezik trafikimi. Deri tani:

- Janë ngritur dhe funksionojnë qendra pritese dhe riintegruese publike dhe jopublike për viktimave të trafikimit për gratë e vajzat, si Tiranë, Vlorë, Elbasan.
- Është siguruar një informacion i detajuar për gratë, vajzat dhe fëmijët që kanë përfituar nga programet e pritjes dhe rehabilitimit në qendrat pritëse.
- Janë licensuar 8 agjensi punësimi, të cilat ndërmjetësojnë për punësim jashtë shtetit, duke siguruar mundësinë për punësim të ligjshëm dhe duke mënjanuar mashtrimin për punësim, që përdoret nga trafikantët. Agjensitë e punësimit monitorohen nga Inspektorati Shtetëror i Punës për të mos lejuar abuzimet me to.
- Në qendrën e riintegrit të IOM-it u janë ofruar mundësi integrimi gra e vajza, të cilat ndjekin kurse formimi profesional dhe një pjesë e tyre janë punësuar.

## **Gra të dhunuara**

Megjithëse jo shumë sistematike, studime të ndryshme tregojnë se dhuna në familje është gjerësisht e pranishme në shoqërinë shqiptare. Ajo nuk njihet sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike apo fetare, gjendjes ekonomike, ose gjeografisë, por në shumicën e rasteve të raportuara gratë janë viktimat. Vrojtjet e dhjetë viteve të fundit tregojnë se mbi një të katërtat e grave raportojnë të jenë bërë viktimat të dhunës emocionale dhe seksuale, dhe se gratë rurale janë rëndom më të prekuara nga dhuna fizike. Fenomeni i dhunës në familje ndonëse nuk është i ri, ai mbetet i fshehtë dhe mentaliteti i familjes bën që të mos ndërhyhet sa duhet. Kohët e fundit për t'iu ardhur në ndihmë grave dhe vajzave janë hapur qendra këshillimi, avokatore si dhe strehëza për gratë e dhunuara të cilat kryesisht ofrohen nga OJF-të. Por problemet e mëposhtme evidentohen:

- Shërbime jo të mjaftueshme sensibilizuese për rolin e gruas në familje dhe marrëdhëniet e saj me pjesëtarët e tjerë të familjes.
- Shërbime jo të mjaftueshme këshilluese dhe rehabilituese.
- Aktivizimi i pamjaftueshëm i specialisteve si punonjës socialë, sociologë, mjekë, psikologë, juristë për trajtimin e problemeve të dhunës në familje.

## **Të moshuarit**

Megjithëse Shqipëria ka popullsinë me të re në Europë, përqindja e popullsisë mbi moshën 60 vjeç është në rritje graduale. Parashikohet që ajo të përbejë 12.2 përqind të popullsisë deri në

vitin 2010 nga 10.4 përqind në vitin 2000. Vlerësohet se afër 37 000 njerëz mbi moshën 66 vjeç jetojnë nën kufirin e varfërisë. Te gjithë qytetarët që kanë punuar dhe kanë paguar kontributet, përfitojnë pension pleqërie. Por pensionet sidomos ato në zonat rurale janë të ulta ose sa 20 përqind të konsumit të familjeve me të varfëra fshatare.

Megjithatë mungesa e të dhënave mbi shëndetin, mirëqenjen dhe përkrahjen sociale për të moshuarit, niveli i lartë i sëmundjeve kronike, barra e paaftësisë tërësisht e menjajshme, deprivimi ekonomik dhe mungesa e oportuniteteve sociale, nënkuptojnë që shumica e njerëzve në moshë, me shumë përpiqen të mbijetojnë sesa të jetojnë kënaqësitë e oportuniteteve personale. Në këtë mënyrë vetë shoqëria është e privuar nga kontributi që mund të përfitonte nga eksperiencat e qytetarëve të saj me të moshuar, dhe për më tepër paguan një çmim për kujdesin social dhe shëndetsor.

Emigracioni i të rinjve, strukturimi i familjes dhe ndryshimet në stilin e jetesës, po rritin përditë e më shumë numrin e të moshuarve të vetmuar dhe që kanë nevojë për shërbime sociale. Shërbimet për të moshuarit ofrohen në pesë qendra shërbime rezidenciale publike ku janë sistemuar 245 kliente të moshuar të vetmuar dhe me probleme sociale-ekonomike. Po ashtu për të moshuarit janë ngritur edhe shërbime në qendra ditore dhe shërbime në shtëpi me pranë komunitetit nga OJF-të. Me projektin 'Shpërndarja e shërbimeve sociale në komunitet' janë ngritur edhe disa shërbime multidisiplinare, ku ofrohen shërbime ditore edhe për të moshuarit. Por këto shërbime nuk i plotësojnë nevojat, nuk mbulojnë të gjithë territorin e vendit.

Si përfundim, për grupet në rrezik përjashtimi social, ekziston një sistem shërbimesh sociale në qendra rezidenciale dhe ditore. Këto shërbime janë të shumëllojshme, rezidenciale, ditore, shërbime në shtëpi, mbështetje psikosociale, ndërgjegjësim, lobim, avokati, përfaqësim etj:

- **Shërbimet shoqërore publike** ofrohen në 21 institucione rezidenciale dhe 5 ditore, të cilat financohen nga buxheti i shtetit. Deri tani këto shërbime janë administruar nga ShSSH. Në vitin 2007, filloi edhe procesi i decentralizimit dhe transferimit të shërbimeve në vartësi të qeverisjes vendore. Ofrohen shërbime për fëmijë jetimë e me probleme sociale (9 institucione), për PAK (6 qendra rezidenciale dhe 3 ditore), të moshuar (5 qendra rezidenciale) apo për viktime të trafikimit (1 qendër për gra, vajza, fëmijë dhe migrantë të parregullt). Kapaciteti i këtyre qendrave është për rreth 1200 klientë. Aktualisht në këto qendra përfitojnë shërbime 1075 kliente. Këto shërbime janë shtrirë në qarqet kryesore të vendit. Në Shkoder funksionojnë 5 institucione rezidenciale, në Durrës 2 institucione, në Tiranë 6 institucione, në Vlorë dhe Sarandë 4 institucione, në Korçë 3 institucione, dhe në Lezhë, Berat, Fier, Gjirokastër nga një qendër shërbimesh.
- Përveç shërbimeve shoqërore rezidenciale publike, vitet e fundit ofrohen **shërbime shoqërore jopublike** edhe nga OJF ose organizata fetare në qendra ditore, shërbime në familje dhe rezidenciale. Për këto shërbime janë shtrirë në qytetet kryesore të vendit si në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Gjirokastër, Vlorë. Këto shërbime ofrohen për fëmijët jetimë dhe me probleme shoqërore, për riaftësimin e PAK, për të moshuarit, viktimat e trafikimit, këshillim për gratë dhe vajzat, kundër drogës etj. Shërbimet komunitare financohen kryesisht nga donatorë të huaj.
- Sistemi i shërbimeve po reformohet me synim plotësimin më të mirë të nevojave nepërmjet decentralizimit dhe kalimit të përgjegjësisë në qeverisjen vendore, ngritjen e një rrjeti **shërbimesh komunitare** në bashkëpunim me strukturat e qeverisjes vendore dhe përfshirjen e shoqërisë civile në ofrimin e tyre. Shërbimet komunitare janë ngritur me mbështetjen e Projektit të Bankës Botërore. Gjate vitit 2006, u ngritën dhe u bënë funksionale 17 shërbime ditore me bazë komunitare për fëmijët, të rinjtë, për PAK, vajzat dhe gratë në nevojë, për të moshuarit. Këto shërbime u ngritën në bashkëpunim dhe komunat në katër qarqe të vendit: Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë. Për vitin 2007 janë ngritur edhe 27 shërbime të tjera komunitare, të cilat shtrihen në 8 qarqe të vendit. Në këtë mënyrë mbulohet 2/3 e territorit të vendit me modelin e ri të shërbimeve komunitare.

## 2. Vizioni, prioritetet strategjike dhe qëllimet strategjike

Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale është e ndërtuar mbi parime që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa për të Drejtat e Njëriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Karta Sociale Evropiane (e rishikuar), Karta Evropiane e Autonomisë Lokale, Komunikatat e Komisionit Evropian dt. 12 mars 1997 “Mbi modernizmin dhe përmirësimin e mbrojtjes shoqërore” dhe Komunikatën e Komisionit dt. 30 tetor 2003 “Për mundësi të barabarta për njerëzit me aftësi të kufizuara”:

- Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi: Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, origjina, feja, mosha, aftësitë e kufizuara ose veçanësi të tjera. Çdo individ në nevojë ka të drejtën të përfitojë të njëjtën ndihmë shoqërore apo shërbime. Të parandalohet dhe luftohet diskriminimi në përfitimin e shërbimeve.
- Mbrojtja: Grupe të caktuara, përfshirë fëmijët, duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë në përputhje me të drejtat dhe nevojat e tyre. Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi dhe neglizhenca, kudo që ata ndodhen.
- Drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit: Një mjedis favorizues duhet të sigurojë mbijetesën dhe zhvillimin maksimal të individëve, në aspektin e zhvillimit fizik, mendor, shpirtëror, moral, psikologjik dhe social, në përputhje me dinjitetin njerëzor.
- Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve: Individët janë përgjegjës për jetët e tyre. Ata duhen inkurajuar të marrin vendime për mënyrën e jetës brenda normave që shoqëria ka vendosur. Ata duhen nxitur të shprehin opinionin e tyre për shërbimet shoqërore dhe të ndihmohen për të ruajtur ose fituar sërish pavarësinë e tyre, të kenë të drejtën e ankimit dhe të ndjekjes së rastit të tyre. Ofruesit e shërbimeve shoqërore duhet të respektojnë të drejtat, dinjitetin, mendimet, pikëpamjet dhe veçanësitë e përfituesve nga planifikimi i shërbimeve deri në realizimin e tyre.
- Përfshirja dhe integrimi: Shërbimet shoqërore të kontribuojnë për ruajtjen e pozitës së individëve në shoqëri dhe për t'i mbrojtur ata nga përjashtimi social. Shërbimet duhet të garantojnë përfshirjen e individëve në nevojë në aktivitete të jetës së përditshme. Ofrimi i shërbimeve në mjedisin ku jeton, nuk i shpëton individët nga rrjedha e jetës së përditshme e cila është cënuar nga një situatë kritike.
- Respektimi i të drejtave dhe nevojave: Gama e shërbimeve që u ofrohet njerëzve duhet të përcaktohet në përputhje me nevojat e tyre dhe jo nga ato të sistemit.
- Partneriteti: Shërbimet shoqërore kërkojnë angazhimin e strukturave të nivel qendror, rajonal e vendor dhe partneritetin e aktorëve të mundshëm të komunitetit. Këta aktorë do të realizojnë identifikimin, vlerësimin, planifikimin e nevojave dhe ngritjen e ofrimit e shërbimeve. Partnerë në këtë proces do të jenë organizatat e shoqërisë civile, grupet komunitare, biznesi social dhe personat me ndikim në komunitet.
- Cilësia e shërbimeve: Përdoruesit e shërbimeve dhe familjarët e tyre duhet të kenë besim në shërbimet që ata përfitojnë. Ofruesit e shërbimeve shoqërore duhet të jenë të ndërgjegjshëm për standardet e shërbimeve që ofrojnë dhe të vlerësojnë rrezikun që vjen nga shërbime jocalësore. Profesionistët duhet të zotërojnë aftësitë e nevojshme për ofrimin e përshtatshëm të shërbimeve. Strukturat përgjegjëse shtetërore kanë për detyrë të bëjnë të njohura standardet, të ndihmojnë në aplikimin e tyre dhe të sanksionojnë zbatimin korrekt të tyre.
- Standardet kombëtare drejtojnë vendimmarrjen në nivel lokal: Strukturat qendrore hartojnë politikat dhe standardet e shërbimeve shoqërore, përcaktojnë aftësitë të nevojshme që duhet të kenë stafet e shërbimeve, caktojnë përparësitë në vlerësimin e politikave dhe monitorimin e zbatimit të standardeve. Vendimet për ngritjen e shërbimeve shoqërore në përputhje me nevojat e individëve dhe komunitetit, duhen marrë në nivel vendor, aty ku janë përfituesit dhe lindin nevojat e tyre. Strukturat vendore janë administruesit dhe realizuesit e shërbimeve shoqërore.

## Vizioni

Ritmi i ndryshimit social, ka qene i shpejte ne dy dekadat e fundit ne Shqiperi. Për të mbrojtur njerëzit nga pasojat me të keqja të këtij ndryshimi, nevojitet nje sistem i mire-projektuar i mbrojtjes sociale. Strukturat shtetërore, per hartimin dhe zbatimin e politikave, do te punojne per te siguruar se qeverisja vendore, shoqeria civile dhe familjet, bashkepunojne per te permiresuar mireqenien individuale dhe familjare. Nje sistem i mbrojtjes sociale, duhet te siguroje, te ardhurat dhe sherbimet e duhura, qe cdo individ te jetoje denjesisht, te zhvilloje dhe te aplikojë kapacitetet dhe aftesite e veta, ne faza te ndryshme te jetes sipas deshires se tij. Vizioni ynë është që Shqipëria të ketë vendosur një sistem të tillë në vitin 2013, i cili të sigurojë, mbrojtjen e duhur sociale për qytetarët e saj. Politikat e mbrojtjes sociale do te konvergojne me konceptet te cilat po adoptohen aktualisht nga vendet anetare te Bashkimit Europian: Ne 2013:

- Mireqenia e pergjithsme e popullise do te jete permiresuar.
- Varferia dhe perjashtimi social, do te jene reduktuar.
- Te ardhura te arsyeshme do te sigurohen per njerezit me ne nevoje, duke ofruar perfitime per te punuar dhe nderkohe duke mbeshtetur pjeserisht ata qe kane veshtiresi per t'u punesuar.
- Cilesia, disponibiliteti dhe efektiviteti i sherbimeve sociale, do te jete permiresuar, duke mbrojtur te drejtat e klienteve. Standardet do te perdoren per te rregulluar ofrimin e sherbimeve sociale, por gjithashtu per te fuqizuar potencialin veprues te OJF-ve.
- Qeveria ne bashkepunim me strukturat e qeverisjes vendore dhe shoqeria civile do te nderhyje ne problemet e femijeve.
- Sherbimet do te ndihmojne njerezit me aftesi te kufizuara per te jetuar ne menyre te pavarur.
- Do te inkurajohet perfshirja sociale mes grupve te marxhinalizuara.
- Barazia gjinore do te jete permiresuar.
- Mbrojtja sociale, do te kete nje baze finaciare te qendrueshme, e mbeshtetur dhe nga strukturat e reformuara te sherbimeve.

## Prioritetet strategjike

Për realizimin e vizionit të mësipërm janë përcaktuar prioritetet e mëposhtme:

### 3. Zbutja e varfërisë

- Permiresimi i targetimit per skemen e ndihmes ekonomike
- Shtrirja e kushtezimit te perfitimit te ndihmes ekonomike nepermjet punes, ne te gjithë trritorin.
- Permiresimi i administrimit te subvencionit per energjine

### 4. Reformimi i sistemit të shërbimeve shoqërore

- Decentralizimi
- Institucionalizimi i marredhenjeve me shoqerine civile
- Deinstitutionalizimi
- Garantimi i cilesise nepermjet percaktimit te standarteve, monitorimi i rezultateve per cilesine e standarteve dhe vleresimi dhe permiresimi i cilesise se sherbimit



- Vleresimi i nevojave dhe planifikimi komunitar
  - Trainimi dhe zhvillimi i stafit të shërbimit social
5. Mbështetja e grupeve në rrezik të përjashtimit social
- Luajtja e rolit koordinues me qeverinë për zbatimin e strategjisë ndërsektoriale të përfshirjes sociale, në përgjithësi, dhe politikave ndërprerëse për grupet sociale të përcaktuara (fëmijet, PAK, Romët dhe gratë), në veçanti
  - Zbatimi i masave prioritare specifike të përcaktuara në politikën ndërprerëse

## Qëllimet strategjike

Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale ka për qëllim të arrijë këto synime strategjike, sipas prioritetëve strategjike:

### 6. Zbutja e varfërisë

- Reduktimi i shkallës së varfërisë absolute për frymë në 10% deri në 2013 sipas rezultateve të vëzhgimit të nivelit të jetesës së familjes.
- Rritja e buxhetit për programin e ndihmës ekonomike
- Rritja e mbulimit të familjeve të varfëra nga ndihma ekonomike sipas rezultateve të vëzhgimit të nivelit të jetesës së familjes
- Reduktimi i numrit të familjeve jo të varfëra që marrin ndihmë ekonomike rezultateve të vëzhgimit të nivelit të jetesës së familjes
- Rritja e pagesës mesatare të ndihmës ekonomike
- Shtrirja e kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike nëpërmjet punës, në një numër të sa më të madh bashkë dhe komunash.

### 7. Reformimi i sistemit të shërbimeve shoqërore

- Kalimi i të gjitha shërbimeve rezidenciale brenda vitit 2007 në administrim të njesive vendore.
- Zgjerimi i llojshmerisë së shërbimeve komunitare dhe mbulimi i të gjitha grupeve me shërbime baze në të gjitha rrethet e vendit.
- Shtrirja e shërbimeve komunitare deri në vitin 2013 edhe në bashkitë që aktualisht nuk kanë shërbime të tilla.
- Pilotimi i shërbimit të kujdestarisë 2008-2010 në dy bashki (Tiranë, Shkoder) dhe deri në vitin 2013 shtrirja e këtij shërbimi edhe në njesitë e tjera vendore në përputhje me nevojat dhe mundësitë e buxhetit.
- De-institucionalizimi, konsolidimi i modelit të shërbimeve "shtëpi-familje" për fëmijet dhe PAK, zgjerimi i këtyre shërbimeve edhe për grupet e tjera sociale (të rinjtë, të moshuarit).
- Implementimi i standardeve të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për fëmijet, PAK, të moshuarit.
- Licensimi i të gjitha OJF që ofrojnë shërbime të përkujdesit për klientet brenda vitit 2008.
- Inspektimi dy herë në vit i të gjitha shërbimeve të përkujdesit rezidencial dhe ditor që ofrohen nga operatorët publikë dhe privatë.

### 8. Mbështetja e grupeve në rrezik të përjashtimit social

- Sigurimi qe strategjia ndërsektoriale të përfshirjes sociale monitorohet dhe vleresohet rregullisht
- Alokimi i fondeve te mjaftueshme per te mundur qe Ministria te luaje rolin e koordinuesit.

## Strukturat implementuese

Individët në nevojë, familjet dhe komuniteti në tërësi është drejtperdrejt pjesa më e interesuar për ndërtimin e një sistemi të përshtatshëm shërbimesh shoqërore. Pushteti qendror, pushtetit vendor dhe shoqëria civile kanë përgjegjësi kryesore për ngritjen e sistemit të shërbimeve që fokusohet mbi klientin. Deri tani përgjegjësia për realizimin e shërbimeve shoqërore ka qenë e dyfishtë: nga njëra anë e pushtetit qendror dhe nga ana tjetër e pushtetit vendor. Vitet e fundit shoqëria civile ka luajtur një rol të rëndësishëm për realizimin e shërbimeve të reja shoqërore në komunitet. Marrëdhëniet e strukturave të pushtetit qendror dhe atij vendor me shoqërinë civile po institucionalizohen më tej nëpërmjet sistemit të licensimit e inspektimit. Ata po marrin një rol të veçantë në procesin e realizimit të filozofisë së re të shërbimeve shoqërore. Roli i individëve dhe komunitetit ka filluar të bëhet më i dukshëm. Riformulohen rolet dhe përgjegjësitë e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor. Rritet roli i shoqërisë civile dhe individëve.

### Pushteti qendror

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

- Rishikon dhe zhvillon politikat dhe legjislacionin kombëtar
- Monitoron zbatimin e legjislacionit
- Harton buxhetin kombëtar për shërbimet shoqërore, ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftësisë, planifikon dhe delegon fondet në njësitë e qeverisjes vendore dhe monitoron përdorimin e fondeve buxhetore sipas destinacionit
- Licenson ofruesit e shërbimeve shoqërore
- Harton standardet dhe kriteret e shërbimeve shoqërore
- Krijon dhe programon Fondin Shoqëror për zbatimin e politikave e krijimin e shërbimeve të reja si dhe mbështet zhvillimin e shërbimeve shoqërore edhe në njësitë e pushtetit vendor që nuk kanë mundësi
- Harton politikat, legjislacionin dhe mekanizmat për raportimin e rasteve të keqtrajtimit
- Siguron që procesi i decentralizimit të realizojë në kohë shërbime alternative dhe të efektshme në nivel vendor

Shërbimi Social Shtetëror:

- Operon si institucion ndërmjetës midis nivelit politikëbërës, Ministrisë, dhe nivelit zbatues, pushtetit vendor
- Monitoron dhe inspekton përdorimin e fondeve dhe zbatimin e standardeve në të gjitha nivelet e shërbimeve publike dhe jopublike
- Siguron që të gjitha shërbimet e ofruesve të plotësojnë standardet e cilësisë për të marrë licensën për t'i ofruar këto shërbime
- Përgjigjet për zbatimin e legjislacionit
- Trainon stafet dhe ofruesit e shërbimeve

Strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror:

- Operojnë si institucion ndërmjetës, bashkëpunues dhe mbështetës për të realizuar koordinimin ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore
- Koordinojnë veprimtarinë e sektorëve të ndryshëm që lidhen me shërbimet shoqërore në

#### nivelin rajonal

- Realizojnë koordinimin dhe planifikimin e nevojave në nivel rajonal.
- Grumbullojnë informacionet dhe të dhënat në nivel rajonal për monitorimin dhe vlerësimin e impaktit të politikave
- Kontrollon zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, PAK dhe standardet e shërbimeve

#### Pushteti vendor

- Pasqyron objektivat e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale në programet dhe buxhetet e zhvillimit ekonomiko-shoqëror, rajonal ose vendor
- Miraton ngritjen e strukturave të shërbimeve shoqërore dhe buxhetin vendor për ngritjen dhe zgjerimin e shërbimeve shoqërore
- Përgjigjet për përdorimin e fondeve të kushtëzuara të buxhetit të shtetit dhe zbatimin e standardeve kombëtare të shërbimeve shoqërore
- Identifikon familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, PAK, individët që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror
- Planifikon nevojat e grupeve në nevojë dhe harton kërkesën për fonde
- Ngre lloje të reja të shërbimeve shoqërore në përputhje me nevojat e komunitetit
- Administron institucionet rezidenciale publike, ndjek shërbimet në qendrat ditore dhe shërbimet komunitare që janë nën juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore
- Miraton veprimtarinë e OJF-ve dhe të ofruesve të tjerë që zbatojnë projekte për shërbime shoqërore në territorin e njësisë së qeverisjes vendore
- Përzgjedh, sipas prokurimit publik, ofruesit e shërbimeve shoqërore të licensuara, për të plotësuar nevojat e komunitetit
- Shpërndan pagesat e ndihmës ekonomike dhe të PAK
- Formulon e dërgon statistikën në qark dhe në strukturat e tjera
- Koordinon veprimet ndërsektoriale për mbrojtjen nga keqtrajtim, duke përfshirë informimin për keqtrajtimin, vlerësimin fillestar, evidentimin e keqtrajtimit të mundshme, mundësitë dhe nevojat e familjes, zhvillon plane individuale për çdo rast duke ofruar shërbime apo duke koordinuar shërbimet me profesioniste të tjera për të mbështetur familjet dhe fëmijet. Kompletion funksionet për menaxhimin e rasteve si mbajtja e të dhënave, rishikimi sistematik i planeve për secilin rast dhe përgatitja e raporteve për në gjykatë.

#### Shoqëria civile

- Ofron shërbime të reja shoqërore në komunitet (sipas nevojave)
- Merr pjesë në planifikimin e shërbimeve në përputhje me nevojat e komunitetit
- Ndihej, nëpërmjet avokatisë, në analizën dhe përmirësimin e politikave të shërbimeve shoqërore
- Mobilizon individët dhe grupet në nevojë për të marrë pjesë në çështjet shoqërore
- Veprojnë për të përmirësuar mirëqenien e anëtarëve të tyre dhe grupeve të tjerë në nevojë
- Identifikon dhe raporton rastet për të cilat dyshon se ka keqtrajtim
- Zhvillon programe parandalimi dhe përmirëson koordinimin me strukturat vendore
- Ofron shërbime me bazë komunitare në rrjet për mbrojtjen, mbështetjen dhe trajtimin

sociale të fëmijve dhe prindërve

### **Individët**

- Marrin përgjegjësi për veten e tyre
- Identifikojnë dhe raportojnë keqtrajtimin e dyshuar
- Ndhmojnë anëtarët e tjerë të familjes
- Organizohen në grupe për të ndihmuar njëri-tjetrin dhe sillen si komshinj të mirë
- Kontribuojnë në koston e shërbimeve të ofruara, kur kanë të ardhura të mjaftueshme
- Punojnë si vullnetarë

## 3. Politikat

Në këtë kapitull bëhet një renditje e politikave të strategjisë së mbrojtjes sociale sipas prioritetit strategjik.

### 3.1 ZBUTJA E VARFERISË

Ne Kapitullin 1 paraqiten disa sfida në rritjen e efektshmërisë së pagesave në kesh në reduktimin e varferisë. Me poshtë parashikohen masat për reformimin të skemës së ndihmes ekonomike dhe të subvencionit për energji.

#### Ndihma ekonomike

Konceptet baze që qendrojnë në reformat e propozuara të programit të ndihmes ekonomike janë:

- Përdorimi i informacionit për: vlerësimin e varferisë; identifikimi i numrit të familjeve të varfëra dhe fondet e duhura për bllok grantet e ndihmes ekonomike për çdo njësi të pushtetit lokal
- Rritja e masës së mbulimit të nevojave të familjeve të varfëra me përfitime.
- Përmirësimi i vlerësimit të familjeve aplikante.
- Kushtëzimi i shpërndarjes së NE me pjesëmarrjen në punët në komunitet.
- Kushtëzimi i shpërndarjes në NE me pagesën e energjisë elektrike.

#### Informacioni për llogaritjen e parametrevë baze të Programit të NE

Te dhënat e LSMS do të shërbejnë si referencë për matjen e kufirit të varferisë dhe përqindjen e popullsisë nën këtë kufi. Këto të dhëna, së bashku me rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave (REPOBA), do të përdoren për përgatitjen e Hartës së varferisë dhe pabarazisë në Shqipëri, e cila i rendit nënsitet e qeverisjes vendore sipas nivelit të varferisë.

Studimi i INSTAT, zhvilloi së pari një model që parashikonte nivelin e konsumit të familjeve duke përdorur të dhëna nga LSMS të vitit 2002. Më pas, planifikoi një model për të gjitha familjet në të gjithë vendin, duke përdorur të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë. Megjithatë renditja e INSTAT nuk është përfundimtare, ajo përdori burimet më të pasura të informacionit dhe i analizoi ato duke përdorur një metodologji të pranuar në nivel ndërkombëtar.

Harta e varferisë do të përdoret për llogaritjen e numrit të familjeve të varfëra dhe planifikimin e bllokgranteve të NE, për çdo njësi vendore. Indikatorët kryesorë që do të shërbejnë për identifikimin e numrit të familjeve të varfëra në nivel kombëtar dhe për çdo njësi vendore që do të përfshihen në skemën e NE janë:

- Te dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave, të përditësuara: (i) numri i përgjithshëm i popullsisë rezidente në nivel kombëtar si dhe numri i popullsisë rezidente për çdo njësi vendore; (ii) numri i familjeve gjithsej në nivel kombëtar dhe numri i familjeve për çdo njësi vendore; si dhe (iii) numri mesatar i personave për një familje, në nivel kombëtar dhe për çdo njësi vendore.
- Te dhënat e LSMS, për: (i) kufirin e varferisë absolute (konsumi mujor për frymë në vlerën 4891 lekë me çmimet e vitit 2002), (ii) kufirin e varferisë absolute ekstreme (konsumi mujor për frymë në vlerën 3047 lekë me çmimet e vitit 2002), si dhe (iii) përqindjen e popullsisë

nën vijen e varfërisë, "headcount rate" ne nivel kombetar dhe per çdo njësi vendore. (hartat e varfërisë).

Mbi bazen e indikatorëve të mesiperm përlogaritët, numri i familjeve të varfëra që do të përfshihen në skemën e NE për çdo njësi të qeverisjes vendore, sipas shembullit të mëposhtëm (Bashkia Kuçovë):

Përcaktimi i numrit të familjeve të varfëra për Bashkinë Kuçovë.

- Popullsia: 18038 banorë (REPOBA)
- Përqindja e popullsisë nën kufirin e varfërisë ('headcount rate'): 12.5% (hartat e varfërisë)
- Numri i personave nën kufirin e varfërisë absolute: 2255 (18,038 x 12.5%)
- Numri mesatar i personave në një familje të varfër: 3.8 persona për familje
- Numri i familjeve gjithsej nën kufirin e varfërisë absolute: 593 (2255 / 3.8)

Aktualisht Bashkia Kuçovë jep ndihmë ekonomike për 850 familje.

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007.

Në këtë proces, përlogariten dy tregues kryesorë: (i) popullsia nën vijën e varfërisë, në nivel kombëtar dhe për çdo njësi vendore dhe (ii) numri i familjeve nën vijën e varfërisë, që do të përfshihen në skemën e NE. Këto tregues, zhvillohen për çdo bashki/komunë/qark dhe në nivel kombëtar dhe mbi këto baze, formulohet hartat e varfërisë. (Tabela 3.1).

**Tabela 3.1 Numri i familjeve të varfëra (2005) dhe numri aktual i familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike (2007) sipas qarqeve**

	Numri i familjeve nën kufirin e varfërisë, 2005			Numri i familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike, 2007		
	Urbane	Rurale	Total	Urbane	Rurale	Total
Berat	2630	5899	8529	4342	4712	9054
Diber	1187	8918	10105	3053	13708	16761
Durrës	4473	3936	8409	1682	688	2370
Elbasan	4423	12806	17229	5180	3899	9079
Fier	4038	8484	12522	3376	1643	5019
Gjirokastrë	1242	3986	5228	1055	1073	2128
Korçë	3138	9896	13034	3299	7295	10594
Kukës	1075	4438	5513	2937	9284	12221
Lezhë	1967	3639	11119	4335	2202	6537
Shkoder	3127	9155	12282	7248	10554	17802
Tiranë	8670	7696	16366	9897	4333	14230
Vlorë	3616	3276	6892	1926	493	2419
Gjithsej	39586	81120	127228	48830	64329	113159

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007.

Të dhënat tregojnë që ka diferencë ndërmjet numrit të popullsisë së varfër (sipas LSMS 2005) dhe numrit aktual të popullatës dhe familjeve përfituese të ndihmës ekonomike (2007). Këto

diferenca mund te korrigojohen duke perdorur treguesit e hartes se varferise si dhe vleresimin e burimeve per te ardhurat, sidomos per familjet ne zonat rurale.<sup>1</sup>

Numri i familjeve te varfera per cdo njesi vendore, te identifikuara mbi bazen e nivelit te varferise, dergohet si indikator kontrolli (tavan orjentues) per cdo bashki/komune ne momentin e hartimit te projekt-buxhetit per vitin e ardhshem. Bashkite/komunat, brenda kufirit te ketij treguesi te rekomanduar (tavan), identifikojne familjet e varfera qe do te perfshihen ne skemen e NE ne baze te kriterëve te vleresimit, per te dhenat e dokumentacionit qe dorezojne aplikantet.

### Mulimi i nevojave te familjeve me perfitime

Deri në vitin 2013, propozohet që masa e ndihmës ekonomike për familje do të tentojë arritjen e treguesit të nivelit të varfërisë per person, por brenda një kufiri tavan që nuk e kalon nivelin e pensionit minimal në shkallë vendi. Masa mujore e ndihmës ekonomike në vlerë do të vazhdojë të llogaritet në përputhje me strukturën e familjes e diferencuar për grupet e ndryshme të anëtarëve të saj, në vartësi edhe me karakteristikat e varfërisë.

Kufiri minimal dhe maksimal i NE përcaktohet cdo vit me VKM në vartësi me ritmet e rritjes së pensionit minimal në qytet në shkallë vendi, progresin ekonomik dhe burimet buxhetore. Për vitin 2008 dhe 2009, niveli maksimal i ndihmës ekonomike do të jetë 7500 lekë në muaj për familje, ndërsa niveli minimal 1000 lekë në muaj për ndihmën ekonomike e pjesëshme. Në këtë periudhë, do te mbeten të pa ndryshuara pagesat për anëtarët e familjes sipas strukturës së saj. Me pas, keto pagesa gradualisht do te rriten. Projektioni i masës mesatare të ndihmës ekonomike për një familje si dhe për një person në periudhën 2007-2013 paraqiten në Tabelen 3.2.

**Tabela 3.2 Projektion i masës së ndihmës ekonomike sipas anëtarëve të familjes**

Struktura e familjes	Masa (lekë)						
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Kryefamiljarë	2600	2600	2600	3000	3300	3400	3500
Mbi moshë pune	2600	2600	2600	3000	3300	3400	3500
Persona në moshë pune	700	700	700	800	1200	1400	1600
Persona nën moshë pune	600	600	600	700	1100	1300	1500

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007.

Rritja e masës së mbulimit të nevojave të familjeve të varfëra do të realizohet nga: (i) rritja e fondeve buxhetore që do te transferohen në programin e NE dhe (ii) ulja e numrit të familjeve përfituese nga skema e NE si rezultat i rritjes ekonomike. Projektioni i numrit të familjeve të varfëra, fondeve buxhetore për mbulimin e nevojave dhe masës mesatare për një familje dhe per nje person, paraqiten në Tabelen 3.3.

<sup>1</sup> Numri i familjeve te varfera sipas LSMS, per zonat rurale, eshte 81120, ndersa ne fakt perfitojne NE 64329. Rezultatet sipas LSMS, do ti nenshtrohet korrektimit per te ardhurat qe sigurojne familjet nga aktivitetet bujqesore dhe blegtorale. Korrektimi pasqyrohet ne piken pasardhese "Mbulimi i nevojave te familjeve me perfitime".



Tabela 3.3 Projektioni i buxhetit, numrit të familjeve, dhe masës mesatare të perfitimit

	Fondet Milionë lekë	Numri i familjeve në NE	Përfitim mesatar mujor për familje Lekë	Përfitim mesatar mujor për person Lekë
2007	2600	114000	1890	406
2008	3600	93000	3226	693
2009	4800	85000	4706	1010
2010	5700	80000	5931	1274
2011	6800	74000	7686	1650
2012	7200	70000	8508	1827
2013	7600	70000	9115	1957

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007.

Dy supozimet janë përdorur për të projektuar numrin e familjeve që do të bëjnë pjesë në skemën e ndihmës ekonomike duke filluar nga viti 2008 deri në vitin 2013.

- Në përputhje me të dhënat e LSMS, numri i popullsisë në nivelin e varfërisë absolute në vitin 2013 parashikohet të jetë rreth 326000 banorë ose 10% e popullsisë gjithsej, nga 18 %<sup>2</sup> që është aktualisht.
- Mbështetur në strukturën aktuale të përbërjes së familjeve të varfëra në skemën e NE, rezulton se një familje e varfër ka mesatarisht në përbërjen e saj 4.7 anëtarë nga të cilët: kryefamiljarët zënë 21% të numrit të përgjithshëm të personave në skemën e NE, personat mbi moshë pune 2%, personat në moshë pune 34% ndërsa personat nën moshën ligjore të punës 43%.

Në vitin 2013, në skemën e NE parashikohet të bëjnë pjesë 70 000 familje nga të cilat 35 000 familje në zonat urbane të cilat do të marrin kryesisht ndihmë ekonomike të plotë dhe po kaq rreth 35 000 familje do të perfshihen në skemën e NE në zonat rurale të cilat përgjithësisht do të marrin NE të pjesëshme. Krahas me reduktimin e numrit të familjeve, është parashikuar edhe rritja e fondeve buxhetore për programin e NE në përputhje me nivelet e parashikuara në PBA për periudhën 2008-2010. Në periudhën 2011-2013 rritja e fondeve për NE do të jetë me e moderuar. Në vitin 2013 fondet për programin e NE, parashikohen të jenë 7.6 miliard lekë ose tre herë më shumë se në vitin 2007. Në vitin 2013, masa mesatare e NE për një familje, parashikohet të jetë 9115 lekë nga 1890 lekë që është në vitin 2007 ose pesë herë më shumë.

### Permiresimi i dokumentacionit për vleresimin e familjeve aplikante

Identifikimi i gjendjes social-ekonomike të familjeve të varfra që duhet të mbështeten me NE është përgjegjësi e bashkive/komunave. Administratoret sociale në bashki/komuna, brenda numrit të familjeve të varfëra të rekomanduara nga Ministria e Punës në përputhje edhe me Harten e Varfërisë, identifikojnë familjet e varfëra me ose pa të ardhura, të cilat janë në nivelin e varfërisë zyrtare.

Për vleresimin e situatës së varfërisë të këtyre familjeve, administratoret sociale, sigurojnë informacion nga tre burime kryesore: (i) nga familjet aplikante që kërkojnë të perfshihen në

<sup>2</sup> Persosja e politikave për reduktimin e varfërisë, kërkon nderhyrjen e qeverisë për përgatitjen e Hartës së re të Varfërisë (LSMS- 3), në vitin 2008. Kjo do të krijojë mundësi për të saktësuar përfundimisht Hartën e Varfërisë dhe një bazë krahasimi të mjaftueshme me periudhat e mëparshme. Përveç fondeve prej rreth 400 mijë \$, do të nevojitet edhe angazhimi i INSTAT dhe ekspertëve të huaj.

skemen e NE, (ii) agjensite shtetore qe veprojne ne nivel vendor, si dhe (iii) verifikimi ne terren i situates se varferise se familjeve ne nevoje, duke perdorur disa tregues alternative.

*Informacioni nga agjensite publike qe veprojne ne nivel vendor* ka te beje me: punesimin, i cili sigurohet nga zyrat e punes; punësimin informal ne inspektoriatin e punes; zyrën e tatim taksave dhe sigurimeve shoqërore; rregjistrimin e pasurisë të paluajtshme dhe automjeteve; zyrat e tregut të lirë, urbanistikës etj. Ky informacion, sigurohet ne bashkepunim me agjensite e ndryshme vendore. Kjo praktike nuk perben ndonje ngarkese per familjet aplikante ne NE. Dhënia e ketij informacioni nga këto agjensi ne nivel vendor, është i detyrueshëm, periodik, dhe përcaktohet në VKM. Deri tani shkembimi i ketij informacioni nuk ka funksionuar. Venia ne eficence e shkembimit te informacionit, do te zbuse pjesen informale te skemes se NE, qe eshte pasoje e informalitetit te sektoreve te tjere dhe mungeses se koordinimit.

*Informacioni dhe dokumentat qe plotesojne aplikantet* dhe qe vleresohet nga administratorët shoqërore ne pushtetin vendor, ka te me: (i) deklaraten qe jep kryefamiljari per të ardhurat nga prona, toka, bujqësia, blegtoaria, (ii) deklaraten mujore për prezencën e të gjithë anëtarëve të familjes; (iii) vërtetimin si punëkërkuës të papunë, nje here ne tre muaj, (iv) perberjen e familjes sipas çertifikates se gjendjes civile; (v) çertifikaten e pronësisë ose (vi) tapine e tokës.

Dokumentacioni qe do te perdoret per identifikimin e nivelit te varferise se familjeve qe do te bejne pjese ne skemen e NE, jepet ne tabelen 3.4.

**Tabela 3.4 Treguesit dhe dokumentacioni për identifikimin e familjeve**

Treguesit	Sipas nr. dt. 14.12.05	VKM 787	Propozimet në të ardhmen
<b>A. Dokumenta që plotësohen nga aplikanti (kryefamiljari)</b>			
1. Deklarate vjetore per burimet e te ardhurave ose mungesen e tyre	X		X
2. Deklarate mujore per prezencen e anetareve te familjes ne moshe pune	X		-
3. Vertetimin si "pune kerkues te papune" per anetaret e afte per pune te familjes (çdo tre muaj)	X		X
4. Çertifikaten e gjendjes familjare	X		X
5. Çertifikaten e pronësisë (tokes etj) nga ZR Pasurisë se Paluajtshme	X		X
6. Aktin e marrjes ne pronesi/perdorim (tapia e tokes) ku rregjistrimi i pronesise ende nuk ka perfunduar	X		-
<b>B. Informacion nga agjensite shtetore qe veprojne ne nivel vendore</b>			
1. Zyra e punes, per punesimin dhe papunesine	-		X
2. Zyra e tatim-taksave, per ushtrim aktiviteti me leje ose pa leje	-		X
3. Inspektoriatin e Punës, per punesimin ilegal	-		X
4. Zyra e sigurimeve shoqerore, per pension pleqerie/ familjer	-		X
5. Zyra e rregjistrimit te pasurimeve te paluajtshme (hipoteka)	-		X
6. Zyra e rregjistrimit te automjeteve	-		X
7. Seksioni prane bashkive (urbanistika, tregu i lire, etj) .	-		X
<b>C. Informacion per raste te vecanta (masa kufizuese)</b>			
C1. Kur familja ndryshojne vendbanimin nga fshati ne qytet pas dates 1.8.1991 paraqet:			
• Vertetimin nga kryetari i komunes/ bashkise qe eshte larguar per arsye pune para dates 1.8.1991	X		X
• Kopjen e librezes se punes te noterizuara qe ka qene i punesuar ne qytet para largimit nga fshati	X		X
• Çertifikaten e pronësisë se tokes, kur kane perfituar toke	X		X
C2. Kur familja ndryshojne vendbanimin nga qyteti ne qytet, pas 1.8.1991,	X		X

paraqet librezën e punës ku vertetohet se në momentin e levizjes personi ka qenë i punësuar në vendbanimin e ri

C3. Familjet që ndryshojnë vendbanimin, brenda 30 ditëve paraqesin vertetimin në se kanë përfituar NE në vendbanimin e mëparshëm	X	X
D. Tregues alternativ për identifikimin e gjendjes sociale ekonomike të familjes:		
1. Gjendja e banesës, sipërfaqja dhe aksesimi në shërbimet baze	-	X
2. Pronesia mbi mjetet levizëse	-	X
3. Anëtar të familjes në emigracion	-	X

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007.

*Permiresimi dhe thjeshtezimi i dokumentacionit për vleresimin e varferisë së familjeve aplikante për NE. (Tabela 3.4).*

*A. Për dokumentat që plotësohen nga familjet aplikante (Seksioni A).* Aktualisht familjet plotësojnë 6 dokumenta. Propozojmë që të plotësojnë 4 dokumenta ose 33 % më pak, nga të cilat tre plotësohen vetëm një herë në vit dhe një dokument që verteton pjesën informale të punës, plotësohet një herë në tre muaj. Nga këto katër dokumenta, dy janë deklaratat që plotësohen nga aplikanti në familje, ndërsa dy të tjera merren në sportelet e agjensive publike vendore. Konkretisht: (i) Deklarata mujore e prezencës së anëtarëve të afër të punës (pozicioni 2) dhe vertetimi tremujor nga zyra e punës, (pozicioni 3) të njehesohen në një dokument; (ii) Certifikatë e pronësive (pozicioni 5) dhe tapia e tokës (pozicioni 6), njehesohen në një dokument.

*B. Informacioni nga agjensitë shtetërore, (Seksioni B)* që veprojnë në nivel vendor, sigurohet nga shteti burime të ndryshme. Karakteri detyrues, i shkëmbimit të këtij informacioni, përcaktohet me VKM nr. 787, dt. 14.12.2005, por në praktikë nuk ka funksionuar, megjithatë dy institucione janë brenda sistemit të Ministrisë së Punës, dy janë në sistemin e financave dhe tre të tjera në institucionet e regjistrimit të pronësive, etj.

Propozojmë që ky informacion të informatizohet dhe të rrjedhë në rrugë elektronike dhe shkëmbim, sipas një kalendari, të përcaktuar me VKM, ku të saktësohen detyrat e aktoreve dhe masat administrative për mos zbatimin e tyre. Qeverisja vendore, deri në listat e aplikanteve për NE, në zyrat e këtyre agjensive, ndërsa agjensitë konfirmojnë kërkesat. Funksionimi i shkëmbimit të informacionit, përben pjesën kryesore të masave për zbardhjen e informalitetit të programit të NE, që lidhet me nivelin e të ardhurave, punësimit, pronën, etj. Ky informacion nuk përben ngarkesë për aplikantët.

*C. Informacioni për levizjet nga fshati në qytet dhe nga qyteti në qytet, (Seksioni C)* është specifik dhe i kufizuar në numër, për të frenuar dublimin e përfitimit të NE, në zonën e origjinës dhe atë pritese, vazhdimin e përfitimit të NE për familjet e varfëra, etj. Propozohet që ai duhet të mbetet në fuqi.

*D. Përcaktohen tregues alternativë, (Seksioni D)* që do të përdoren për herë të parë si detyrues për administratoret sociale në procesin e vlerësimit të varferisë. Tregues të tilla si gjendja e banesës dhe aksesimi në shërbimet baze, pronesia e mjeteve levizëse, anëtarë në emigracion, etj., do të përcaktohen me VKM.

Ndryshimet, thjeshtimet apo permiresimet e bera, lehtësojnë 33 % dokumentacionin dhe vëllimin e punës që lidhet me aplikantët dhe permiresojnë me 50 % treguesit e tjerë, që lidhen me institucionet dhe agjensitë publike.

*Vlerësimi i dokumentacionit, mbi të ardhurat nga toka, bujqësia, blegtorja dhe aktivitete të tjera të familjeve aplikante, në zonat rurale, përben një komponent të ri për reformimin e mekanizimit të NE. Në procesin e identifikimit të familjeve që do të përfshihen në skemën e NE, vlerësohen të ardhurave nga këto aktivitete, që sigurojnë familjet aplikante dhe kjo shumë zbritet nga NE që duhet të marrë familja, e llogaritur sipas strukturës së anëtarëve të saj. Në*

kete rast, kur te ardhurat nga aktivitetet bujqesore, jane me te medha se nevojat ligjore te llogaritura, familja nuk fiton te drejten per t'u perfshire ne skemen e NE, ndersa kur keto te ardhura jane me te vogla se sa nevojat, familja perfiton NE te pjeseshme.

Të ardhurat që sigurojnë familjet nga aktivitete bujqesore e blegtorale, deri tani janë vlerësuar me disa koeficientë (1995) të cilët nuk pasqyrojnë realisht progresin dhe potencialet prodhuese të aseteve bujqesore e blegtorale si dhe situatën aktuale të tregut. Sipas vleresimeve te nje studimi te vitit 2007, nga eksperte te Bankes Boterore, rekomandohet qe vleresimi i te ardhurave nga toka dhe blegtoria te behet duke perdorur koeficiente te rinj:

- per produktet bujqesore, koeficientet e detajuar per dhjete kategorite e ndryshme te tokes, do te jene me 60-90 % me te larte.
- për produktet blegtorale, koeficientet e rinj te vleresimit te te ardhurave do te jene 3 herë më të larta per zonat malore e kodrinore dhe 4 herë me te larta në zonat fushore.

Aplikimi i koeficienteve te rinj, ne procesin e vleresimit te te ardhurave te familjeve fermere, do të shërbejë për identifikimin korrekt të familjeve që janë realisht në nevojë. Duke perdorur keta koeficiente, eshte projektuar qe deri ne vitin 2013, te reduktohet me afro 50 %, numrit i familjeve qe perfitojne NE ne zonat rurale.

**Tabela 3.5 Koeficientet e rinj qe do te perdoren per vleresimin e te ardhurave nga bujqesia dhe blegtoria**

**A. Koeficientet sipas kategorise se tokes lek/m<sup>2</sup>**

Emertimi	Kategoritë e tokës								
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX-X
VKM 787, dt. 14.12.2005	9	8	7	7	5	5	4	4	3
Studimi Bankes Boterore	15	13	12	11	9.5	8.6	7.7	7	4
Rritja (%)	66	62	71	57	90	72	92	75	33

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007.

**B. Koeficientet per vleresimin e te ardhurave nga blegtoria**

	Të ardhurat nga një lopë ose ekuivalenti nga llojet e tjera te blegtorise		
	Zona fushore	Zona kodrinore	Zona malore
VKM 787, dt. 14.12.2005	22 500 lek/vit	18 000 lek/vit	13 000 lek/vit
Studimi Bankes Boterore	96 000 lek/vit	54 000 lek/vit	41 200 lek/vit
Rritja ne here	4.2	3	3.1

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007.

**Kushtezimi i shperndarjes se NE me pune ne komunitet**

Bashkitë dhe komunat, kanë hapësira ligjore (me VKM, si mundesi por jo si detyrim) për kushtëzimin e shpërndarjes së ndihmës ekonomike me punë komunitare me kohë të plotë ose me kohë të pjesëshme.

*Projektet e punëve në komunitet, me kohë të plotë, organizohen me nje numer te kufizuar pjesemarresish. PAGESA per keto pune eshte e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi si dhe sigurimet shoqërore. Paga përbëhet nga fondet e ndihmës ekonomike e llogaritur sipas strukturës së familjeve, por jo më shumë se pagesa maksimale e NE që përcaktohet me VKM.*

Pjesa tjetër e pagesës deri në nivelin e pagës minimale, plotësohet nga fondet e taksave vendore të bashkisë/komunës.

Shtirja e këtyre projekteve, ndonese te kufizuara, ka dhene impakt 10-20 % ne uljen e numrit te familjeve perfituese te NE. Aplikimi i tyre ne te ardhmen, me VKM, do te rekomandohet si mundesi duke e lene ne kompetence te bashkive/komunave, qe kane burime te mjaftueshme financiare nga taksat lokale, per te plotësuar pagesën me fondet e veta. Pas përfundimit të projektit, pjesëmarrësit kanë të drejtë të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike në përputhje me kriteret ligjore në fuqi. Familjet që refuzojnë pjesëmarrjen në këto projekte, përjashtohen nga skema e NE.

*Ne projektet me kohë të pjesëshme, disa ditë në muaj*, thirren në punë komunitare të gjithë anëtarët e aftë për punë të familjeve që bëjnë pjesë në skemën e NE. Pagesa në këtë rast është e barabartë me masën e NE që i takon familjes në përputhje me strukturën e anëtarëve të saj. Fondet qe do te mbeten te lira si rezultat i mospjesemarrjes në punë të familjeve, i përfitojnë familjet që aktivizohen në këto projekte. Aplikimi i kesaj forme, ka dhene impakt deri ne 50 %, ne uljen e numrit te familjeve ne skemen e NE. Propozohet qe kjo forme te jete e detyrueshme (me VKM), per te gjitha bashkite/komunat, duke perfshire edhe njesite me te ardhura te mjaftueshme, nga taksat vendore.

Në të dy format e angazhimit në punë komunitare, familjet që nuk pranojnë të marrin pjesë në punë, largohen nga skema e ndihmes ekonomike.

Synimi është rritja e transparencës në shperndarjen e fondeve, ulja e numrit të familjeve dhe përfituesve abuziv, rritja e të ardhurave për familje që angazhohen me punë komunitare, perfitimi i komunitet si rezultat i permiresimit te infrastruktures, transportit, higjenes, terreneve sportive, sistemit te kullimeve dhe vaditjes, etj.

Bashkite/komunat per realizimin e ketyre projekteve, marrin masat e meposhtme:

- përcaktojnë numrin e personave të aftë për punë për çdo familje.
- identifikojnë fushat e ndërhyrjes me projekte pune me kohë të plotë ose të pjesëshme.
- përcaktojnë fondet nga burimet e taksave lokale, per projektet me kohe te plote, per te mbuluar pagën minimale dhe sigurimet shoqërore.
- percaktojne fondet e NE, për te gjitha pjesemarrësit ne projekte me kohë të pjesëshme, në përputhje me strukturën e familjes por jo më shumë se maksimumi i ndihmës ekonomike që përcaktohet me VKM.

## **Kushtezimi i shperndarjes se NE me pagesen e konsumit te energjisë elektrike**

Do te merren masat e meposhtme:

- Kompensimi do të kushtëzohet me pagesën e faturës së energjisë elektrike nga familjet dhe grupet përfituese.
- Përfitimi i NE dhe kompensimi i energjisë nuk mund të realizohet pa paraqitur pagesën e faturës së energjisë ne zyren e finances se bashkise/komunes. Në të kundërt, familjet e humbasin të drejtën e përfitimit të kompensimit te nergjise dhe NE.
- Përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar dhe kompensimi i energjisë nuk mund të realizohet pa paraqitur pagesën e faturës së energjisë tek zyra e finances. Në të kundërt, PAK e humbasin të drejtën e përfitimit të subvencionit dhe të pagesës së PAK.

- Punonjësit buxhetor me pagë bruto nën 35 mijë lekë në muaj, duhet të paraqesin pagesën e faturës së energjisë në zyrën e financës të institucionit. Në të kundërt humbet të drejtën e përfitimit të kompensimit.
- Pensionistët e vetmuar dhe invalidët e punës duhet të paraqesin pagesën e faturës së energjisë në institucionin që tërheqin pensionin për të përfituar subvencionin e energjisë. Në të kundërt humbasin të drejtën e përfitimit të kompensimit dhe të pensionit.

## 3.2 REFORMIMI I SISTEMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Politikat kombëtare të përkujdesjes shoqërore kanë në filozofinë e tyre ndërtimin e një sistemi shërbimesh për të plotësuar nevojat apo për të minimizuar ndikimin e pasojave negative të dukurive sociale mbi kategoritë që kërkojnë të përfitojnë nga shërbimet e saj. Sistemi i përkujdesjes shoqërore, nëpërmjet politikave dhe objektivave strategjike, synon mbështetjen e njerëzve në nevojë brenda familjes dhe në komunitetet e tyre, në raport me përkujdesjen që ofrohet në shërbimet e centralizuara rezidenciale. Reformimi i sistemit të shërbimeve shoqërore parashikon që:

- shërbimet e përkujdesit rezidencial rezidencial të transferohen në njësitë vendore dhe të të kalojnë gradualisht drejt shërbimeve me bazë komunitare, në përputhje me nevojat e qytetarëve
- të ngrihen shërbime të reja komunitare, krahas shërbimeve ekzistuese të përkujdesit rezidencial
- të zgjerohet llojshmëria dhe gjeografia e shërbimeve në përputhje me nevojat e evidentuara
- të rritet pjesëmarrja e njësive të qeverisjes vendore dhe organizatave të shoqërisë civile për programimin e realizimin e shërbimeve shoqërore
- të rritet përgjegjësia e njësive vendore për financimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve
- të hartohen, zbatohen, monitorohen dhe përmirësohen standardet e shërbimeve për çdo grup në nevojë, për të siguruar shërbime cilësore dhe eficiente
- të respektohen të drejtat e grupeve në nevojë për mbështetje sociale, të plotësohen nevojat e tyre dhe të nxitet integrimi në jetën shoqërore, veçanërisht për femijet, PAK dhe të moshuarit,
- të nxitet pjesëmarrja e biznesit social në financimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale komunitare.

## Decentralizimi

Vendimet për planifikimin, shpërndarjen dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore do të merren në nivel vendor (nga këshillat e komunave dhe bashkive), aty ku identifikohen nevojat sociale dhe ku jetojnë përfituesit. Në këtë kuadër edhe përgjegjësitë, buxhetet përkatëse dhe shërbimet do të jenë ekskluzivisht përgjegjësi e pushtetit vendor. Respektimi i parimit të decentralizimit është zgjedhja më e mirë për ofrimin e shërbimeve shoqërore dhe mundësia më e përshtatshme për përfituesit e shërbimeve. Zbatimi i këtij parimi kërkon një shpërndarje të re të detyrave dhe përgjegjësisë midis pushtetit qendror dhe atij vendor. MPÇSSHB zhvillon politikën, legjislativën, standardet për ofrimin e shërbimeve dhe përgatit sistemin për kontrollin dhe vlerësimin e shërbimeve, në mënyrë që çdo individ të ketë mundësi të gjejë se si janë zbatuar politikën dhe nëse fondet janë përdorur në mënyrë të efektshme.

Të gjitha përgjegjësitë e tjera do të kalojnë në qeverisjen vendore. Procesi i decentralizimit, de-institucionalizimit, krijimi i shërbimeve të reja komunitare më pranë familjes dhe komunitetit, përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve, do të realizohen, paralelisht me krijimin e persosjen e një mjedisi juridik e ligjor të përshtatshëm, përmirësimeve organizative dhe strukturore, hartimin e standardeve të reja të shërbimeve, për të gjitha kategoritë e përfituesve, licensimin e ofruesve të shërbimeve dhe inspektimin e tyre nga strukturat përkatëse të shërbimeve. Reformimi i sistemit të shërbimeve do të mbështetet në masa e veprime për rritjen e kapaciteteve të aktoreve pjesëmarrës, në nivel qendror dhe vendor dhe organizatave të shoqërisë civile si ofruese të shërbimeve.

## **Transferimi i qendrave të shërbimeve rezidenciale në varësi të njësive të qeverisjes vendore**

Kalimi i institucioneve të shërbimeve rezidenciale publike në varësi të qeverisjes vendore ka filluar në vitin 2006 dhe parashikohet të përfundojë në fund të vitit 2008. Bashkitë/komunat do të marrin përgjegjësitë dhe administrojnë të gjitha shërbimet shoqërore që ofrohen aktualisht në këto qendra për individët që janë banorë të territoreve që administrojnë:

Perveç 12 institucioneve të përkujdesit rezidencial që tashme kanë kaluar në varësi të qeverisjes vendore, (Bashkisë Tiranë (1); Bashkisë Korçë (1); Bashkisë Vlorë (2); Bashkisë Shkodër (2); Bashkisë Sarandë (2); Bashkisë Durrës (1); Bashkisë Fier (1); Bashkisë Gjirokaster (1) dhe Bashkisë Lezhë (1).) Ne të ardhmen viti 2007-2008, do të transferohen edhe institucionet e tjera rezidenciale në administrim të njësive vendore. (Bashkisë Kavajë (1), Bashkisë Shkodër (2), Bashkisë Korçë (1) dhe Bashkisë Berat (1), Sarandë, (1), etj.

Kalimi i institucioneve në njësive vendore, do të shoqërohet me transferimin e ndërtesave, transferimin e fondeve përkatëse nga buxheti qendror, personelin, inventaret etj. Do të vendosen kritere për ruajtjen e destinacionit të këtyre ambienteve dhe shërbimeve.

Në këtë proces SHSSH do të luajë një rol mbështetës dhe do të ndihmojë njësitë e qeverisjes vendore që të marrin përgjegjësitë për menaxhimin e shërbimeve. Burimet njerëzore të këtyre njësive do të trainohen për të përvetësuar përgjegjësitë e reja në kuadrin e procesit të decentralizimit. Në SHSSH është ngritur Sektori i Trainimit, i cili ka si përgjegjësi hartimin e programit vjetor të trainimit, të materialeve përkatëse, bashkëpunimin me donatorë dhe ekspertë të fushës për mundësimin e trainimeve cilësore në përputhje me nevojat e të punësuarve në sistemin e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.

SHSSH në bashkëpunim me qarqet do të koordinojë edhe procesin e shpërndarjes së individëve në nevojë, nga rrethet me mundësi të kufizuara për ofrimin e shërbimeve, në rrethet/qarqet që kanë mundësi e kapacitete të lira për ofrimin e shërbimeve shoqërore. Këto vendime do të marrin parasysh edhe nevojën e përdoruesve për të qenë afër familjeve të tyre. Autoritetet lokale ku banon individi do të jenë përgjegjëse për transferimin e fondeve dhe mbështetjen e klientit edhe në rastet kur ai transferohet në një rreth tjetër pritës, jashtë juridiksionit të tyre, për përfitimin e shërbimeve shoqërore.

Për plotësimin e kërkesave të vecanta do të ketë edhe disa institucione rezidenciale, të cilat do të administrohen në nivel kombëtar si: qendrat për viktimat e trafikimit, për PAK, femije, të moshuarit etj. Në këto qendra do të përfitojnë shërbime rastet urgjente, që vijnë nga rajone që ende nuk kanë ngritur shërbime për të gjithë grupet në nevojë.

## **De-institucionalizimi**

Shërbimet sociale publike, janë ofruar kryesisht në institucionet rezidenciale për grupe me nevoja të veçanta, si: jetimët, PAK apo të moshuarit. Këto shërbime kanë treguar që nuk janë

alternativa me e mire per perfituesit. Shkëputja nga familja dhe komuniteti u mohan përfituesve mbështetjen e tyre dhe të drejtën për të marrë shërbime në mjedisin ku jetojnë. Dhënia e shërbimeve rezidenciale në ambiente të mëdha për shumë përfitues, pengon zhvillimin e individualitetit dhe të aftësive sociale, duke krijuar vështirësi për integrimin e tyre pas daljes nga institucioni.

Gjithashtu nga studimet e bëra, rezulton se kostoja financiare e shërbimeve në qendrat rezidenciale është më e lartë në krahasim me shërbimet e tjera me bazë komunitare, të cilat, përgjithësisht, ofrohen për një kohë më të shkurtër. Organizata dhe donatorë të huaj, prezantuan konceptin e de-institucionalizimit të shërbimeve. De-institucionalizimi i shërbimeve shoqërore, në thelb është proces lëvizjeje nga shërbime shoqërore rezidenciale në shërbime komunitare. Ky proces mbështetet në katër komponentë:

- Parandalimin e pranimeve dhe qendrimet e panevojshme ne institucionet rezidenciale
- Sigurimin e alternativave te tjera per strehimin, trajtimin, edukimin dhe rehabilitimin e individëve që nuk e kanë të nevojshëm qendrimin në shërbimin rezidenciale
- Përmirësimin e kushteve, përkujdesjes dhe trajtimit per ata qe kanë nevojë per përkujdeje ne qendra rezidenciale
- Sigurimin që fëmijët të vendosen në institucionet rezidenciale për një kohë sa më të shkurtër

Do te thellohet bashkëpunimi me OJF-të që ofrojnë shërbime alternative për fëmijë apo për PAK për të zëvendësuar shërbimin rezidencial, me shtëpitë familje, kujdestarinë, birësimin etj.

Nën shembullin e projektit te zbatuar në Shtëpine e Foshnjës në Shkoder, ne institucionet e perkujdesit per femije do te promovohen nderhyrjetve komplekse si: identifikimi i familjeve biologjike dhe të afërmeve, mbështetja e tyre për të marrë pranë tyre fëmijën e institucionalizuar, këshillimi dhe puna parandaluese në maternitet, organizimi i femijeve ne shtepi familje, mbajtja e kontakteve me të afërmit, etj.

Modeli i dy shtepive-familje te decentralizuara, ne Durres, do te zhvillohet me tej edhe ne rrethe te tjere, me qellim qe sherbimet për femije te ofrojne një mjedis të përshtatshëm familjar, organizime te vogla, modelin prinderor, jeten ne komunitet, etj. Njësite mbeshtetese per familjet dhe nënat ne nevojë, do te nxiten te ngrihen dhe funksionojne edhe prane sherbomeve te tejra per femije. Po ashtu per femijet me aftesi te kufizuara do te ndiqet modeli i sherbimeve te ngritura ne 7 shtepi familje ne Shkoder, per te promovuar rehabilitimin psiko-fizik dhe nxitjen e aftësive sociale e profesionale, atelie pune, biznese sociale, etj.

Per procesin e deinstitutionalizimit, MPÇSSHB ka percaktuar përparësitë dhe veprimet që do te ndërmerren per grupet ne nevojë:

### **Për fëmijët**

- Të mos mbahen ne përkujdesje rezidenciale fëmijët nën 8 vjeç, perveç se në raste emergjencash dhe për një kohë shumë të shkurtër.
- Të zhvillohen sisteme alternative të përkujdesjes, familjet kujdestare dhe birësuese.
- Te krijohen dhe zhvillohet shërbimet ditore për fëmijë.
- Te punohet per reduktimin e kërkesës për vende në qendrat rezidenciale dhe te shihet si prioritet edukimi publik, puna me nënat në maternitetet për të reduktuar braktisjet, dhe me familjet në vështirësi.
- Të ndërmerren veprime aktive për të rehabilituar fëmijët e te rinjte qe gjenden ne qendra rezidenciale, ne familjet e tyre.



Nje shërbim tjetër alternativ për femijet është kujdesi në familjen kujdestare. Ministria e Punës me mbështetjen e UNICEF ka përfunduar draft dokumentin e politikës për kujdestarin e femijeve. Kujdestaria do të shërbejë për rritjen e cilësisë së shërbimeve për femijet jetimë dhe nga familje me probleme sociale. Ky lloj shërbimi do të ofrohet nga familjet kujdestare, që marrin përgjegjësi ligjore të perkujdesjes. Kjo platformë do të mbështesë dhe nxisë më tej traditën e mirë Shqiptare për perkujdesjen e femijeve jetimë dhe të anëtarëve në nevojë nga të afërmit e tyre. Fillimisht shërbimi i kujdestarisë do të pilotohet në Tiranë dhe në Shkodër, në bashkëpunim edhe me organizata me eksperiencë në këtë drejtim. Me pas ky shërbim do të shtrihet në të gjithë territorin e vendit.

### Për të rriturit

- Te zhvillohen shërbime alternative për të parandaluar institucionalizimin, me synimin që individët në nevojë të qëndrojnë pranë familjeve të tyre, apo në komunitet.
- Të fillojë vlerësimi i të rriturve në perkujdesje rezidenciale, për të identifikuar personat që:
  - mund të jetojnë të pavarur brenda komunitetit;
  - dëshirojnë të kthehen në komunitetin nga i cili kanë ardhur;
  - mund të jetojnë në komunitetin prej të cilit vjen, me mbështetjen e shërbimeve alternative,
  - dëshirojnë t'i bashkohet familjes, e cila do ta dëshironte "ribashkimin";
  - dëshirojnë të jetë në perkujdesje rezidenciale

### Për të moshuarit

- Ofrimi i shërbimeve në qendrat rezidenciale do të vazhdojë të ofrohet vetëm për të moshuarit e vetmuar. Do të shfrytëzohet kapaciteti i qendrave ekzistuese dhe do të përmirësohen kushtet e jetesë për plotësimin e kërkesave të standarteve që kanë filluar të implementohen për këto kategori sociale.
- Qendrat e shërbimeve ditore pranë komunitetit që ofrohen nga operatorët publik dhe privat do të shtrihen në të gjithë qytetet e vendit në përputhje me nevojat sipas domos për të mbuluar nevojat në ato zona ku nuk ka ende shërbime rezidenciale për këto kategori.
- Ofrimi i shërbimeve për të moshuarit në familje do të aplikohet për të moshuarit e vetmuar dhe me patologji të rënduar. Ky shërbim i ri do të bashkohet edhe me profesionist të fushës së shëndetësisë.

### Ngritja e shërbimeve të reja shoqërore në komunitet

Në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë që përcakton Ligji nr. 9355, dt. 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", njësitë e qeverisjes vendore do të identifikojnë nevojat dhe në përputhje me këto nevoja do të ngrenë lloje të reja shërbimesh shoqërore. Njësitë e qeverisjes vendore, do të planifikojnë fonde nga të ardhurat e veta për ngritjen dhe zgjerimin e shërbimeve shoqërore. Me këto fonde, bashkitë/komunat do të kenë të drejtë të blejnë shërbime dhe të kontraktojnë OJF-të, të cilat kanë ekspertizë dhe eksperiencë në fushën e shërbimeve sociale. Bashkitë me të ardhura më të mëdha kanë më shumë mundësi të për ngritur dhe mbështetur shërbime sociale. Për bashkitë në zona të largëta dhe me infrastrukturë të varfër, që mund të kenë më pak të ardhura, buxheti i shtetit do t'i mbështesë me më shumë fonde për të siguruar ofrimin e shërbimeve sociale bazë.

Modeli dhe tipologjia e shërbimeve të reja komunitare, (44 qendra shërbimesh ditore) të ngritura me mbështetjen e Projektit të Bankës Botërore "Shpërndarja e Shërbimeve Shoqërore",

per pese grupe në nevojë: fëmijët, të rinjtë, PAK, gratë dhe të moshuarit, do te konsolidohet dhe zgjerohet. Ne kete proces do te rritet bashkepunimi me OJF-të dhe aktore te tjere lokale, nepermjet kontraktimit te sherbimeve me fondet e njesive vendore, dionatoreve, komunitetit te biznesit, dhe sherbimet do te orjentohe drejt qendrave ditore, shërbimeve në shtëpi, qendrave multidisiplinare, strehëzat per grate e dhunuara, qendra rinore, qendra e linja këshillimi, etj. Ne kete menyre, modeli i sherbimeve ditore, do te mbuloje nje numer me te madh perfituesh, do te zgjeroje tipologjine e sherbimeve dhe gradualisht do te mboleje gjithë teritorin e vendit.

Njesite vendore do te kene te gjitha hapsirat ligjore per te ngritur sherbime te reja komunitare ne perputhje me vleresimin e nevojave te grupeve te ndryshme ne territorin e tyre dhe mundesite financiare per mbeshtetjen e ketyre sherbimeve.

## Institucionalizimi i marrëdhënieve me shoqërinë civile

Roli i organizatave te shoqërisë civile (kryesisht i OJF-ve dhe personave juridikë privatë) do të rritet më tej në të ardhmen. Këto organizata janë tashmë partnerë të strukturave publike dhe ato po kontribuojnë, si: ofrues të shërbimeve shoqërore, mbrojtës të të drejtave dhe interesave të grupeve në nevojë, formules të rekomandimeve për përmirësimin e legjislacionit te shërbimeve shoqërore, realizues të ndërhyrjeve parandaluese e sensibilizuese nëpërmjet edukimit dhe informimit te publikut për dukuri negative dhe pasojat e tyre mbi individin, familjen dhe shoqërinë. Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin vendimmarrës është një tjetër përgjegjësi e shoqërisë civile, e cila realizohet nëpërmjet menaxhimit të debatit social dhe transmetimit në rekomandime konkrete dhe në proceset vendimarrëse të nevojave, prioriteteve, ideve, mendimeve të komunitetit, që ndikojnë në jetën e një grupi të caktuar. Organizatat jofitimprurëse, si njësi fleksibël, kanë treguar se përshtaten dhe veprojnë shpejt në mbulimin e shërbimeve për të cilat shteti ka mundësi të kufizuara për të ndërhyrë.

MPÇSSHB në dokumentat strategjike dhe praktikën e saj, i konsideron ofruesit e shërbimeve sociale si partnerë dhe po punon për institucionalizimin e marrëdhënieve me këtë grupim. Bashkëpunimi me OJF të cilat përbëjnë grupin më të madh të ofruesve jopublikë, mbështetet në një legjislacion bashkëkohor si:

- Ligji nr. 8788, datë 7.5.2001, "Për organizatat jofitimprurëse"
- Ligji nr. 8789 "Për rregjistrimin e OJF-ve"
- Ligji nr. 8781 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" "
- Udhëzimi nr. 1321/9, datë 3.12.2003 "Për licensimin e personave juridikë privatë, përfshirë edhe OJF-të për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore"
- Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"
- VKM nr. 564, dt. 12.8.2005 "Për licensimin e ofruesve të shërbimeve shoqërore", i ndryshuar

Për të vendosur marrëdhënie partneriteti, MPÇSSHB:

- Ka evidentuar OJF-të aktive qe ofrojne shërbime shoqërore në të gjithë vendin
- Është pasuruar baza e të dhënave për OJF-të aktive qe ofrojne shërbime shoqërore për grupet ne nevojë sipas qarqeve; ne këtë informacion pasqyrohet impakti i shërbimeve të OJF-ve për lehtësimin e nevojave të grupeve të ndryshme, përfituesit, llojet e shërbimeve etj
- Janë përcaktuar kompetencat për bashkëpunimin me OJF-të në nivel Ministrie, ShSSH dhe të drejtorive rajonale të ShSSH

- Bashkëpunimi me donatorët dhe OJF-të është instrumentalizuar nëpërmjet marveshjeve që nënkruan Ministrinë, Shërbimi Social Shtetëror për ngritjen e shërbimeve të reja, rritjen e kapaciteteve të strukturave qendrore dhe vendore, implementimin e standarteve etj
- Procesi i licensimit ka filluar në vitin 2004 dhe deri tani janë licensuar 70 ofrues shërbimesh shoqërore për fëmijët jetimë dhe me probleme sociale, fuqizimin dhe mbështetjen e grave dhe vajzave të trafikuar dhe të dhunuara, për PAK, të moshuarit, etj. Procesi i licensimit dhe rilicensimit, do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Pervoja e fituar nga OJF-të, në fushën e ofrimit të shërbimeve shoqërore, do të përdoret nga njesitë vendore për ngritjen e shërbimeve për grupet në nevojë. Bashkëpunimi në të ardhmen do të synojë:

- Rritjen e rolit të OJF-ve në procesin e vlerësimit të nevojave për shërbime shoqërore dhe të atë të planifikimit komunitar në nivel rajonal.
- Mbështetjen për të ofruar shërbime shoqërore në nivel bashkie/ komune persona juridikë privatë, si OJF-të, ofrues privatë etj.
- Shërbimet e ofruara nga personat juridikë privatë do të orientohen në:
  - Shërbime ditore për personat në nevojë si fëmijë, PAK, të moshuar etj.
  - Shërbime mbështetëse për familjet e varfëra dhe me probleme shoqërore;
  - Shërbime këshillimi, rehabilitimi, trajnimi për fuqizimin e individëve dhe grupeve në nevojë si gratë, të rinjtë, PAK etj.
  - Strehëza, shtëpi familje, qendra pritjeje dhe rehabilitimi, shërbime në familje për gratë, vajzat e dhunuara e të trafikuar, fëmijët jetimë, të moshuarit etj.
  - Sensibilizim dhe informim për dukuri negative dhe pasojat e tyre mbi individin dhe shoqërinë.
  - Mbështetje e institucioneve publike të përkujdesit për të përmirësuar sasinë dhe cilësinë e shërbimeve etj.

Financimi nga donatorët, mbështetja nga burimet e qeverisjes vendor dhe komunitetit, do të jenë faktorë kyç që do të sigurojnë rritjen e potencialin e OJF-ve, si ofrues të shërbimeve cilësore dhe të efektshme.

## Garantimi i cilësisë

Sistemi i shërbimeve shoqërore, në Shqipëri, përveç shërbimeve rezidenciale publike është diversifikuar edhe nga prania e shërbimeve të ngritura nga OJF-të. Decentralizimi do të shoqërohet edhe me krijimin dhe zbatimin e kuadrit rregullues që vlerëson kapacitetet e tyre dhe i çertifikon ato, duke i lejuar subjektet të ofrojnë shërbime. Të gjithë shërbimet që ofrohen nga ofrues publikë dhe privatë duhet të garantojnë shërbime cilësore në përputhje me standardet. Cilësia e shërbimeve shoqërore përbehet nga tri elemente kryesore:

- Përcaktimi i standardeve
- Monitorimi i arritjes së cilësisë të vendosura me këto standarde
- Vlerësimi e përmirësimi i cilësisë së shërbimeve

## Standardet

Standardet që u hartuan gjatë vitit 2006, përcaktojnë në mënyrë të matshme kriteret që duhet të përmbushë një shërbim apo ofrues shërbimesh. Ato përbëjnë një dokument publik që ndihmon

ofruesit e shërbimeve në plotësimin e detyrimeve që ata marrin përsipër të ofrojnë. Standardet mbështeten në parimet e: përfshirjes shoqërore, pjesëmarrjes, ndërtimit të kapaciteteve, përdorimit të përvojave ekzistuese, etj. Standardet do të mbulojnë shërbimet për grupet për grupet kryesore në nevojë. Përveç Standardeve të Përgjithshme të Shërbimeve, të cilat përbëjnë bazën për respektimin e të drejtës së klientit për t'u mbështetur me shërbime cilësore në përputhje me nevojat, janë hartuar: (i) Standardet për fëmijët në institucionet rezidenciale, (ii) Standardet për shërbimet për PAK, (iii) Standardet për të moshuarit në qendrat rezidenciale, (iv) Standardet për të moshuarit në qendrat ditore si dhe (v) Standardet për shërbimet për personat e trafikuar dhe në rrezik trafikimi.

Standardet do të botohen dhe shpërndahen tek të gjithë ofruesit publikë dhe jo publikë. Për njohjen me standardet dhe aspekte të caktuara të tyre, do të realizohen trainime dhe tryeza të rumbullakta me punonjës të qendrave të shërbimeve, njësive vendore, inspektoriatit të shërbimeve sociale, etj. Implementimi i standardeve të shërbimeve në të ardhmen do të shoqerohet me veprimtari trainuese dhe njohëse, shkëmbim eksperience dhe i praktikeve të mira, hartime të udhëzimeve dhe rregulloreve, për fuqizimin dhe informimin e ofruesve të shërbimeve për të zbatuar paketën e standardeve për çdo grup specifik dhe kriteret respektive të tyre.

Gjatë vitit 2008 e në vazhdim do të ndiqet procesi i implementimit të standardeve nepermjet:

- Testimit në ofrues të ndryshëm shërbimesh në mënyrë që të jenë të arritshme, të vlerësueshme dhe realiste
- Publikimit, prezantimit dhe përgatitjen e ofruesve për t'i aplikuar standardet e reja
- Familjarizimi i ofruesve të shërbimeve me standardet
- Kontrollin e zbatimit të standardeve

## **Inspektimi**

Procesi i inspektimit të shërbimeve bazohet në Ligjin nr. 9355, dt. 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", VKM nr. 512, dt. 31.05.2006 "Për procedurat e kryerjes së kontrolit të ndihmës ekonomike, pagesës së PAK dhe shërbimeve shoqërore" dhe Udhëzimin e Ministrit të Punës për inspektimin e shërbimeve shoqërore. Për inspektimin e ofruesve të shërbimeve sociale, është ngritur Inspektoriatit i Shërbimeve në qendër dhe në 12 rajone. Për të mbështetur inspektorët dhe për ta kthyer inspektimin në një instrument mbështetës, informues dhe monitorues për ofruesit e shërbimeve publike dhe private, është hartuar Metodologjia e Inspektimit të Shërbimeve Sociale. Në baze të këtij udhëzuesi, inspektorët do të vlerësojnë shërbimin e ofruar duke e krahasuar atë me standardet në fuqi. Inspektimi do të shërbejë si një sistem paralajmërimi nëse politikat e zbatuara për shërbimet nuk kanë dhënë rezultatet e duhura. Inspektimi mund të kërkohet edhe nga vetë ofruesit për të parë nivelin e cilësisë së shërbimeve që ata ofrojnë. Inspektimi konsiderohet si një proces i dobishëm, konstruktiv, transparent dhe nxitës për zhvillim. Për të realizuar misionin e tyre si inspektorë por njëkohësisht edhe si informues të ofruesve për standardet, legjislacionin dhe zhvillimet e reja në fushën e shërbimeve sociale, inspektorët do të përfshihen në trainime për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

## **Licensimi**

Detyrimi për licensimin e ofruesve të shërbimeve shoqërore, parashikohet në ligjin nr. 8788, dt. 7.5.01 "Për Organizatat Jofitimprurëse", ku parashikohet e drejta e OJF-ve për t'u licensuar, nga organet kompetente, në fushat e të cilave OJF-të, ushtojnë veprimtarinë e tyre. Në këtë kuadër, licensimi i ofruesve të shërbimeve sociale, realizohet nga MPÇSSHB si struktura kompetente për hartimin e politikave sociale, standardeve të shërbimeve dhe inspektimin e cilësisë së tyre. Bazuar dhe në nenin 18 të ligjit nr. 9355, dt. 10.03.2005 "Për ndihmën dhe

shërbimet shoqërore", procedura e licensimit është detajuar më tej me VKM nr. 564, dt. 12.08.2005 "Për licensimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore", i ndryshuar.

Qëllimi i licensimit të ofruesve të shërbimeve shoqërore është: mbrojtja e interesave të klientëve nga ofrimi jocilësor i shërbimeve; aplikimi i standardeve të shërbimeve sociale dhe përmirësimi i cilësisë; evidentimi i të gjithë ofruesve të shërbimeve dhe vendosja e linjave të bashkëpunimit në nivel qendror dhe vendor; njohja më e mirë e "target" grupeve dhe nevojave të tyre dhe shmangja e mbivendosjes së shërbimeve; aftësimi i strukturave të qeverisjes vendore për të njohur ofruesit e shërbimeve dhe mbështetja e tyre në procesin e ofrimit të shërbimeve të reja komunitare.

Licensimi nuk është i detyrueshëm për të gjitha OJF-te që veprojnë në fushën sociale, por vetëm për ato që ofrojnë shërbime që kanë lidhje të drejtpërdrejta me mirëqenien e përfituesve; kërkojnë një staf të specializuar dhe kanë ose drejtojnë qendra përkujdesi ditore, rezidenciale, shërbime në shtëpi etj.

Organizata që p.sh janë të angazhuara në veprimtari sensibilizuese ose grupime të përfituesve që zhvillojnë thjesht veprimtari informuese ose lobuese, mund ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi pa patur nevojë për pajisje me licensë.

Në bazë të Vendimit të licensimit, veprimtaritë që duket të pajisjen me licensë janë:

- Qendrat e kujdesit rezidencial për fëmijë jetime, të braktisur, nga familje të varfëra dhe me probleme sociale;
- Qendrat e kujdesit rezidencial për PAK, të moshuar, persona të varur nga alkooli dhe droga, viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje etj;
- Qendrat ditore të përkujdesit për të gjitha grupet në nevojë: të grave, fëmijëve, PAK, të rinjve dhe të moshuarve;
- Qendrat e këshillimit psiko-social;
- Qendra të planifikimit familjar dhe linja këshillimi etj;
- Shërbime të kujdesit në shtëpi për PAK, të moshuar të vetmuar, persona që vuajnë nga sëmundje kronike etj;
- Qendrat e riaftësimit për PAK;
- Qendra pritëse dhe riintegruese për gratë e dhunuara dhe të trafikuar, etj.

Pajisja me licensë për ofrimin e shërbimeve sociale është detyrim i barabartë si për OJF-të vendase dhe të huaja ashtu dhe për personat juridikë privatë. Procedurat për marrjen e licensës, kërkojnë të vërtetojnë që aplikuesi ka kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për të ofruar një shërbim të caktuar ndërsa shërbimet që janë aktualisht të ngritura të provojnë kapacitetet e tyre, sipas kërkesave të standardeve të reja.

Aplikimet për licensë, vlerësohen nga Komisioni i Licensimit të Ofruesve të Shërbimeve Shoqërore, që drejtohet nga Zëvendësministri i Punës dhe ka si anëtarë përfaqësues nga Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale, Drejtoria Juridike, Shërbimi Social Shtetëror, Departamenti i Punës Sociale, në Fakultetin e Shkencave Sociale, si dhe përfaqësues nga ofruesit e shërbimeve. Përvoja e deritanishme në procesin e licensimit (70 OJF të licensuara) do të shërbejë për thjeshtimin e procedurave të licensimit dhe rritjen e bashkëpunimit me ofruesit e licensuar. Licensimi është i lidhur me inspektimin e shërbimeve dhe në rastet që inspektorët vërtetojnë probleme serioze në ofrimin e shërbimeve, ata kanë të drejtë që sipas afateve të shkallëzuara të propozojnë masa që nga gjoha, pezullim e deri në heqje licensë. Propozimet shyrtohen dhe miratohen nga Komisioni.

Licensimi do të vazhdojë, duke licensuar ofrues, të rinj, rilicensuar dhe persosur me tej mekanizmat vleresimin e kapaciteteve të ofruesve por njekohesisht edhe me propozime konkrete për mbeshtetjet financiare të tyre.

## Kontraktimi

Të gjitha shërbimet që do të blihen nga OJF-të dhe operatorët e tjerë privatë do të kontraktohen me bashkitë/komunat konform legjislacionit të shërbimeve shoqërore dhe për përdorimin e fondeve publike. Në ligjin "Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore", OJF-të kanë të drejtë të përfshihen në procesin e tenderimit të fondeve për shërbimet sociale dhe të aplikojnë për fonde në bashki ose komunë. Njësitë e qeverisjes vendore do të programojnë fonde nga buxheti lokal për mbeshtetjen e shërbimeve sociale. Tenderimi i shërbimeve sociale do të bazohet në kritere specifike ku vlerësohet cilësia e shërbimeve, eksperiencia dhe ekspertiza e ofruesve. Bashkitë / komunat do të organizojnë tenderimin e shërbimeve sipas parimit për favorizimin e subjekteve që ofrojnë shërbime cilësore dhe eficientë. Në procesin e tenderimit të fondeve për shërbime, do të vlerësohen kapacitetet e ngritura dhe nevoja e komunitetit për llojin e shërbimit. Fondet publike që do të përdoren për financimin e shërbimeve sociale të ofruara nga OJF-të, do t'ju nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe auditimit, si çdo fond tjetër buxhetor.

## Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi komunitar

Shërbimet shoqërore ofrohen në përputhje me nevojat e klientit. Ato adresohen në radhë të parë drejt njerëzve që kanë më shumë nevojë duke u fokusuar tek individit dhe familja në të cilën ai jeton. Vlerësimi i nevojave merr parasysh faktorët që pengojnë individët për një jetë aktive në komunitet. Vlerësimi do të fillojë me analizen e situatës shoqërore të çdo individit dhe me synim mbeshtetjen e pavarësisë dhe autonomisë së individit dhe respektimin e preferencave individuale për mënyrën e jetës. Në procesin e vlerësimit do të identifikohen nevojat për shërbime që klienti të arrijë pavarësi dhe autonomi me të madhe. Po ashtu do të identifikohen llojet e shërbimeve që do t'u ofrohen në mënyrë të drejtperdrejtë individëve apo familjeve të tyre për të lehtësuar dhe ndihmuar me mirë rehabilitimin e individëve. Planifikimi komunitar do të jetë një formë e re për vlerësimin e nevojave për shërbime dhe shërben si:

- metodë e planifikimit të shërbimeve shoqërore në nivel bashkie/komune apo qarku, për të plotësuar me mirë nevojat e veçanta në nivel lokal si dhe nevojat e individëve
- proces i hapur për identifikimin e nevojave, burimeve dhe për të dhënë zgjidhjen me të mirë në fushën e shërbimeve shoqërore
- mundësi për grupet në nevojë që të përfaqësohen dhe të prezantojnë në nivel vendor nevojat e tyre dhe mënyrat e plotësimit të tyre

Përgatitja e planit rajonal të vlerësimit të nevojave kalon në katër faza:

1. Analiza e gjendjes ku përshkruhen situata demografike, gjeografike, mjetet e komunikimit, ekonomia lokale, llojet e shërbimeve dhe individët që përfitojnë nga këto shërbime.
2. Përcaktimi i politikave dhe prioriteteve lokale dhe llojet e shërbimeve për të cilat ka nevojë komuniteti.
3. Përgatitja e një plani për zhvillimin e shërbimeve në nivel lokal. Në këtë fazë bëhet vlerësimi i shërbimeve që kryhen aktualisht dhe nevojat për shërbime të tjera që do të krijohen.

4. Realizimi i planeve te prioriteteve: fillimi dhe vazhdimi i veprimeve te nevojshme për të kthyer idetë në praktikë.

Komitetet e Planifikimit veprojnë ne nivel qarku. Komitet do te përbëhen nga 15 anëtarë ku bëjnë pjesë perfaqesuesit e pushtetit vendor (qarku, bashkia/komuna), te zyrave rajonale te SHSSH, te OJF qe veprojnë ne nivel qarku, shoqatave të përfituesve, si dhe aktorë të tjerë nga fusha e arsimit, rendit, shëndetësisë etj. Komitetet kanë funksion konsultativ dhe këshillimor dhe përgatisin planin rajonal për shpërndarjen e shërbimeve dhe monitorimin e zbatimit të këtij plani. Shkalla e gjerë e përbërjes mundëson konsultimin dhe bashkëpunimin ndërmjet aktoreve. Ne kuadrin e planit rajonal të përkujdesit, Komitetet e Planifikimit kanë per detyre:

- vlerësimin e nevojave per shërbime sociale
- identifikimin e numrit dhe llojeve te shërbimeve per te plotësuar këto nevoja
- përcaktimin e prioriteteve rajonale
- identifikimin e ofruesve te shërbimeve shoqërore
- planifikimin financiar te shërbimeve
- përgatitjen e strategjive te qarta konsultimi dhe komunikimi dhe zbatimi te këtyre planeve
- ngritjen e sistemit te monitorimit te planit dhe vlerësimin e impaktit te tij mbi grupet vulnerabel

Komitetet e Planifikimit kanë një përvojë tre-vjeçare. Ato janë ngritur dhe kanë vepruar fillimisht ne 4 rajone pilot (Tirane, Durrës, Shkoder, Vlore). Në 4 qarqet pilot ku u zbatua faza e parë e projektit të Bankës Botërore u vlerësuan 50 projekte te ofruar nga OJF per ngritjen e shërbimeve te reja shoqërore. Mbi këtë bazë janë realizuar procedurat per krijimin e 47 qendrave per shërbime shoqërore dhe po punohet edhe per projekte te tjera. Përvoja e fituar në planifikimin komunitar nga viti 2006 e ne vazhdim po shtrihet edhe ne qarqe te tjera.

## Trainimi dhe zhvillimi i stafit

SHSSH si strukturë ekzekutive e politikave te mbrojtjes shoqërore, ka qene e angazhuar ne mënyrë te drejtperdrejtë per menaxhimin e shërbimeve shoqërore publike. Me kalimin e përgjegjësive për ngritjen dhe administrimin e shërbimeve sociale në njësitë e qeverisjes vendore dhe transferimin e institucioneve të përkujdesit në varësi të tyre, SHSSH, u kthye në një institucion, mbështetës, monitorues dhe inspektues për zbatimin e legjislacionit për ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Shërbimi Social ka në strukturën e tij në qender dhe nivel rajonal 130 punonjës. Institucionet e perkuajdesit shoqëror, nje pjese e te cilave kane kaluar ne varesi te pushteti vendor, kanë rreth 540 punonjës.

Per forcimin e kapaciteteve te punonjësve të angazhuar në sistemin e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, ne nivel qendror dhe vendor janë kryer ne mënyrë te herëpashershme trainime te pergjithëshme dhe specifike per programet e ndryshme te mbrojtjes shoqërore. Në kuadrin e decentralizimit, reformës, legjislacionit dhe standardeve të reja, u realizuan studime mbi përgatitjen, kompetencat dhe informimin e stafit me qëllim zbatimin e suksesshëm të këtij kuadri ligjor dhe strategjik. Pavarësisht përvojës së punës së kryer per ofrimin e shërbimet shoqërore dhe zbatimin e programeve te NE dhe PAK, u vërejt se në kushtet e reformimit te sistemit te shërbimeve, aftësite e tyre profesionale kishin nevojë per t'u rivlerësuar, zhvilluar e përforcuar ne përputhje me përgjegjësitë e reja.

Aktualisht përgatitja e punonjësve socialë realizohet nga Universitetet. Janë krijuar gjithashtu edhe qendra trajnimi me karakter praktik duke krijuar profesioniste te shërbimeve shoqërore te tipeve te ndryshme jashtë sistemit te universiteteve, si p.sh. kursi për përgatitjen e edukatorëve të specializuar dhe profesionistëve që punojnë me PAK. Per ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve

të burimeve njerezore qe punojne ne sistemin e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore ne përputhje dhe me reformën janë marrë këto masa:

- Prane SHSSH është ngritur një Sektor per Trajnimin e stafeve ne nivele te ndryshem te planifikimit, realizmit e menaxhimit, monitorimit dhe inspektimit të shërbimeve, etj.
- Trajnimi i stafeve do të bëhet sipas përshkrimeve të reja te vendeve te punës, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për çdo punonjës
- Krijimi dhe rifreskimi i kapaciteteve per njohjen e legjislacionit, politikave të reja etj duke ofruar rregullisht trajnim plotësues dhe rifreskues per punonjësit qe janë te trainuar; po ashtu do te këtë trajnime edhe per inspektoret e shërbimeve shoqërore
- Trajnimi per stafet mbështetëse qe punojne drejtëperdrejtë me klientet (p.sh. pastruesit, guzhinieret, receptionistet etj)

Grupet që do të përfshihen në trajnim:

- Nëpunësit e administratës civile (të MPÇSSHB, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit etj)
- Punonjësit e Shërbimit Social Shteteror ne nivel qendror dhe rajonal
- Punonjësit e njësive te qeverise vendore qe punojne ne shërbimet shoqërore ne te gjitha nivelet - komuna, bashki dhe qarqe
- Punonjësit aktualë dhe të rinj (publikë dhe jopublikë) që ofrojnë shërbime shoqërore
- Studentet e fakulteteve të shkencave shoqërore të universiteteve, qe kerkojne te fitojnë dijeni dhe praktikë pune në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore

### 3.3 MBËSHTETJA E GRUPEVE NË RREZIK NGA PËRJASHTIM SOCIAL

Prioritetet kryesore te strategjise se mbrojtjes sociale, përfshijnë të gjitha grupet në nevojë që janë identifikuar në legjislacionin shqiptar. Nevojat specifike te grupeve te vecanta te ekspozuar ndaj riskut te perjashtimit social, paraqiten në dokumenta strategjikë ndërsektorialë të Qeverisë për fëmijët, barazinë gjinore dhe dhunën në familje, PAK, kushtet e jeteses se komunitetit Rom, trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafikimin e fëmijëve. Objektivat, masat dhe veprimet e përcaktuara në planet e veprimit të dokumentave të mësipërme, kanë një filozofi të përbashkët, që u trajtua në Kapitullin 3.2. Kjo filozofi lidhet me decentralizimin, de-institucionalizimin, ngritjen e shërbimeve ditore, pranë familjes dhe komunitetit, rritjen e përfshirjes së pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve. MPÇSSHB ka përgjegjësi për: (i) implementimin e objektivave qe i perkasin drejtëperdrejt strukturave te varesis te saj qe lidhen me ofrimin e shërbimeve sociale dhe zbatimin e programeve te tjera te mbrojtjes sociale, (ii) monitorimin e progresit te objektivave qe duhet te realizojne ministrite e linjes dhe njesite e qeverisjes vendore, për arsimin, shëndetsinë, strehimin, kulturen, sportet, krijimin e lehtesirave per levizjen dhe telekomunikacionin, në interes të grupeve të rrezikuara nga diskriminimi dhe perjashtimi social. **Strategjia ndërsektoriale e përfshirjes sociale** përshkruan politikat e qeverise për pikat (i) dhe (ii); MPÇSSHB ka rolin udhëzuese gjatë hartimit dhe monitorimit.

Per realizimin e ketij misioni, ne MPCSSHB jane bërë përmirësime të rëndësishme strukturore dhe organizative. U ngriten dhe po funksionojne ne Ministri apo ne strukturat e vartesis: Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta, Sekretariati Teknik për PAK, Sekretariati për Monitorimin e Objektivave të Strategjisë së Fëmijëve, Sekretariati për Zbatimin e Objektivave të Strategjisë së Romëve dhe jane percaktuar personat pergjegjes në te gjitha strukturat e varësisë në qender dhe në nivel rajonal,qe janë pergjegjese për ndjekjen e zbatimit të objektivave. Po ashtu janë ngritur struktura: i) per femijet: Komiteti Ndërministror për Mbrojtjen e të Drejtave te Femijeve, ii) per PAK: Këshilli Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar, dhe iii) per romet, Komiteti për Mbrojtjen e Minoriteteve.



## Fëmijet

Qeveria konsideron që për shkak të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, fëmijet kanë nevojë për një mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore. Qëllimet janë zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Konventa Për të Drejtat e Fëmijëve; sigurimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët; vazhdimësia e procesit që siguron respektimin e interesave të fëmijëve; ngritja e sistemit të institucioneve dhe marrja e masave të tjera të domosdoshme për të mbrojtur fëmijët nga të gjithë format e dhunës, të shfrytëzimit dhe nga keqtrajtimet; sigurimi i jetesës së fëmijëve në mjedis familjar; përsosja e kuadrit ligjor në fushën e birësimeve; përmirësimi i shërbimeve shëndetësor dhe arsimor; reduktimi i numrit të fëmijëve që punojnë; dhe ulja e numrit të fëmijëve të rrugës dhe ngritja e shërbimeve që i mbrojnë dhe zhvillojnë fëmijët. Për të gjitha këto synime, janë përcaktuar objektiva, masa dhe veprime në "Strategjinë Kombëtare për Fëmijet".

### Roli koordinues i qeverisë

Dy janë strukturat që monitorojnë Strategjinë Kombëtare të Fëmijëve: Komiteti Ndërmënyor për të Drejtat e Fëmijëve dhe struktura mbështetëse e tij Sekretariati Teknik i Fëmijëve.

Komiteti Ndërmënyor për të Drejtat e Fëmijëve, funksionon si një organ këshillimor pranë Këshillit të Ministriave për politikën dhe programet për fëmijë. Komiteti do të nxisë realizimin e detyrimeve legjislative, administrative dhe ekzekutive që rrjedhin nga Strategjia e Fëmijëve. Për realizimin e misionit, Komiteti Ndërmënyor për të Drejtat e Fëmijëve mbështetet nga Sekretariati Teknik i Fëmijëve, i cili është i përfshirë në strukturën e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Sekretariati Teknik i Fëmijëve, koordinon punën me institucionet qendrore dhe vendore, shoqërinë civile si dhe aktorë të tjerë që punojnë për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve. Sekretariati ndjek implementimin e strategjisë nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, harton raportet tre-mujore dhe vjetore të progresit, orienton dhe mbështet donatorët vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë, dhe organizon studime dhe analiza mbi gjendjen e fëmijëve në Shqipëri.

### Masat prioritare për mbijetesën dhe mbrojtjen e fëmijeve

Strategjia kombëtare e fëmijeve ka katër objektiva strategjike: mbijetesën e fëmijeve, mbrojtjen e fëmijeve, zhvillimin e fëmijeve dhe pjesëmarrjen e tyre. Ministri të ndryshme të linjës përgjigjen për veprimet prioritare të çdo objekti. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse direkt për zbatimin e masave specifike prioritare për mbrojtjen dhe mbijetesën e fëmijeve. Shume prej këtyre objektivave janë paraqitur me siper në përshkrimin e politikës për shërbimet sociale (Seksion 3.2). Por sipas planit të veprimit, ka dhe disa politika të tjera që duhen ndjekur, sic janë:

- Mbrojtja e fëmijeve nga dhuna dhe abuzimi nepermjet ngritjes së qendrave të rehabilitimit psiko-fizik për fëmijet e abuzuar dhe të rrahur, promovimi i rolit të punonjësit social dhe psikologut në mbrojtjen e fëmijeve, dhe zbatimi i sanksioneve për garantimin e mbrojtjes së fëmijeve nga abuzimi në institucionet ku mbahen nën kujdes.
- Parandalimi i trafikimit të fëmijeve nepermjet bashkëpunimit me të ngushtë me institucionet e tjera publike dhe mbrojtja dhe ri-integrimi i viktimave nepermjet sistemit të referimit.

## Personat me aftësi të kufizuara

Qeveria angazhohet për nxitjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të PAK, lehtësimin e jetesës së pavarur të tyre si dhe rritjen e pjesëmarrjes në jetën e komunitetit dhe zhvillim të tij. Dokumenti bazë për politikën dhe shërbimet mbështetëse për PAK është 'Strategjia kombëtare e personave me aftësi të kufizuara' dhe plani i saj i veprimit. Kjo strategji bazohet në këto parime: drejta civile, barazia, dhe mos-diskriminimi; vetëvendosja; përfshirja, pjesëmarrja, dhe mundësitë e barabarta; jetesa pa barriera dhe mjedisi i lirë; parandalimi, identifikimi, dhe trajtimi i hershëm; rehabilitimi dhe integrimi.

Politikat për PAK reflektojnë parimet dhe masat e dokumentave europianë dhe ndërkombëtarë si Plani i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar 2006-2014 i Këshillit të Evropës, Konventa e Kombëve të Bashkuara për të Drejtat e PAK, Karta Sociale Europiane e Rishikuar etj. Në këtë kuadër programet për PAK, synojnë të zhvendosen nga modeli mjekësor drejt atij social, i cili vë theksin tek të drejtat e PAK, aftësitë e tij dhe gjetjen e mekanizmave nga ana e shtetit dhe shoqërisë për krijimin e kushteve që PAK të mos ndihen të mënjanuar dhe diskriminuar.

Ministria e Punës, ka rritur mbështetjen për PAK dhe në politikën e saj për shërbimet sociale, u ka kushtuar vëmendje të vecantë shërbimeve për PAK dhe shtrirjes së tyre në të gjithë vendin.

Në vitin 2005, me Ligjin nr. 9355 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", u rrit ndjeshëm pagesa e aftësisë së kufizuar, kujdestarit si dhe u përfshinë në skemat e përfitimit edhe grupe që për shkak të kufizimeve të mëparshme ligjore nuk përfitonin edhe pse kishin nevojë për mbështetje.

Mbështetja për PAK, do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Me përparësi do të mbështeten PAK që kanë nevojë për nivel të lartë mbështetje, në familje të varfra, etj. Ministria e Punës, në të njëjtën kohë po punon për zbatimin e politikave që nxisin formimin dhe punësimin e PAK në workshope të mbrojtura dhe në tregun e hapur të punës. Punëdhënësit që punësojnë PAK, do të mbështeten dhe nxiten me fonde subvencione nga buxheti i shtetit, për përshtatjen e vendit të punës, garantimin e punësimit afatgjatë, etj.

## Roli koordinues i qeverisë

Qeveria ka krijuar një institucion të posaçëm për përfshirjen e dimensionit të aftësisë së kufizuar në politikë-bërje dhe koordinimin e politikave shumë-sektoriale që ndikojnë jetën e PAK. Këshilli Kombëtar për Çështje të Aftësisë së Kufizuar është një institucion këshillues pranë Këshillit të Ministrave. Ai drejtohet nga Zëvendëskryeministri dhe përfshin ministrat e dikastereve që lidhen me mbrojtjen sociale, formimin dhe punësimin, arsimin, shëndetësinë, përshtatjen e mjedisit dhe komunikimin, dhe perfaqësues të pesë OJF-ve kombëtare për PAK. Ai miraton raportin për të drejtat e paafetësisë që do të botohet në baze vjetore deri në vitin 2009 dhe më pas do të botohet çdo dy vjet.

Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror, i cili drejtohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, mbikeqyr zbatimin e strategjisë kombëtare dhe jep rekomandime Këshillit Kombëtar.

Sekretariati Teknik i vendosur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shanseve të Barabarta në MPCSSHB është ngarkuar me mbledhjen dhe shpërndarjen e të gjithë informacionit në lidhje me aftësinë e kufizuar; lidhjen me pikat fokale në të gjitha ministritë, OJF-te e PAK dhe zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror; përgatitjen e takimeve të Këshillit Kombëtar dhe të Këshillit Administrativ.

## Masat prioritare për ngritjen e kapaciteteve, legjislacionin dhe kërkimin

Strategjia kombëtare e PAK ka shtatë objektivat: inkurajimi dhe edukimi për një shoqëri që mundëson pjesëmarrjen; realizimi i të drejtave; sigurimi i arsimit optimal; sigurimi i mundësive për punësim dhe zhvillim ekonomik; promovim i një shërbimi publik i përgjegjshëm dhe transparent; mbështetja për një jetë cilësore në komunitet; dhe mbledhja dhe përdorim i informacionit. Ministri të ndryshme përgjigjen për veprimtarite prioritare të secilit objektiv. Përveç masave prioritare për shërbimet të paraqitura më sipër, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse direkte për zbatimin e masave specifike prioritare për:

- Ngritjen e kapaciteteve të tilla si përcaktimi dhe konsolidimi i strukturave të reja rajonale për vlerësimin shumë-disiplinor të PAK
- Përgatitjen e një ligji integral për aftësinë e kufizuar dhe përmirësimin e legjislacionit në mbështetje të OJF-ve që ofrojnë shërbime për PAK
- Kërkimi, mbledhja dhe përditësimi i të dhënave statistikore për PAK me qëllim përshtatjen e politikave me nevojat e tyre

## Përfitimet për PAK

Konventa për të Drejtat e PAK, rekomandimet e OKB për Barazimin e Mundësive dhe Plani i Veprimit të Këshillit të Evropës, orientojnë zhvendosjen e vlerësimit të PAK nga modeli mjekësor drejt modelit social, duke mundësuar edhe vlerësimin e nevojave sociale dhe mënyrën e plotësimit të tyre. Këto dokumenta rekomandojnë gjithashtu përdorimin e Manualit Ndërkombëtar për Klasifikimin e Funksioneve, të Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF), i përgatitur nga OBSH, i cili është i organizuar në tre komponentë: (i) struktura dhe funksionet e trupit të individit; (ii) aktivitetet që lidhen me punën, veprimet e tij dhe pjesëmarrjen në situata jetësore; (iii) informimin për AK të rënde dhe faktorët mjekësorë. Realizimi i këtyre rekomandimeve si dhe Konventa e OKB për të Drejtat e PAK, kërkojnë që në këto komisione, gradualisht mbi bazën e studimeve dhe mundësive që do të krijohen, përveç eksperteve mjekësore, të përfshihen edhe punonjës social, psikologë, profesionistë për fëmijët dhe të rinjtë, etj. Për këtë do të merren masat e mëposhtme:

- Kthimi gradual i KMCAV dhe KMPV në institucione multidisiplinare, me funksion vlerësimin shumëplanësh të PAK, duke u fokusuar në kapacitetin e PAK dhe jo në aftësinë e kufizuar të tyre.
- Informimi i PAK dhe familjarëve të tyre, për ndërhyrje mjekësore, terapi rehabilituese, shërbime ekzistuese, etj.
- Zbutja graduale e ndikimit të modelit mjekësor duke përfshirë aspektet sociale, si funksionimi dhe pjesëmarrja, në vlerësimin e PAK.
- Kontraktimi i profesionistëve të fushës mjekësore dhe sociale, sipas grup moshës dhe llojit të AK të personave që komisionohen, duke vënë theksin në nevojat specifike të çdo moshë për zhvillim dhe rehabilitim, përkujdesje dhe shërbime, mbrojtje dhe përfaqësim, etj.
- Promovimi pas vitit 2010 të Manualit ICF për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, në strukturat arsimore të mjekësisë, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Shëndetësisë dhe në komisionet e vlerësimit të PAK.
- Vendosja e një sistemi të ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, drejt modelit social, në përputhje edhe me kërkesat e Konventës për të drejtat e PAK dhe dokumentave të tjerë ndërkombëtarë.
- Studimi i mundësive për shkallëzimin e pagesave në varësi të rëndësës së aftësisë së kufizuar, shkallës së vetfunksionimit dhe moshës, etj, për të siguruar mbështetjen e nevojshme për PAK.

## Komuniteti i Romëve

Qeveria angazhohet politikisht për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom përmes politikave e programeve konkretë për zbutjen e varfërisë, përfshirjen e tyre në jetën publike, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre etnik. 'Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të minoritetit Rom' do të shërbejë si udhezues.

### Roli koordinues i qeverisë

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse për të ndjekur zbatimin e masave prioritare të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Minoritetit Rom. Sekretariati Teknik i Romeve, si struktura e MPÇSShB:

- bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe donatorë të ndryshëm për të gjetur fondet e nevojshme për të realizuar masat prioritare
- bashkëpunon me shoqatat e komunitetit rom për të zgjidhur në mënyrë të vazhdueshme të gjitha problemet që kërkojnë bashkëpunimin dhe bashkëpërgjegjësi me komunitetin përkatës
- ka si detyrë të rëndësishme nxitjen e organeve të ndryshme shtetërore për të përfshirë në planet e tyre të zhvillimit objektivat e parashikuara në strategji
- ndjek planet e zbatimit dhe indikatorët e monitorimit dhe do t'u raportoje institucioneve zbatuese apo Keshillit të Ministrave në lidhje me progresin.

### Masat prioritare për mbrojtjen sociale

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është e ngarkuar për të zbatuar masat prioritare specifike për mbrojtjen sociale të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Minoritetit Rom. Në veçanti:

- Integrimi i fëmijëve rom të rrugës në jetën normale: Për integrimin e këtij grupi fëmijësh është menduar ngritja e qendrave ditore të cilat do të shërbejnë si strehë dhe shkolle, që do të realizohen në bashkëpunim me donatorë vendas dhe të huaj nëpërmjet OJF-ve që zbatojnë projekte në edukimin dhe zhvillimin e kësaj kategorie fëmijësh. Institucione shtetërore si Inspektoriati Shtetëror i Punës do të ushtrojë kontrolle sistematike lidhur me punën e zezë të fëmijëve rome.
- Asistencë dhe mbështetje e romeve për aplikimin dhe përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet e varfëra: Duke qënë se shumë familje rome nuk përfitojnë ndihmë ekonomike për arsye se nuk njohin të drejtat që janë të garantuara në ligj është programuar (i) organizimi i një fushate sensibilizuese në fushën e mbrojtjes sociale për të drejtat e përfitimit për ndihmën ekonomike, pagesën e papunësisë, dhe pagesën barrë lindje; si dhe (ii) nxjerrjen e një akti administrativ që detyron komunat dhe bashkitë për t'u dhënë asistencë ligjore familjeve rome për plotësimin e dosjeve.
- Stimulimi dhe mbështetja e shoqatave rome si përfaqësues të aspekteve të ndryshme të jetës së tyre: Për realizimin e këtij objekti është e domosdoshme (i) evidentimi dhe rregjistrimi i OJF-ve rome që ushtrojnë aktivitete; (ii) krijimi i një rrjeti të këtyre OJF-ve; (iii) bashkëpunimi i OJF-ve me organe të ndryshme vendimarrëse të shtetit.

### Gratë

Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje diktohet nga nevoja për përmirësimin e statusit të gruas në Shqipëri dhe për harmonizimin me kërkesat dhe standartet për çështjet e barazisë gjinore dhe integrimin e tyre në politikat dhe programet

publike nga Konferenca e Pekinit ne vitin 1995 dhe Platforma e Verpimit, Pekin +5, +10, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian.

### **Roli koordinues i qeverisë**

Për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje do të jetë përgjegjëse MPÇSSHb, me strukturat e saj në vartësi. Brenda MPÇSSHb, funksionon Njësia e Barazisë Gjinore, si strukturë politikëbërëse brenda Drejtorisë së Politikave të Shanseve të Barabarta me detyrë formulimin e politikave për shanse të barabarta të fokusuar në perspektivën e barazisë gjinore.

Sipas Ligjit Nr. 9669 dt.18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", MPÇSSHb ngarkohet të ngrejë një strukturë të posaçme për çështjet e dhunës në familje si dhe të mbikëqyrë procesin për krijimin e strukturave të tilla në institucionet e tjera. Deri në ngritjen e kësaj strukture, zbatimi i strategjisë do të monitorohet nga Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta.

### **Masat prioritare të veçanta**

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është e ngarkuar gjithashtu për të zbatuar masat prioritare specifike për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje të parashikuara në strategjinë ndërsektoriale e përkatese. Në mes të tjerash, kjo përfshin:

- Rishikimi i Ligjit Nr. 9198 dt. 1.7.2004 "Për barazinë gjinore në shoqëri" si dhe legjislacionit të tjera nga këndvështrimi gjinor në përputhje me standartet ndërkombëtare
- Kontribut në përpjekjet për rritjen e numrit të grave në vendimmarrjen publike
- Rritja e aksesit për kategoritë e grave në nevojë për t'u informuar mbi bazën ligjore dhe programet që sigurojnë mbrojtjen sociale si dhe institucionet që ofrojnë këto shërbime
- Kontribut në përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe cilësisë së informimit të publikut për kapërcimin e stereotipeve gjinore dhe rëndësinë e arritjes së barazisë gjinore në shoqëri, nëpërmjet politikave dhe produkteve të ndryshme në fushën e medias
- Ndhima për krijimin dhe kualifikimin (me Ministrinë e Shendetësisë) e ekipeve multi-disiplinare për të garantuar cilësinë e shërbimit ndaj viktimave të dhunës dhe individëve që dhunojnë

## 4. Implikimet financiare

Tabela 4.1 paraqet shpenzimet totale te buxhetuara dhe te realizuara per 2007-en, si dhe tavanet e shpenzimeve te projektuara per 2008-2010 sipas PBA-se, per tre programet buxhetore e Ministrise se Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta. Programi i ri i mbrojtjes sociale perfshin programin e ndihmes ekonomike, pagesat per aftesin e kufizuar, kompensimin e energjise dhe kompensimin e te perndjekurve politik dhe ne nje kapitull te vecante shpenzimet per kujdesin social. Per here te para ne vitin 2007 parashikohet edhe programi buxhetor per shanse te barabarta.

**Tabela 4.1 Shpenzimet aktuale dhe ato te projektuara sipas programit buxhetor, 2005-2010**

Milion lekë	2005 fakt	2006 fakt	2007 plan	2008 projektuar	2009 projektuar	2010 projektuar
1. Planifikim, menaxhim, administrim	632	605	182	193	213	220
2. Mbrojtja sociale (2.1 +2.2)	10,140	11,633	13,824	15,258	17,185	18,535
2.1 Asistenca sociale	9,751	11,137	13,356	14,700	16,400	17,800
Ndihma ekonomike	3,257	3,048	2,856	3,600	4,800	5,700
Pagesa e PAK	6,094	7,014	8,100	8,700	9,200	9,700
Kompensimi i energjise	-	675	2,000	2,000	2,000	2,000
Të perndjekurit politik	400	400	400	400	400	400
2.2 Kujdesi social,1	389	496	468	558	785	735
3. Shanset e barabarta	-	-	10	11	12	13
Shuma gjithsej (1+2+3)	10,772	11,182	14,016	15,462	17,410	18,768

Shenim 1: Ne te dhenat per Kujdesin Social, fakt 2005-2006, nuk jane perfshire, fondet e Projektit te B.Boterore per sherbimet sociale.

Burimi: Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, janar 2007.

Programi buxhetor i mbrojtjes sociale eshte projektuar per te qene pjese konstante e buxjetit te pergjithshem te MPCSShB (19.6%). Megjithate, si pjese e buxhetit total te qeverise, pjese e programit buxhetor te mbrojtjes sociale eshte projektuar te reduktohet nga 6.19% ne 2007 ne 5.96% ne 2010. Fondet per mbrojtjen sociale sipas PBA parashikohet te rriten me 10% ne vitin 2008, 12% ne 2009, dhe 10% ne vitin 2010.

Pjesa me e madhe e shteses se fondeve do te kaloje ne programin e ndihmes ekonomike. Ky program ne vitin 2010 parashikohet te rritet dy here me shune se ne vitin 2007. Rritja e fondeve dhe perfshirja vetem e familjeve realisht te varfera ne skeme do te ndikoj ne menyre te dukshme ne uljen e varferise. Ne vitin 2010, pagesa mesatare per nje familje ne skemen e ndihmes ekonomike do te jete 6.000 leke ose tre here me shume se ne vitin 2007.

Fondet e programuara per mbeshtetejen e PAK do te kene nje rritje me te moderuar duke tentuat afrimin me pensionin minimal ne qytet. Duke filluar nga viti 2008 deri ne vitin 2010, fondet per pagesen e PAK rriten mesatarisht me 6-8%.

Programi buxhetor i mbrojtjes sociale do te sjelle keto rezultate per tre vitet e ardhshme:

**Tabela 4.2 Produktet kryesore dhe buxheti e programit të mbrojtjes sociale**

Përshkrimi	Produkti kryesor 2008-2010	Milion lekë			
		2007 buxheti	2008 projektuar	2009 projektuar	2010 projektuar
Shërbime të decentralizuara; marrja e përgjegjesive nga qeverisja vendore për administrimin dhe ofrimin e shërbimeve në nivel lokal	600 kliente	495	311	318	378
Shërbime të deinstitutionalizuara; rritja e llojshmërisë së shërbimeve me baze komunitare brenda institucioneve që ofrohen shërbime residenciale	65 kliente	6	6	7	8
Shërbime residenciale se bashku me qendren për të verberit	230 kliente	133	141	157	165
Përfituesit nga granti i ndihmës ekonomike dhe pagesës për PAK	80000 familjet do të përfitojnë nga ndihma ekonomike në 2010 70000 personat do të përfitojnë nga pagesa për PAK	10800	12300	13962	15306
Kompensimi i familjeve të varfëra nga rritja e çmimit të energjisë elektrike	110000 familjet do të përfitojnë	2000	2000	2000	2000
Licensimi	100 licensa	13	16	52	60
Raportet inspektimi mbi standartet e shërbimeve shoqërore	24 raporte kontroli	44	87	43	58
Raportet Inspektimi mbi zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe pagesave të PAK	380 inspektime (njehere në vit çdo vit)	58	82	96	68
Të përndjekuri politike		400	400	400	400
Shërbime në bazë komunitare (sipas projektit të Bankës Boterore)		402	0	0	0

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007.

Me fondet e buxhetit qendror mbulohen të gjithë nevojat për shërbimet e decentralizuara të kaluara në vartësi të bashkive, ndërsa shërbimet komunitare të ngritura me projektin e Bankës Boterore duke filluar nga gjysma e vitit 2008 do të mbulohen me burimet e veta të njesive vendore. Zhvillimi i shërbimeve komunitare në të ardhmen do të bëhet nga burimet e veta qeverisjes vendore, fondit sociale dhe nga donatorët.

## Mekanizmi financiar

### Ndihma ekonomike

Deri tani, MPÇSSHB ka programuar dhe transferuar fondet për bllok-ndihmën ekonomike në fillim të vitit për çdo bashki dhe komunë, në përputhje me kërkesat e ardhura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe vlerësimin e tyre në nivel kombëtar. Fondet e programuara nga njësitë vendore, së bashku me dokumentacionin shoqëruar, ku zhvillohet metodologjia e llogaritjes së treguesve, paraqiten si kërkesa në SHSSH në nivel rajonal i cili mbasi kryen vlerësimet e nevojshme i përcjell në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH.

Reformimi i skemes së NE parashikon, që Ministria të përcaktojë si tregues tavanin maksimal të familjeve përfituese të NE për çdo bashki/komunë në varësi të hartës së varferisë. Bashkit/komunat do të për zgjedhin familjet që do të bëjnë pjesë në skemë, brenda numrit të rekomanduar, në bazë të vlerësimit të gjendjes sociale ekonomike të tyre (sipas kriterëve dhe dokumentacionit), dinamikës së varferisë, (hyrjeve dhe daljeve në skemë), si dhe vlerësimit të të ardhurave nga prona dhe aktivitetet bujqësore dhe blegtrorale. Nevojat për fonde përcaktohen duke shumezuar numrin e familjeve të për zgjedhura me masën e pagesës së NE në përputhje me strukturën e familjes.

Kërkesat për fonde së bashku me formularët shoqëruar kalojnë për vlerësim në zyrat rajonale të SHSSH i cili më pas i përcjell në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH. Shërbimi Social Shtetëror verifikon zbatimin e kriterëve dhe standardeve në fuqi dhe për llogarit, përfundimisht fondet për çdo bashki/komunë për të gjithë programin e NE në nivel kombëtar, të cilat së bashku me fondet e programeve të tjera të mbrojtjes sociale bëhen pjesë e projektbuxhetit të MPÇSSHB.

### Shërbimet sociale

Burimet e financimit për shërbimet e përkujdesit shoqëror do të përbëhen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit; nga të ardhurat vendore, nga fondet e projekteve të përbashkëta të qeverisë dhe donatorëve, kontributet e përfituesve, dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga organizatat, persona fizikë, juridikë apo individë. Fondet nga buxheti i shtetit delegohen si grante të kushtëzuara në njësitë e qeverisjes vendore që në fillim të vitit. Kjo do të ndihmojë në planifikimin e shërbimeve komunitare që do të bëjë çdo bashki/komunë. Reforma për decentralizimin e shërbimeve shoqërore mban parasysh edhe faktin se në fillimet e veta zhvillimi i shërbimeve të reja shoqërore në njësitë e qeverisjes vendore me të ardhura të pakta, do të kenë nevojë për mbështetje nga buxheti qendror.

SHSSH, krahas detyrave për vlerësimin e nivelit të varfërisë dhe programimin e fondeve të ndihmës ekonomike dhe të PAK, do të vazhdojë të analizojë e vlerësojë për një periudhë të caktuar edhe nevojat për shërbime shoqërore në nivel kombëtar për çdo rajon, rreth, bashki/komunë, bazuar në planifikimet komunitare të rajoneve. Kjo do të shërbejë për të balancuar nevojat me mundësitë e ofrimit të shërbimeve shoqërore, sidomos për rajonet me kapacitete dhe mundësi të pakta financiare.

Krijimi i Fondit Shoqëror do të ndihmojë për mbështetjen e shërbimeve të reja dhe zhvillimin e politikave shoqërore. Ky fond do të krijohet me fondet e buxhetit qendror, donacione të ndryshme, marrëveshje etj. Me këtë fond do të realizohen politika për shtrirjen e shërbimeve të reja shoqërore dhe kryesisht do të mbështeten njësitë e qeverisjes vendore që kanë të ardhura të pakta. Në këtë mënyrë do të tentohet të zbuten edhe diferencat midis zonave të ndryshme, që rrjedhin nga burime dhe mundësi të kufizuara financiare. Çdo qark/bashki/komunë nuk mund të ketë mundësi, burime financiare dhe kapacitete njerëzore për të ngritur të gjitha llojet e shërbimeve që kërkon komuniteti, por ato mund t'i blejnë këto shërbime nga qarqe/bashki të tjera, OJF apo ofrues privatë, në përputhje me ligjin "Për prokurimin e fondeve publike".



Qarqet/bashkitë/komunat mund të koeperojnë edhe me njëra-tjerën për të ndërtuar shërbime shoqërore të përbashkëta.

Këto mekanizma të financimit të shërbimit do të sigurojnë vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shoqërore ekzistuese që do të transferohen në përgjegjësi të njërive të qeverisjes vendor. Kontrolli për përdorimin e fondeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror do të bëhet nga Inspektoriati i Shërbimeve Shoqërore dhe organet e specializuara të kontrollit, në përputhje me ligjin "Për auditimin e brendshëm dhe kontrollin financiar".

## **Kontrolli financiar**

Kontrolli i përdorimit të fondeve për programet e mbrojtjes sociale, bëhet nga organet e specializuara të kontrollit në përputhje me ligjin për auditimin e brendshëm. Në nenin 27 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore", përcaktohet se Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta është autoriteti përgjegjës jo vetëm për hartimin e politikave, legjisllacioni, programimin e fondeve por edhe për kontrollin e efikasitetit të përdorimit të fondeve në programet sociale nga strukturat në nivel vendor.

Për këtë qëllim Ministri i Punës Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, bazuar në pikën 2, të nenit 27 të këtij ligji, ka ngritur Inspektoriatin e Ndihmes Ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore, i cili kontrollon zbatimin e legjisllacionit nga strukturat e vartësive, seksionet e mbrojtjes sociale në bashki/komune, dhe institucionet e përkujdesit ku ofrohen shërbime sociale.

Në kushtet e reformimit të sistemit të shërbimeve sociale, decentralizimit dhe të transferimit të kompetencave në pushtetin vendor, janë ndare qartë detyrat midis MPÇSSH dhe Shërbimit Social Shtetëror, i cili, si institucion ekzekutiv në nivel qendror dhe vendor, merr përgjegjësi të reja që lidhen me inspektimin, monitorimin, kontrollin e zbatimit të përdorimit të fondeve në programet e ndihmes ekonomike, pagesës së PAK dhe shërbimeve sociale.

Për realizimin e këtij misioni me Urdhërin Nr. 252, dt 01.11.2006, të Kryeministrit u miratua struktura e re e Shërbimit Social Shtetëror. Në përberjen e SHSSH, u krijua Drejtoria e Inspektimit të Programit të NE dhe pagesës së PAK si dhe Drejtoria e Inspektimit të shërbimeve sociale. Strukturat e inspektimit shtrihen edhe në nivel rajonal. VKM Nr. 512 dt 31.5.2006, përcakton procedurat e reja të kryerjes së kontrollit të ndihmes ekonomike, pagesës së PAK dhe shërbimeve shoqërore. Ristrukturimi i strukturave të kontrollit u shoqërua me një përmirësim në procedurat e zbatimit të legjisllacionit. VKM për procedurat e kontrollit përcakton: i) subjektet, llojin, kohën dhe objektivat e kontrollit; ii) masat që jepen për moszbatimin e legjisllacionit për pagesat e NE, PAK dhe për ofruesit e shërbimeve sociale; iii) dokumentacioni që do të nënshtrohet kontrollit që plotësohet nga përfituesit, informacionin që duhet të japin angjensite publike në nivel rajonal për numrin e përfituesve, nivelin e varfërisë, të ardhurat, punësimin, pronën, rezidencën legale të familjes etj.

Inspektoriati i Shërbimeve Shoqërore, në procesin e inspektimit, duhet të garantojë realizimin e cilësive të shërbimeve në përputhje me standartet e miratuara të cilat kanë në qendër klientin si përfitues shërbimesh. Inspektoriati i shërbimeve ka kompetencë për të dhënë masa kur konstatohet se nuk zbatohen standartet e kërkuara: propozimi i heqjes së licencës, bllokimi i aktivitetit, shlyerjen e detyrës dhe fillimi i procedurave kur ato përbejnë vepra penale (Tabela 4.3).

Përmirësimi i metodologjisë, treguesve, kritereve për vlerësimin e varfërisë si dhe përdorimi i informacionit dhe dokumentacionit të ri që shërben për identifikimin e familjeve të varfëra do të shoqërohet edhe me procedurat e reja të kontrollit për të garantuar administrimin e fondeve në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Kjo procedura synon lehtësimin dhe shkurtimin e kohës së aplikantëve për plotësimin e dokumentacionit, eliminimin e transaksioneve dhe pagesave

te paligjeshme nga njera ane dhe forcimin e detyrive ligjore (me VKM ) per saktetin dhe kohen e informacionit qe duhet te japin institucionet dhe agjensite publike qe operojne ne nivel vendore lidhur me statusin e varferise te aplikanteve te ndryshem. Per kete do te nderhyrjet ne keto drejtime:

- Aplikantet do te vazhdojne te plotesojne tre deklarata personale (Rubrika 1.1) (qe nuk lidhen me zyrat e administrates publike) ku pasqyrohet gjendja sociale ekonomike e familjes, punesimi apo emigrimi, te ardhurat nga bujqesia, blegtoria dhe pagesa e detyrimeve ndaj KESH. Keto dokumenta do te vazhdojne te jene objekt kontrolli.
- Aplikanti do te vazhdojne te marrin dhe te dorezojne certifikaten e gjendjes familjare dhe te pronesise se tokes vetem nje here ne vit dhe nje here ne tre muaj, vertetimin si pune kerkues i papune (Rubrika 1.2). Ky informacion i domosdoshem meret nga zyrat e administrates publike ne rajon. Objekt kontrolli ne kete rast (me VKM) do te jete administratori i njesise vendore dhe institucioni qe leshon dokumentin.
- Informacioni nga agjensite publike rajonale per punesimin, tatim-taksat, inspektorati i punes, sigurimet shoqerore, zyra e rregjistrimit te pasurive, rregjistrimit te automjeteve, dhe zyrat e taksave vendore (Rubrika 1.3) megjithese i detyrueshem me VKM, deri tani nuk ka funksionuar dhe nuk eshte bere as objekt i kontrollit dhe ndeshkimit per mos zbatim te ligjit. Ky informacion i domosdoshem duhet te dergohet nga shtate zyrat dhe agjensite rajonale, duke reduktuar keshtu informalitetin ne procesin e identifikimit te varferise dhe familjeve qe duhet te perfitojne NE.
- Objekt kontrolli do te vazhdojne te jene administratoret shoqeror ne bashki/komun , per zbatimin e kriterëve per masen e NE, vleresimin e te ardhurave nga bujqesia , blegtoria dhe programi i fondeve per NE dhe PAK. Ky objekt kontrolli, ne gjashte-drejtime (Rubrika 1.4) qe deri tani nuk eshte realizuar. Ne kete rast kontrolli lidhet vetem me punen e administrates vendore, i cili ne vetvete mbart informalitet te larte .
- Disa fusha te tjera kontrolli (10 fusha) lidhen me zyren e finances (Rubrika 1.5), periodiciteti i kontrollit (Rubrika 1.6), dhe masat per shkeljet ligjore (Rubrika 1.7). Zbatimi i kriterëve te kontrollit dhe masave shternguese do te ndikojne ne perdorimin me efektivitet te fondeve per uljen e varferise.

Implementimi i kriterëve dhe i metodologjise se inspektimit per sherbimet shoqerore, ka si objekt kontrollin e 15 fusha, te cilat kane filluar te japin rezultate.

Fushat dhe objektivat e kontrollit per programet e NE, pageses se PAK dhe sherbimeve sociale si dhe permiresimet qe duhet te behen ne te ardhmen paraqiten ne Tabelen 5.1.

**Tabela 4.3 Objekti i inspektimit te ndihmes ekonomike, PAK dhe sherbimeve sociale**

Objekti i kontrollit	Aktual	Bëhet
1. Inspektorati i Ndhmes Ekonomike dhe Pagesa ne Cash		
1.1 Dokumenta qe ploteson aplikanti. Deklarat per:		
- gjendjen sociale-ekonomik (VKM 787, Mod 1)	X	X
- perberjen e familjes, statusi ne punesimit, arsim, emigracion etj. (VKM 787, Mod 2)	X	X
- kompesimin e energjise elektrike (Udhezimi 10 dt. 26.9.2006)	X	X
1.2 Dokumenta qe aplikanti merr nga istitucionet (VKM 787):		
- certifikata e gjendjes familjare	X	X
- certifikata e pronesise tokes/tapia	X	X
- vertetimin si pune kerkues i papune	X	X
- vertetimet per statusin e varferise per familjet qe ndryshojne vendbanimit (Udhezimi 338/3 dt. 6.3.2006)	X	X

1.3 Informacion nga agjensite publike rajonale nga:		
- Zyra e Punes, per punesimin dhe papunesine		X
- Zyra e Tatim-Taksave, per ushtrim aktiviteti me leje ose pa leje		X
- Inspektoriati i Punes, per punesimin ilegal		X
- Zyra e Sigurimeve Shoqerore, per pensioni pleqerie/familjer		X
- Zyra e Rregjistrimit te Pasurimeve te Paluajtshme (hipoteka)		X
- Zyra e Rregjistrimit te Automjeteve		X
1.4 Per kriteret e vleresimit te varferise nga administratoret:		
- Zbatimi i kriterëve per llogaritjen e mases se NE sipas struktures se familjes (VKM 787)	X	X
- Zbatimi i kriterëve per vleresimin e te ardhurave nga bujqesia/blegtoaria (Udhezimi Nr. 479 dt. 6.3.2006)		X
- Zbatimi i kriterëve per programimin e fondeve per NE (Udhezimi Nr.2471 dt. 6.12.2006, Mod. 1)	X	X
- Zbatimi i kriterëve per programimin e fondeve per pagesat e PAK dhe invalidet e punes (Udhezimi Nr.2472, dt. 6.12.2006, Mod. 1)	X	X
- Te dhenat e intervistimit/vizite ne familje (Udhezimi 338/3, dt. 10.3.2006)	X	X
- Numri i perfituesve dhe fondet e propozuara nga bashkia/komuna dhe numri i perfituesve dhe fondet te miratuara nga keshilli i bashkise/komunes	X	X
1.5 Per zyren e finances ne bashki/komune		
- perputhja e listepagesave ne njesin vendore me dokumentat ne thesar, per numrin e familjeve, pagesa per NE dhe pagesen per kompesimin e energjise		X
- perputhja e listepagesave ne njesi vendore me dokumentat ne thesar, per numrin e perfituesve, pagesa per PAK dhe pagesen per energjine		X
- krahasimi i listepageses te perfituesve me aftesi te kufizuara dhe perfituesve si invalid pune		X
1.6 Periodiciteti i kontrollit dhe konkluzionet		
- Inspektorati e nivel qendror kontrollon nje here ne vit Zyren Rajonale te SHSSH dhe me zgjedhje njesit e qeverisjes vendore		X
- Inspektorati Rajonal kontrollon nje here ne vit te gjitha njesite e qeverisjes vendore		X
- Raporti dhe konkluzionet e kontrollit, shkeljet dhe masat e propozuara i drejtohet Kryetarit te bashkise/komunes dhe nje kopje prefektit		X
1.7 Masat qe japin Inspektoret per shkeljet nga administratoret (VKM Nr. 512)		
- gjobe, sipas neneve 5 dhe 6 te ligjit "Per kundervajtjet administrative" (deri ne gjysem page ose deri ne 2 vjet heqje lirie)		X
- verejtje me shkrim		X
- propozim per largim nga puna		X
- propozim per fillimin e procedurave per autoritet pegjegjes		X
- per ndryshimin e destinacionit te fondeve, te NE dhe PAK, inspektoriati propozon edhe nderprerjen e fondeve		X
2. Inspektorati i Sherbimeve te Perkuajdesit Social		
2.1 Zbatimi i paketes se standardeve te sherbimit, per secilin grup perfituesish:		
- zbatimin e legjislacionit ne fuqi, sipas natyres se sherbimeve qe kryhen		X
- dokumentacionin e çdo klienti qe perfiton sherbime		X
- kushtet higjieno-sanitare te institucionit		X
- dokumentacionin e nevojshem te personelit, qe ofron sherbimin		X
2.2 Inspektoriati per shkeljet e vertetuara jep nje nga masat e meposhtme		
- Pezullimin e veprimtarise se subjektit deri ne plotesimin e standardeve te sherbimeve		X
- Mos-rinovimin e licences per ushtrimin e veprimtarise		X
- Heqjen e licences per ushtrimin e veprimtarise dhe mbylljen e saj		X
- Fillimin e procedurave per shlyerjen e demit te shkaktuar		X
- Masen disiplinore, per shkelje te dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative		X
2.3 Raporti i kontrollit, shkeljet e vertetuara dhe masat qe do te merren i dorezohen subjektit te kontrolluar, Prefektit dhe Ministrise		
		X

---

2.4 Pas heqjes se licences:	
- kerkon prane gjykates, shperndarjen e shoqates ose fondacionit, ne perputhje me "Kodin Civil i Republikes se Shqiperise", te ndryshuar	X
- njofton organet tatimore per nderprerjen e veprimtarise se subjektit	X
2.5 Subjektet e kontrolluara ka te drejte te ankohet sipas dispozitave ne Kodin e Procedurave Administrative	X

---

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007.

## 5. Monitorimi

Monitorimi i zbatimit të strategjisë do të bazohet mbi një listë indikatorësh të përzgjedhur. Këta indikatorë fokusohen në arritjen e qëllimeve strategjike dhe janë hartuar në nivelin e *impaktit* dhe të *rezultateve*. Me poshte paraqiten disa ceshtje që lidhen me instrumentat kryesore monitoruese.

### Ndihma ekonomike

Sistemi i monitorimit të varferise u krijua në vitin 2002 njëkohësisht me anketën e parë kombëtare për matjen e nivelit të jetesës, LSMS, me mbështetjen e komunitetit të donatoreve. LSMS ka shërbyer në kryerjen e vlerësimeve të besueshme për varferinë dhe në të kuptuarit e tendencave të treguesve të asistencës sociale nëpërmjet anketave me pjesë të modelit fillestar të 2003-shit dhe 2004-es e sidomos nëpërmjet vezhgimit të viti 2005 e cila krijoi një model të ri. LSMS ka qenë e pazevendësueshme në matjen e impaktit të politikave kryesore sociale, përfshi politikën e transfertave publike, të tilla si ndihma ekonomike. Vlera e saj është akoma më e madhe nëse marrim parasysh që varferia është një fenomen shumë-dimensional që pasqyrohet shumë mirë nga LSMS për shkak të anketave të saj të gjera të cilat mbulojnë probleme të aksesit në shërbimet publike.

Mendohet që anketimi nga LSMS duke përdorur të njëjtat definicione për garantimin e monitorimit të tendencave në kohë, do të ishte i vlefshëm të perseritej çdo tre vjet në kushtet e ndryshimeve të shpejta social-ekonomike. Kjo do të thotë se gjatë zhvillimit të kësaj strategjie, duhet të zhvillohen edhe dy runde të tjera të LSMS në 2008 dhe në 2011. Megjithatë, nuk ka një angazhim që nëse donatorët nuk do ta financojnë plotësisht LSMS, kosto e saj do të mbulohet dhe nga qeveria. Draft-programi 5-vjeçar statistikor nuk e përfshin LSMS në programin që ka për vezhgimet. Në vend të tij, theksi ka kaluar tek Vezhgimi për Buxhetin e Familjes, që fillimisht u zhvillua në vitin 2006 por me një fokus disi më të ndryshëm.

Është shumë e rëndësishme që LSMS të kryhet, sepse monitorimi i impakteve kryesore të pritshme të strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale mbështetet plotësisht në rezultatet e saj të disponueshme. Për shembull, harta e varferise (që përdori rezultatet e Censurit të 2001-shit dhe LSMS 2002 ) duhet të përditesohet me rezultatet e Censurit 2011, sepse deri atëherë rradhitja e komunave dhe bashkive sipas shkallës së varferise do të jete vjetëruar - kështu që do të nevojitet një LSMS e re. Ministria e Punës, Ceshtjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta duhet të luajë një rol aktiv që pyetsori për Censurin të krijojë një hartë më të mirë të varferise.

Një problem tjetër që duhet marrë në konsideratë, është nëse duhen bërë përpjekje të kalohet në llogaritjen e treguesve të varferise në baze të të ardhurave që të përputhet me praktikën e vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Megjithatë, pritët që gjatë zhvillimit të strategjisë, konsumi do të jete më i besueshëm dhe i matshëm sesa të ardhurat. Ka mundësi që vezhgimi i tendencave afat-gjate të marrë më shumë rëndësi se krahasimet ndërmjet vendeve.

Një nga sfidat kryesore është akoma mungesa e mekanizmave vlerësues dhe monitorues në rang kombëtar për vlerësimin e ndikimit të programit të ndihmes ekonomike dhe subvencionit për energjinë, nëse politikën e meparshme kanë qenë të suksesshme, nëse pushteti lokal ka vënë në zbatim dhe ka administruar me efektshmeri udhëzimet e administratës qendrore. Vlerësimet e efektshmerisë së politikave për transfertat publike dhe ndërveprimet me transfertat private janë mbështetur në asistencën e huaj. Kapacitetet e brendshme duhet të fuqizojnë.

Një nga problemet që preokupon formuluesit e politikave sociale është plani për modernizimin e regjistrimit të gjendjes civile dhe pajisja e të gjithë qytetarëve me karta identiteti. Vendosija e lidhjes ndërmjet numrit të kartës së identitetit dhe përfituesve të ndihmes ekonomike mund të kontribuojë shumë në minimizimin e abuzimeve në program.

## Shërbimet sociale

Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave nga njësitë e qeverisjes vendore do të japë një tablo realiste për vlerësimin e politikave dhe nevojave për shërbime të reja. Njësitë e qeverisjes vendore do të jenë strukturat më të përshtatshme për mbledhjen e statistikave dhe informacioneve në terren. Këto struktura janë më afër klienteve dhe ofruesve të shërbimeve dhe, si të tilla, njohin me mirë banorët dhe problematikën e territorit të tyre, vlerësojnë kërkesat, nevojat dhe mundësitë për shërbime dhe bashkëpunojnë me ofruesit e tjerë të shërbimeve. Të dhënat e grumbulluara kalojnë në nivel qarku, në sektoret perkates të shërbimeve shoqërore rajonale, e më pas në institucionet qendrore si SHSSH/MPÇSSHB.

- Vendosja e një dialogu të rregullt dhe ligjor ndërmjet MPÇSSHB e institucioneve në varësi të saj dhe njësitë të qeverisjes vendore për grumbullimin e të dhënave e informacioneve.
- Do të përcaktohen treguesit e detyrueshëm statistikorë nga MPÇSSHB dhe Ministria e Brendshme për të gjitha institucionet në varësi të tyre (me VKM)
- Të dhënat e grumbulluara do të raportohen si kaskadë nga bashkitë, komunat në nivel qarku, në drejtoritë rajonale të Shërbimeve Sociale e më pas në SHSSH/ MPÇSSHB.
- Analiza periodike sipas statistikave administrative dhe raportimi në instancat e prore.
- Raportet periodike të inspektorëve të NE, PAK dhe shërbimeve shoqërore në nivele e prore, si një burim për analizën e politikave shoqërore.

## Grupet në rrezik përjashtimi social

Vezhgimet e nivelit të jetesës nuk janë mekanizmi më i përshtatshëm për monitorimin e situatës së grupeve të vulnerabël, të cilët janë relativisht të izoluar dhe të pakët në numër. Kështuqë sfida për monitorimin e saktë të këtyre grupeve është thelbësore. Roli koordinues i MPÇSSHB, është përshkruar në Kapitullin 3. Përsa i përket monitorimit të zbatimit të politikave:

- Në rastin e fëmijëve, Sekretariti Teknik, do të ndjekë progresin e objektivave dhe do të raportojë në Komitetin Nderministror për të Drejtat e Fëmijëve.
- Në rastin e personave me aftësi të kufizuara, Sekretariati Teknik do të raportojë tek Këshilli Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar dhe në Parlament, çdo vit deri në vitin 2009 dhe më vonë, një herë në dy vjet.
- Në rastin e Romeve, ndryshimi i banimit, do të thotë se është e vështirë të vëzhgohen kushtet e tyre të jetesës dhe të vlerësohet progresi. Në vitin 2005, UNDP, vëzhgoi popullsinë romë në dhjetë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore, duke përfshirë Shqipërinë, dhe solli informacion të vlefshëm social ekonomik, që mund të shërbejë si bazë. Megjithatë Shqipëria nuk ka firmosur, Dekadën për Përfshirjen e Romeve, 2005-2015, ofron një kontekst për të rifreskuar informacionin, edhe pse do të duhet mbështetje financiare dhe teknike nga jashtë.

### Treguesit e monitorimit

Progresi në implementimin e strategjisë do të vlerësohet me anë të indikatorëve të përcaktuar më poshtë. Këta indikatorë masin ekskluzivisht rezultatet dhe impaktet.

Tabela 5.1 Lista e indikatorëve të strategjisë

	Indikator	Ndarja	Burimi
--	-----------	--------	--------

Zbutja e varfërisë			
	Shkalla e varferise relative		LSMS
	Shkalla e varferise relative para transfertave sociale ne cash		LSMS
	Hendeku i varferise relative		LSMS
	Shkalla e varferise absolute		LSMS
	Shkalla e varferise ekstreme absolute		LSMS
Pagesat ne cash			
	Numri i familjeve ne ndihme ekonomike		ShSSH
	Masa mesatare mujore e ndihmes ekonomike per familje		ShSSH / LSMS
	Shuma e perfitimeve te ndihmes ekonomike	Sipas njesise	ShSSH
	Mbulimi nga programi i ndihmës ekonomike (%) Përkufizimi: Përqindja i njerëzve të varfëra që përfitojnë	Te varfëra ose ekstremisht të varfëra	LSMS
	Humbjet ne programin e ndihmes ekonomike (%) Përkufizimi: Përqindja e personave jo te varfer qe perfitojne	Te varfëra ose ekstremisht të varfëra	LSMS
	Ndikimi i programit te ndihmes ekonomike mbi reduktimin e varferise (sipas supozimit qe pagesa konsumohet)		LSMS
	Numri i familjeve qe kompensohen per energjine		MPÇSSHb
Sherbimet shoqerore			
	Numri i vendeve qe ofrojne sherbime per femijet	Publike dhe jopublike	ShSSH
	Numri i femijeve perfitues te sherbimeve shoqerore	Publike dhe jopublike	ShSSH
	Fondi i shpenzimeve ne qendrat publike per femijet		ShSSH
	Numri i qendrave qe ofrojne sherbime per pleqte ne nevoje	Publike dhe jopublike	ShSSH
	Numri i te moshuarve perfitues te sherbimeve shoqerore	Publike dhe jopublike	ShSSH
	Fondi i shpenzimeve ne qendrat publike për pleqte		ShSSH
	Numri i qendrave qe ofrojne sherbime per PAK	Publike dhe jopublike	ShSSH
	Numri i PAK perfitues te sherbimeve shoqerore	Publike dhe jopublike	ShSSH
	Fondi i shpenzimeve ne qendrat publike per PAK		ShSSH
	Numri i sherbimeve komunitare	Sipas njesise, grupeve perfituese, statusit	ShSSH
	Numri i sherbimeve alternative te zhvilluara per te parandaluar institucionalizimin	Sipas njesise, grupeve perfituese, statusit	ShSSH
	Përqindja e sherbimeve qe plotesojne standartet		Inspektoriat
Grupet në rrezik përjashtimi social: fëmijet			
	Shkalla e varferise absolute për fëmijet		LSMS
	Numri i fëmijëve të trafikuar brënda apo jashte vendit për qellime shfrytezimi		Ministria e Brendshme
Grupet në rrezik përjashtimi social: PAK			
	Numri i PAK		ShSSH
	Numri i personave me perfitim kujdestarie		ShSSH
	Numri i invalideve te punes		ShSSH
	Pagesa mesatare mujore per nje person te paafte		ShSSH
	Shuma e perfitimeve te pageses se paaftesise		ShSSH
Grupet në rrezik përjashtimi social: Romet			
	Numri i sherbimeve te ofruara per komunitetin Rom		ShSSH
Grupet në rrezik përjashtimi social: gratë			
	Numri i grave ne nevoje qe perfitojne sherbime shoqerore		ShSSH